

PRAKTIKA GJYQËSORE PËRMBARIMORE

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS KOMERCIALE TË KOSOVËS

KAPITULLI I - PARASHKRIMI

KAPITULLI II - URDH RAT PËR SHITJE

KAPITULLI III - URDHËRESAT ME GJOBA MENDATORE

KAPITULLI IV - PLOTËSIMI I PROPOZIMIT PËR PËRMBARIM

KAPITULLI V - MËNYRA E DORËZIMIT TË FATURAVE

KAPITULLI VI - GARANÇIONI FINANCIAR

KAPITULLI VII - ÇAKTIMI I RADHËS SË DEBITORËVE

KAPITULLI VIII - KUSHTET LIGJORE PËR PËRSHTATSHMËRINË E FATURAVE

KAPITULLI IX - KUSHTET PËR PËRMBARIM

PRAKTIKA GJYQËSORE PËRMBARIMORE

**PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS KOMERCIALE TË
KOSOVËS**

DHOMAVE TË SHKALLËS SË DYTË

Për nxjerrjen e kësaj përmbledhje janë analizuar të gjitha vendimet e publikuara të Gjykatës Komerciale – Dhomave të Shkallës së Dytë nga fillimi i punës së kësaj gjykate me datë 01.08.2022 deri me 31.12.2023.

AUTORË:

- **Florin LATA - Avokat**
- **Ardrit HUMOLLI - Bashkëpunëtor ligjor**
- **Valmir HAZIRAJ - Bashkëpunëtor ligjor**

REDAKTOR:

- **Adem VOKSHI - Avokat**

Kontribues tjerë:

- **Urim VOKSHI - Avokat**
- **Senat ELSHANI - Avokat**
- **Albin XHEMAILI - Avokat**
- **Agnesa AZEMI-ADEMI - Avokate**
- **Urtina SHKRELI - Bashkëpunëtoe ligjore**
- **Florentina LATA - Asistente Administrative**

Dizajnoi:

- **Makfire ALIU**

E drejta e autorit - Ky publikim është pronë ekskluzive e Shoqërisë së Avokatëve "Vokshi & Lata" dhe mbrohet nga ligji për të drejtën e autorit. Çdo formë riprodhimi, shpërndarjeje, ekspozimi publik ose përshtatje e këtij publikimi pa pëlqim paraprak me shkrim i Shoqërisë Ligjore "Vokshi & Lata" është i ndaluar.

Ndalimi përfshin, por nuk kufizohet në kopjimin, ndarjen ose shpërndarjen e ndonjë pjese të këtij publikimi në çfarëdo formati ose mediumi, qoftë elektronik, i printuar ose tjetër, për çfarëdo qëllimi, komercial ose jokomercial. Përdorimi i paautorizuar ose shkelja e këtyre të drejtave do të rezultojë me ndërmarrjen e veprimeve ligjore dhe mjeteve juridike sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Për pyetje ose kërkesa në lidhje me përdorimin e këtij publikimi, ju lutemi kontaktoni info@vokshilata.com. "Vokshi & Lata" rezervon të drejtën për të dhënë ose refuzuar lejen sipas vlerësimit të saj.

Copyright © 2024, Shoqëria e Avokatëve "Vokshi & Lata". Të gjitha të drejtat e rezervuara.

NJOFTIM - Informacioni i dhënë në këtë dokument ka vlerë të përgjithshme dhe nuk përbën këshillë ligjore. Asnjë lexues nuk duhet të veprojë bazuar në një informacion të tillë pa kërkuar këshilla profesionale. Edhe pse ne përpiqemi të ofrojmë informacion të saktë dhe në kohë, autorët dhe firma nuk mbajnë përgjegjësi për çdo pasaktësi ose lëshim të përfshirë në këtë dokument.

PARATHËNIE

Me themelimin e Gjykatës Komerciale, kompetenca për trajtimin e lëndëve përmbareme ndërmjet subjekteve juridike, e cila, pas ndryshimeve ligjore të vitit 2013, kishte kaluar në kompetencën e gjykatave të rregullta, u rikthye te një gjykatë e specializuar. Ky zhvillim ka sjellë një përmirësim të rëndësishëm në sistemin tonë gjyqësor, duke garantuar që çështjet përmbareme në mes të subjekteve juridike të trajtohen nga gjyqtarë me ekspertizë të specializuar në çështjet komerciale.

Për të vlerësuar ndikimin e këtij ndryshimi dhe për të pasqyruar përmirësimet e mundshme të praktikës gjyqësore, kemi analizuar praktikën e Gjykatës Komerciale gjatë 17 muajve të parë të funksionimit të saj (01.08.2022-31.12.2023). Në këtë publikim, kemi përfshirë çështjet më të rëndësishme të trajtuara gjatë kësaj periudhe, duke ndihmuar në reflektimin e punës së kësaj gjykate dhe në identifikimin e zhvillime në fushën e drejtësisë komerciale.

Nga një total prej mbi 800 vendimesh të Dhomave të Shkallës së Dytë të analizuar nga ana jonë, kemi përzgjedhur me kujdes vetëm 71 prej tyre për këtë publikim, duke u përqendruar në ato që përfaqësojnë praktikën më të rëndësishme dhe më me ndikim. Çdo vendim është prezantuar në formë të përmbledhur, me një paragraf shpjegues në hyrje. Për lexuesit që dëshirojnë të konsultojnë vendimin e plotë, referencat e sakta janë të përfshira, duke i mundësuar të shkarkojnë vendimin nga faqja zyrtare e Gjykatës Komerciale.

Vlen të theksohet se gjatë muajve të parë të funksionimit të Gjykatës Komerciale, shumë prej këtyre vendimeve kanë shqyrtuar vendimet e nxjerra në shkallë të parë nga gjykatat e rregullta, të nxjerra para themelimit të Gjykatës. Lexuesi do të vërejë se ka mjaft vendime që gjykata i ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje dhe ka dhënë sqarime se si të veprohet në marrjen e vendimeve të drejta.

Ky publikim është i strukturuar në nëntë kapituj ku janë përmbledhë vendimet e gjykatës sipas tematikës duke pasur për qëllim të ndihmojë të gjitha palët e përfshira në proceset përmbareme, si bizneset, avokatët, përmbareuesit privatë, juristët e kompanive dhe kontabilistët e po ashtu të shërbejë edhe për studiuesit e kësaj lëmie.

Shoqëria e Avokatëve "Vokshi & Lata" ka vërejtje për mënyrën e vendosjes dhe interpretimin e dispozitave ligjore nga Gjykata Komerciale në disa nga rastet e përfshira në këtë publikim, ashtu siç pajtohet me Gjykatën në raste të tjera. Megjithatë, këto pajtime apo mospajtime nuk janë objekt i këtij publikimi, prandaj qëndrimet e "Vokshi & Lata" lidhur me këto çështje nuk janë shpërfaqur këtu. Për të ruajtur objektivitetin, kemi përjashtuar nga publikimi çdo vendim ku kemi vepruar si përfaqësues.

Në disa raste, kemi gjetur se ka dallime në qëndrime ose interpretime të Gjykatës për çështje të njëjta. Disa prej këtyre vendimeve i kemi përfshirë në këtë publikim për të inkurajuar diskutimin mbi temat e tilla dhe për të theksuar nevojën për unifikimin e mëtejme të praktikës gjyqësore. "Vokshi & Lata" mbetet e përkushtuar për të vazhduar mbështetjen dhe kontributin e saj në zhvillimin e drejtësisë dhe praktikave më të mira gjyqësore në Kosovë.

Për tu vlerësuar është edhe transparenca e Gjykatës Komerciale, e cila, me publikimin e të gjitha vendimeve, e ka bërë të mundshme përgatitjen e këtij publikimi. Të gjitha vendimet e trajtuara nga ana jonë në këtë publikim janë marrë nga web-faqja zyrtare e Gjykatës Komerciale.

Ky publikim është rezultat i punës dhe angazhimit të shtuar të gjithë stafit të “Vokshi & Lata”, të cilët, krahas punës së përditshme, kanë dhënë kontributin e tyre në përgatitjen e këtij publikimi të praktikës gjyqësore të Gjykatës Komerciale. Mirënjohje të veçantë meritojnë bartësit e këtij projekti Ardit Humolli, Valmir Haziraj dhe Florin Lata për kontributin dhe dedikimin e tyre.

Urim Vokshi

Rreth Vokshi & Lata

Në vitin 1982, në zemrën e Mitrovicës, një qytet industrial që pulsonte me energjinë e punëtorëve të saj, Avokati Adem Vokshi bëri një ndryshim të rëndësishëm në karrierën e tij. Pasi kishte shërbyer si gjyqtar për më shumë se 4 vite, ai vendosi të japë dorëheqjen për shkak të rrethanave politike të kohës, i shtyrë nga dëshira për të kontribuar në drejtësi nga një perspektivë tjetër—si avokat. Ai hapi një zyrë të vogël avokatie, i vetëdijshëm për pengesat që do të përballonte, por i vendosur që drejtësia të kishte një shtëpi të fortë dhe të sigurt. Nga ky fillim modest, zyra e Adem Vokshit u shndërrua në një pikë kyçe për drejtësinë në Kosovë, ku çdo rast, sado i vogël, trajtohej me përkushtim dhe integritet.

Në vitin 2012, një kapitull i ri u hap për këtë zyrë kur Florin Lata, një jurist i ri me vizion dhe energji të re, u kthye nga studimet e tij në Francë. Me një sfond të fortë në të drejtën ndërkombëtare private dhe pronësinë intelektuale, dhe me dëshirën për të kontribuar në përmirësimin e sistemit ligjor në Kosovë, ai u bashkua me z. Vokshi. Ata filluan një periudhë të suksesshme bashkëpunimi në një firmë tjetër avokatie, ku punuan me partnerë të tjerë.

Në ndërkohë, firmës iu bashkua edhe avokati Urim Vokshi, i cili ishte i specializuar në të drejtën komerciale dhe kontraktuale. Ky bashkim ndihmoi në ndërtimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të firmës, duke e rritur stafin dhe duke kontribuar në zhvillimin e saj. Pas një periudhe të gjatë dhe produktive në këtë firmë, z. Vokshi dhe z. Lata vendosën të ndjekin një vizion të përbashkët: të ndërtonin një firmë avokatie model për tregun e Kosovës. Kështu, ata themeluan Shoqërinë e Avokatëve Vokshi & Lata, e cila bazohej në standarde të larta dhe parime etike që do të përballonin sfidat e kohës, me qëllim të ofronin shërbime ligjore cilësore dhe të kontribuonin në zhvillimin e sistemit ligjor në Kosovë.

Kështu lindi Shoqëria e Avokatëve Vokshi & Lata, një firmë që sot është sinonim i cilësisë dhe besueshmërisë. Firma jonë ofron një gamë të gjerë shërbimesh ligjore, duke përfshirë këshilla dhe përfaqësim në të gjitha aspektet e ligjit, si të drejtën afariste dhe komerciale, të drejtën e punës, të drejtën e pronësisë intelektuale, të drejtën fiskale, të drejtën e energjisë, mbrojtjen e konsumatorit, etj. Ne ofrojmë zgjidhje të plota dhe të personalizuar për klientët tanë duke i mbështetur në tejkalimin e sfidave ligjore dhe në mbrojtjen e interesave të tyre në çdo hap.

Ne jemi të përkushtuar të kontribuojmë në shoqëri përmes ndarjes së njohurive dhe edukimit. Kjo përfshin botimin e materialeve që ndihmojnë në avancimin e sektorit ligjor dhe komunitetit të biznesit në Kosovë. Aktivitetet tona përfshijnë publikime, libra, artikuj në revista ndërkombëtare, dhe një blog të pasur në faqen tonë të internetit. Përveç kësaj, avokatët tanë janë trajnerë në fusha të ndryshme ligjore, duke ofruar trajnim dhe workshope për profesionistët dhe investitorët. Këto burime dhe aktivitete janë të dizajnuara për të ofruar njohuri të dobishme dhe këshilla praktike, duke kontribuar kështu në zhvillimin dhe përmirësimin e sektorit ligjor dhe afarist në Kosovë.

Një shembull i angazhimit tonë është “Legal Guide to Investing in Kosovo” një udhëzues që ndihmon investitorët ndërkombëtarë të kuptojnë mundësitë dhe sfidat në Kosovë. Ky botim është një pjesë e rëndësishme e përpjekjeve tona për të ofruar informacion të vlefshëm dhe të saktë, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe ligjor të vendit.

Sot, Vokshi & Lata është një firmë e përkushtuar për të ofruar shërbime ligjore të personalizuar dhe të orientuara drejt klientit. Ne bashkëpunojmë rregullisht me ekspertë nga fusha të ndryshme, për të siguruar që klientët tanë të marrin këshillat më të mira të mundshme. Me një kombinim të përvojës së partnerëve dhe energjisë së të rinjve, Vokshi & Lata është një histori suksesi që vazhdon të shkruhet çdo ditë.

TABELA E PËRMBAJTJËS

PARATHËNIE.....	5
KAPITULLI I.....	13
PARASHKRIMI.....	13
1. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 880/23 i datës 23.10.2023.....	14
2. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 379/22 i datës 22.02.2023.....	16
3. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 71/22 i datës 25.05.2023.....	18
4. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1246/22 i datës 25.05.2023.....	20
5. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 137/23 i datës 10.07.2023.....	22
6. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 419/23 i datës 17.07.2023.....	24
7. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1317/2022 i datës 09.09.2022.....	25
KAPITULLI II.....	27
URDHRAT PËR SHITJE.....	27
8. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 63/2022 i datës 25.08.2022.....	28
9. Aktvendimi K.DH.SHK.II.nr. 270/2023 i datës 06.06.2023.....	30
10. Aktvendimi K.Dh.Shk.II.nr. 1266/2022 i datës 19.06.2023.....	32
11. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 782/2022 i datës 21.06.2023.....	34
12. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 340/2023 i datës 12.07.2023.....	36
13. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 322/23 i datës 09.08.2023.....	38
14. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 86/2023 i datës 05.09.2023.....	40
15. Aktvendimi K.Dh.Shk.II.nr. 214/2023 i datës 22.09.2023.....	42
KAPITULLI III.....	45
URDHËRESAT ME GJOBA MANDATORE.....	45
16. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 749/23 i datës 18.09.2023.....	46
17. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 748/23 i datës 26.10.2023.....	48
KAPITULLI IV.....	51
PLOTËSIMI I PROPOZIMIT PËR PËRMBARIM.....	51
18. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 437/22 i datës 15.02.2023.....	52
19. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 303/22 i datës 12.04.2023.....	54
20. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 729/2022 i datës 20.04.2023.....	56
KAPITULLI V.....	59
MËNYRA E DORËZIMIT TË FATURAVE.....	59
21. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 68/22 i datës 21.07.2022.....	60
22. Aktvendimi Kom.Dh.Sh.II.nr. 1309/22 i datës 22.08.2022.....	62
23. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 33/22 i datës 01.09.2022.....	64

24. Aktvendimi K.DH.SH.II nr. 308/22 i datës 12.10.2022.....	66
25. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 424/22 i datës 26.01.2023.....	68
26. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 777/22 i datës 26.01.2023.....	70
27. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 26/22 i datës 21.03.2023.....	71
28. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 378/2022 i datës 14.04.2023.....	73
29. Aktvendimi K.DH.Shk II.nr. 36/23 i datës 10.05.2023.....	75
30. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1342/2022 i datës 22.05.2023.....	77
31. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1320/22 i datës 16.06.2023.....	79
32. Aktvendimi K.Dh.Sh.II.nr. 355/23 i datës 19.06.2023.....	81
33. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 179/23 i datës 05.07.2023.....	83
34. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 175/23 i datës 07.07.2023.....	85
35. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1709/22 i datës 24.08.2023.....	87
36. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 993/23 i datës 20.09.2023.....	89
37. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1398/2022 i datës 28.09.2023.....	91
38. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 905/23 i datës 02.10.2023.....	93
KAPITULLI VI.....	95
GARANÇIONI FINANCIAR.....	95
39. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1420/2022 i datës 02.11.2022.....	96
40. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1432/2022 i datës 15.11.2022.....	98
41. Aktvendimi K.DH.Shk II.nr. 1402/22 i datës 04.04.2023.....	100
42. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 402/2022 i datës 26.04.2023.....	102
43. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 489/23 i datës 24.08.2023.....	104
KAPITULLI VII.....	107
CAKTIMI I RADHËS SË DEBITORËVE.....	107
44. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 772/22 i datës 17.05.2023.....	108
45. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 366/23 i datës 01.06.2023.....	110
KAPITULLI VIII.....	113
KUSHTET LIGJORE PËR PËRSHTATSHMËRINË E FATURAVE.....	113
46. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 328/22 i datës 27.10.2022.....	114
47. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1282/22 i datës 15.11.2022.....	116
48. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 89/22 i datës 04.01.2023.....	118
49. Aktvendimi Kom Dh.Shk.II.nr. 435/22 i datës 15.02.2023.....	121
50. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1274/22 i datës 17.05.2023.....	123

51. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 173/2023 i datës 01.06.2023.....	125
52. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 336/23 i datës 18.07.2023.....	127
53. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 808/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 28.08.2023.....	128
54. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 745/22 i datës 14.04.2023.....	130
KAPITULLI IX.....	133
KUSHTET PËR PËRMBARIM.....	133
55. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 1233/2022 i datës 23.08.2022.....	134
56. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 748/22 i datës 01.09.2022.....	136
57. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 387/22 i datës 20.12.2022.....	137
58. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 708/22 i datës 07.04.2023.....	139
59. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 315/22 i datës 24.04.2023.....	141
60. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 496/23 i datës 10.05.2023.....	143
61. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 735/22 i datës 10.05.2023.....	144
62. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 353/23 i datës 22.05.2023.....	146
63. Aktvendimi K.DH.Shk.II.nr. 220/2023 i datës 01.06.2023.....	148
64. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 368/22 i datës 05.06.2023.....	149
65. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 346/23 i datës 06.06.2023.....	151
66. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 251/23 i datës 05.09.2023.....	153
67. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1447/22 i datës 29.09.2023.....	155
68. Aktvendimi K.Dh.shk.II.nr. 890/23 i datës 10.10.2023.....	157
69. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 909/23 i datës 16.10.2023.....	159
70. Aktvendimi K.Dh.Shk.II.nr. 888/2023 i datës 17.10.2023.....	161
71. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 906/23 i datës 17.10.2023.....	163



**KAPITULLI I
PARASHKRIMI**

1. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 880/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 23.10.2023.

Gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret, ka parashkrim të pjesërishëm të borxhit për shkak se pagesat e kohëpaskohshme të debitorit, nuk e kanë ndërprerë parashkrimin e tërë borxhit. Gjykata ka theksuar se duhet të vlerësohet faturimi dhe pagesat e bëra për periudhën e caktuar kohore dhe në këtë rast pagesat e bëra brenda periudhës së caktuar nuk e tejkalojnë borxhin për periudhën e njejtë për çka këto pagesa nuk e kanë ndërprerë parashkrimin e borxhit për tërë periudhën.

Kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstraktit të verifikuar nga librat afaristë të kontabilitetit.

Përmbaruesi Privat sipas propozimit të kreditorit, me Urdhrin Përmbarimor P.nr. 158/20 të datës 25.02.2020, ka lejuar përmbarimin në shumën 1618.08€, me kamatë ligjore prej 8%, nga rënia në vonesë, e deri në ditën e pagesës definitive, si dhe tërë shpenzimet e procedurës përmbarimore për borxhin i cili përfshinë periudhën 01.01.2009 deri 31.01.2020.

Kundër Urdhrit Përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim, duke theksuar se kërkesa e kreditorit e specifikuar si në ekstraktin e verifikuar nga libri afarist i kontabilitetit, nuk është i rregullt pasi që nuk është i protokolluar dhe i padatur, përveç kësaj, në kohën kur kërkesat e kreditorit janë krijuar dhe janë bërë të kërkueshme nuk janë kërkuar që të përmbushen nga kreditori brenda afatit prej 3 vite të përcaktuar sipas LMD-së atëherë kemi të bëjmë me kërkesa të parashkuara për çka ka kërkuar të aprovohet prapësimi dhe të anulohet urdhëri për përmbarim.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara. Tutje, ka shtuar se sa i përket pretendimit se borxhi është parashkuar është i pabazuar për shkak se duke u bazuar në kartelën financiare të debitorit, vërehet se debitori ka kryer pagesa të kohëpaskohshme të borxhit.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Parë, me Aktvendimin KPP. nr. 459/22 të datës 25.02.2020, ka aprovuar si të bazuar pjesërisht prapësimin e debitorit, dhe ka shfuqizuar pjesërisht Urdhrin Përmbarimor P.nr. 158/20 të Përmbaruesit Privat, të datës 25.02.2020.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit sa i përket parashkrimit të kërkesës, dhe këtë pretendim e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar duke u mbështetur në Nenin 355 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili ka përcaktuar se:

“1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite.

2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”.

Gjykata konstatoi se afati i parashkrimit rrjedhë për secilin shërbim të kryer veç e veç prandaj për të bërë llogaritjen e shumës për të cilin obligohet debitori ti përmbush kreditorit bëri llogaritjen e tri viteve paraprak nga data kur kreditori ka iniciuar procedurën përmbarimore për çka gjeti se borxhi për periudhën nga data 01.01.2009 deri më 25.02.2017, me të cilin ngarkohet debitori, është borxh i parashkruar.

Sa i përket borxhit në shumë prej 234.36 € për periudhën kohore nga data 26.02.2017 e gjerë me 31.01.2020 gjykata vlerësoj se nuk ka vjetërsim të borxhit për këtë periudhë kohore, meqenëse debitori për këtë periudhë kohore ka realizuar pagesa në shumë prej 220.00 € e nga kjo rezulton se shuma e mbetur për tu paguar është 14.36 €. Gjykata ka theksuar se pasi që kreditori ka kërkuar realizimin e shumës së faturuar për një periudhë të caktuar kohore, gjykata konstatoi se duhet të vlerësohet faturimi dhe pagesat e bëra, nga e cila rezultojë se shuma prej 234.36 € nuk tejkalon borxhin e debitorit ndaj kreditorit për periudhën 26.02.2017 e gjerë me 31.01.2020.

Deri tek ky konstatim gjykata erdhi duke llogaritur faturimet e bëra nga data 26.02.2017 e gjerë me 31.01.2020 që përfshijnë 36 fatura apo shumën prej 234.36 € dhe pagesat e bëra për të njëjtën periudhë e që përfshijnë 13 pagesa apo shumën prej 220.00 €, të gjitha këto të evidentuara në ekstraktin Kartela e Konsumatorit të datës 13.02.2020 lëshuar në emër të debitorit.

Kundër këtij aktvendimi, kreditori në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ankesën e debitorit ta aprovojë në tërësi si të bazuar, ta ndryshojë aktvendimin e ankimuar, dhe ta lë në fuqi Urdhrin Përmbarimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 880/23, të datës 23.10.2023, ka refuzuar të pathemeltë ankesën e kreditorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin KPP.nr. 459/22 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Parë, të datës 25.02.2020.

2. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 379/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 22.02.2023.

E drejta e kreditorit për ta kërkuar pagesën e borxhit nga debitori nuk është parashkruar, për arsye se debitori ka lidhur kontratë për pagesën e borxhit dhe ka nënshkruar deklaratë mbi dakordimin e borxhit. Si rrjedhojë, është shkaktuar ndërprerja e parashkrimit.

Kreditorja, me datë 19.12.2018 ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm - ekstraktit të verifikuar nga librat afaristë për pagesat e shërbimeve komunale, për shumën përkatëse me kamatë 8% nga dita e kalimit të afatit për pagesë deri në pagesën definitive të borxhit.

Kundër Urdhrit Përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 27.12.2018, me të cilën ka propozuar që të aprovohet prapësimi, dhe të shfuqizohet urdhri për përmbarim, pasi që një kërkesë e tillë është parashkruar sipas dispozitave të LMD-së.

Me përgjigje në prapësim të datës 11.01.2019, kreditori ka theksuar se pretendimi i debitorit është i paargumentuar dhe i pabazuar, andaj ka propozuar që të mbetet në fuqi Urdhri i Përmbaruesit Privat për caktimin e përmbarimit.

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, me Aktvendimin CPP.nr. 33/19, të datës 25.02.2019, ka vendosur të refuzojë si të pabazuar prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbarim P.nr. 1495/18, të datës 19.12.2018, të lëshuar nga Përmbaruesi Privat, dhe ka lënë në fuqi urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr. 1495/18, të datës 19.12.2018. Kundër këtij aktvendimi, debitori ka paraqitur ankesë.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së kreditorit, me Aktvendimin Ac.nr. 254/19 të datës 02.08.2019, ka aprovuar të njëjtën dhe ia ka kthyer gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje këtë çështje.

Gjykata e shkallës së parë, në ri procedurë, pas vlerësimit të prapësimin, me Aktvendimin CPP.nr. 70/20, e datës 04.03.2019, ka vendosur që ta refuzojë në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit, të paraqitur kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr. 1495/18, të datës 19.12.2018. Kjo gjykatë ka theksuar se në rastin konkret nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet ligjore të parapara me Nenin 71 të LPP-së për aprovimin e prapësimin.

Gjykata ka arsyetuar se lidhur me pretendimet e debitorit për parashkrimin e borxhit të njëjtat nuk janë të bazuara pasi që palët ndërgjyqëse kanë lidhur kontratën për pagesën e borxhit dhe deklaratën për dakordimin e borxhit, me çka ka ardhur edhe deri te ndërprerja e parashkrimit në kuptim të dispozitës së Nenit 368 të LMD-së, ndërsa duke marrë parasysh datën e dorëzimit të propozimit për përmbarim nga kreditori tek Përmbaruesi Privat 19.12.2018, rezulton se nuk ka kaluar afati 1 vjeçar i paraparë me dispozitën e Nenit 360 të LMD-së.

Kundër këtij aktvendimi, debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, me propozim që të anulohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të anulohet Urdhri Përmbartimor dhe debitori të lirohet nga detyrimi për borxhin pasi që ka të bëj me një borxh paushall të kërkuar nga kreditori dhe i cili është parashkruar. Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr. 379/22, të datës 22.02.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin CPP.nr. 33/19 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, të datës 25.02.2019.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, është konstatuar qartë se përmbartimi është lejuar në bazë të Ekstraktit të verifikuar nga librat afaristë, të lëshuar nga kreditorja, i cili në bazë të Nenit 29 paragrafi 1 pika 1.2 e LPP-së, ka cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe se i njëjti si i tillë paraqet bazë juridike, për caktimin e përmbartimit, ashtu siç përcaktohet me Nenin 21 së të njëjtit ligj. Ekstrakti i dorëzuar është në origjinal, i njëjti është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, dhe nga ajo mund të dihet qartë kërkesa dhe shuma që duhet të realizohet.

Edhe sipas kësaj gjykate, debitori me anë të prapësimit nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilën do të argumentonte ndonjërin nga shkaqet e parapara me Nenin 71 të LPP-së.

Lidhur me çështjen e parashkrimit, Dhoma e Shkallës së Dytë ka ardhur në përfundimin se gjykata e shkallës së parë ka aplikuar drejt të drejtën materiale dhe ka vërtetuar se e drejta e kreditores për ta kërkuar pagesën e borxhit nga debitorit nuk është parashkruar, për arsye se debitori ka lidhur kontratën për pagesën e borxhit dhe deklaratën mbi dakordimin e borxhit me datë 25.08.2017, ndërsa të njëjtës nuk i është përmbajtur, e me të cilën kontratë të lartcekur ex lege ka shkaktuar ndërprerjen e parashkrimit me Nenin 368 par. 1 të LMD-së, i cili ka përcaktuar qartë se: “Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”.

3. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 71/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 25.05.2023.

Me realizimin e kohëpaskohshëm të pagesave pa ndonjë përshkrim, konsiderohet se debitori ka pranuar borxhin ndaj kreditorit, fakt ky i cili shkakton ndërprerjen e afatit të parashkrimit. Si rezultat, debitori nuk mund të thirret në parashkrimin e kërkesës.

Kreditori me datën 20.11.2019, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstraktit të verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit, për përmbushjen e detyrimeve, për periudhën kohore prej datës 01.01.2004 deri më datë 31.10.2019.

Përmbaruesi Privat, sipas propozimit të kreditorit, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.951/19 të datës 20.11.2019, ka lejuar përmbarimin, me të cilën është detyruar debitori që kreditorit në emër të detyrimit në lidhje me marrjen e shërbimit për heqjen e mbeturinave t'i paguajë shumën prej 2,287.98 euro, për periudhën prej 01.01.2004 - 31.10.2019, me kamatën prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër këtij Urdhri Përmbarimor, debitori ka ushtruar prapësim me pretendimin se realizimi i kredisë së kërkuar, është i pamundshëm, për shkak se borxhi i kërkuar është parashkruar. Ndërkaq, për periudhën kohore pas vitit 2016, debitori ka pretenduar se në prapësim ka bashkëngjitur prova të cilat dëshmojnë se ky i fundit ka përmbushur detyrimet e tij ndaj kreditorit.

Duke vepruar sipas këtij prapësimi, kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim në të cilin ka kontestuar në tërësi deklaratimet e debitorit, duke theksuar se provat e paraqitura nga debitori janë vetëm urdhra obligimi për pagesë, porse nuk dëshmojnë se janë ekzekutuar pagesat. Lidhur me parashkrimin, kreditori i është referuar Nenit 368 par. 2 të LMD-së mbi pranimin e borxhit, duke shtuar se debitori kohë pas kohe ka realizuar pagesa në llogari të kreditorit, dhe për këtë arsye debitori nuk mund të thirret në parashkrim.

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, përmes Aktvendimit PPP.nr.22/20 të datës 106.02.2020, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbarimor.

Sipas arsyesimit të ofruar nga kjo Gjykatë, debitori ka realizuar pagesa të njëpasnjëshme për secilin vit kalendarik ndaj debitorit, edhe për periudhën kohore 2004 – 2019 për të cilën kreditori ka kërkuar përmbushjen e detyrimeve nga debitori, ky i fundit ka pohuar borxhin ndaj kreditorit, me çka është ndërprere parashkrim, dhe si rrjedhojë pretendimi i debitorit mbi parashkrimin e borxhit, është ligjërisht i paqëndrueshëm.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur ankesë me pretendimet e njëjta sikurse në prapësim, dhe me propozimin që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë në tërësi ankesën e ushtruar dhe aktvendimin e ankimuar ta anulojë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.71/22, të datës 25.05.2023, ka refuzuar si të pathemeltë ankesën e debitorit, duke vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 22/20 e Gjykatës Themelore në Prizren, të datës 06.02.2020.

Lidhur me çështjen parashkrimin, Gjykata e shkallës së dytë ka përkrahur në tërësi vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, duke konstatuar se marrë parasysh faktin se nga ekstrakti i verifikuar nga libri afarist i kontabilitetit, debitori ka bërë pagesa të kohëpaskohshme, rezulton se debitori e ka pohuar borxhin e tij ndaj kreditorit, për pasojë në rastin konkret nuk kemi parashkrim të kërkesës, pasi që me pagesën e kohëpaskohshme të borxhit, debitori ka ndërprerë afatin e parashkrimit.

4. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1246/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 25.05.2023.

Pretendimet lidhur me parashkrimin e borxhit të paraqitura me rastin e ushtrimit të ankesës, do të konsiderohen si të palejueshme, në rast se të njëjtat nuk janë paraqitur me rastin e ushtrimit të prapësimit, sipas Nenit 180 par. 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm -Faturës së datës 05.08.2020.

Përmbaruesi Privat sipas propozimit të kreditorit, me Urdhrit Përmbarimor P.nr.4/21, të datës 13.01.2021 ka lejuar përmbarimin, me të cilën është detyruar debitori që kreditorit në emër të borxhit nga faturat t'ia paguajë shumën përkatëse si dhe kamatëvonesën prej 8%, duke e llogaritur që nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër Urdhrit Përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim duke arsyetuar se për shkak të pandemisë janë anuluar dasmat dhe ka kërkuar nga kreditori që të jep një afat shtesë prej 6 muajve derisa të fillon puna si biznes andaj ka kërkuar nga gjykata që të ketë parasysh këtë prapësim.

Gjykata Themelore në Pejë me Aktvendimin Ep.nr. 22/21 e datës 02.11.2021, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.4/21, të datës 13.01.2021 të Përmbaruesit Privat.

Gjykata ka theksuar se përmbarimi është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm, të paraqitur në origjinal, e cila është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit dhe rrjedhimisht të njëjtat paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori me arsyetimin se borxhi i kërkuar është parashkruar përkitazi me Nenin 360 par. 1 dhe 1.1 të LMD-së, dhe Nenin 71 par. 1.4 të LPP-së, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën si të bazuar, aktvendimin e shkallës së parë ta prishë dhe lëndën ta kthejë në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit, të datës 25.05.2023, ka refuzuar të pabazuar ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin Ep.nr. 22/21 e Gjykatës Themelore në Pejë, të datës 02.11.2021.

Lidhur me pretendimet e debitorit referuar Nenit 360 të LMD-së sa i përket përshtetimit të borxhit, gjykata ankimore ka vlerësuar se pretendimet e tilla janë të palejueshme pasi debitori këto pretendime nuk i ka paraqitur me rastin e paraqitjes së prapësimit, andaj, në bazë të Nenit 180.3 të LPK-së *“Prapësimi i parashkrimit dhe prapësimi me qëllim kompensimi, që nuk janë paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten me ankesë”*.

Megjithatë edhe nëse do të shqyrtohej një pretendim i tillë i një borxhi të tillë nuk është parashkruar pasi që debitori përpos se nuk e kundërshton një borxh të tillë, edhe në bazë të dispozitave ligjore nga Neni 355 të LMD-së parashihet që:

“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite,

Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar se në bazë të dokumentit të besueshëm - faturave të cilat kreditori i ka bashkangjitur me rastin e ushtrimit të propozimit për përmbarim, janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përmbarimit të propozuar nga kreditori, ngase faturat e datës 05.08.2020, ligjërisht paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarimit sepse të njëjtat janë pranuar nga debitori, prandaj pretendimet e debitorit se shkresat e lëndës nuk më janë dorëzuar asnjëherë nuk qëndrojnë sepse faturat e kreditorit janë të pranuar, nënshkruara si dhe të vulosura nga vet debitori, ndërsa nga shkresat në lëndë përkatësisht fletë-kthesat në lëndë del se debitori ka pranuar edhe shkresat tjera të lëndës, prandaj edhe kjo gjykatë vlerëson se debitori ne rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij konform Nenit 69 par. 5 të LPP-së, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga Neni 71 i LPP-së.

5. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 137/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 10.07.2023.

Realizimi i pagesave të herëpashershme nga debitori ndaj kreditorit, pa specifikuar faturën, ka çuar në ndërprerjen e afatit të parashkrimit dhe fillimin e një afati të ri të parashkrimit. Gjithashtu, fakti që debitori ka kryer pagesa të kohëpaskohshme, tregon se ai ishte i vetëdijshëm për detyrimin e përbushjes mujore të shërbimit sipas ekstrakteve përkatëse. Prandaj, pretendimi se nuk ka marrë asnjë shërbim nga kreditori, është i paqëndrueshëm.

Kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm - ekstraktit të verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit.

Përmbaruesi Privat, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.83/21 të datës 05.01.2021, ka lejuar përmbarimin, me të cilin ka detyruar debitorin që kreditorit në emër të detyrimit në lidhje me marrjen e shërbimit për heqjen e mbeturinave, t'i paguaj shumën përkatëse, me kamatën prej 8% nga kalimi i afatit për pagesë deri në pagesën definitive.

Kundër Urdhrit Përmbarimor, debitori ka paraqitur prapësim, duke theksuar se ka arritur parashkrimi sipas Nenit 360 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të LMD-së, me propozimin që gjykata ta pranojë prapësimin, dhe si rrjedhojë ta shfuqizoj Urdhrin Përmbarimor për shkak të parashkrimit.

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm Civil, pas vlerësimit të prapësimin, ka nxjerrë Aktvendimin Ep.nr.36/21 të datës 01.06.2021, përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Në arsyetimin e këtij vendimi, Gjykata ka theksuar se sipas Nenit 374 të LMD-së të vitit 1978 ish RFSJ-së i aplikueshëm deri me datën 31.12.2012 dhe dispozitën ligjore të Nenit 355 të LMD-së (Ligji Nr.04/L-077) është përcaktuar se kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri vite, parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, punë ose shërbim të kryer, për arsye se në rastin konkret me pagesat e bëra nga debitori e të fundit të datës 09.12.2020, ka ardhur deri të ndërprerja e parashkrimit duke filluar afati i ri i parashkrimit. Kështu, nga koha e pagesës së fundit nga ana e debitorit me datë 09.12.2020 e deri te paraqitja e propozimit për përmbarim nga ana e kreditorit me datën 05.01.2021 nuk ka kaluar afati ligjor prej 3 vite i paraparë me Nenin 355 të LMD-së.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor debitori ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ndër të tjera, në ankesën e paraqitur, debitori ka pretenduar se mes tij dhe kreditorit nuk ka ndonjë raport kontraktual të lidhur, kreditori asnjëherë nuk i ka kryer ndonjë shërbim debitorit, dhe se as nuk i ka faturuar ndonjëherë ndonjë shërbim.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.137/23, të datës 10.07.2023, ka refuzuar si të pathemeltë ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin EP.nr. 36/21 e Gjykatës Themelore në Pejë, të datës 01.06.2021.

Kjo Gjykatë, ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj ka pranuar konkludimin e Gjykatës së shkallës së parë lidhur me këtë çështje përmbarimore.

Lidhur me pretendimin ankimor të debitorit për mungesën e një raporti kontraktual në mes të palëve, Gjykata ka vlerësuar se një pretendim i tillë është i paqëndrueshëm, për faktin se nga ekstraktet të cilat gjinden në shkresat e lëndës, rezulton se debitori edhe më parë ka realizuar pagesa për shërbimet e marra nga kreditori, dhe atë në mënyrë të herëpashershme, si rrjedhojë debitori ka qenë i vetëdijshëm për detyrimin e përbushjes mujore të shërbimit sipas ekstrakteve përkatëse.

Gjykata e shkallës së dytë ka theksuar për debitorin se nëse për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon kreditori kërkon përmbarimin e detyrimit pa ndonjë bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht mund t'i shkactohet dëm me rastin e kryerjes së përmbarimit, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë pretendim debitori të drejtën e tij ta realizojë në kontest të rregullt civil, pasi që një pretendim i tillë, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit.

6. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 419/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 17.07.2023.

Realizimi i një pagese të paspecifikuar nga ana e debitorit, ka ndërprerë afatin e parashkrimit, dhe për pasojë, afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë përsëri nga fillimi, dhe përmes këtij fakti konsiderohet se debitori ka pranuar borxhin.

Kreditori me datën 05.01.2021, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstraktit të verifikuar.

Përmbaruesi Privat, sipas propozimit të kreditorit me Urdhrit Përmbarimor P.nr. 113/2021 të datës 05.01.2021, ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit, për pagesën e borxhit në emër të shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave, për periudhën kohore nga data 31.07.2007 deri me datën 30.11.2020, në shumën përkatëse.

Kundër Urdhrit Përmbarimor debitori me datën 13.01.2021 ka ushtruar prapësim duke pretenduar se kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit lëndor nga Neni 360 të LMD-së.

Gjykata Themelore në Pejë me Aktvendimin Ep.nr. 48/21 e datës 01.06.2021, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të parashtruar kundër Urdhrit Përmbarimor të Përmbaruesit Privat, P.nr. 113/21 të datës 05.01.2021.

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata ka refuzuar si të pabazuara pretendimet e debitorit për parashkrimin e borxhit, ngase duke iu referuar ekstraktit të verifikuar nga librat afaristë për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave, është vërtetuar se debitori ka bërë pagesa të kohëpaskohshme të borxhit, të paspecifikuara, dhe atë të fundit e ka realizuar me datën 31.07.2018, e cila pagesë ka ndikuar që të vie deri te ndërprerja dhe fillimi i rrjedhjes së afatit të ri të parashkrimit, dhe rrjedhimisht, edhe pranimin e borxhit nga ana e debitorit. Meqenëse që nga koha e pagesës së fundit nga debitori të realizuar me datë 31.07.2018 e deri të paraqitja e propozimit për përmbarim nga kreditori – datë 05.01.2020, nuk ka kaluar afati ligjor prej tre (3) viteve i paraparë me Nenin 355 të LMD-së, gjykata ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar. Sipas kësaj gjykate, në këtë rast vlen afati i përcaktuar me Nenin 355 të LMD-së, dhe jo afati i parashkrimit, i caktuar me Nenin 360 të LMD-së, ashtu siç ka pretenduar debitori.

Debitori kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë me pretendimet e njëjta, me propozimin që gjykata e apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, në mënyrë që çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, si dhe ta pezullojë ekzekutimin derisa gjykata e shkallës së parë në shqyrtim verbal të vendosë lidhur me prapësimin e ushtruar.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomë e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 419/23, të datës 17.07.2023, ka refuzuar të pathemeltë ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin Ep.nr. 48/2021 e Gjykatës Themelore në Pejë, të datës 01.06.2021. Gjykata ankimore nuk ka pranuar të bazuara pretendimin e debitorit se është arritur parashkrimi i borxhit konform Neni 360 të LMD-së, pasi që në rastin konkret vie në shprehje Neni 355 i LMD-së, i cili rregullon parashkrimin e kërkesave reciproke të cilat krijohen përmes kontratave komerciale.

7.Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 1317/2022 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 09.09.2022.

Pagesat e kohëpaskohshme të realizuara nga debitori për borxhe të papërcaktuara, nuk duhet të trajtohen si këste, të cilat të mund të konsiderohen pohim i borxhit, dhe rrjedhimisht këto pagesa të realizuara nuk mund të shkaktjnë ndërprerjen e parashkrimit.

Kreditori me datë 26.11.2018, pranë gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktit nga librat afarist.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, me Urdhrin Përmbarimor P.nr. 942/18 të datës 27.11.2018, ka lejuar përmbarimin, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm – Ekstrakti nga librat afarist, plotëson kushtet ligjore për përmbarim.

Ndaj këtij urdhri, debitori me datë 10.12.2018, ka paraqitur prapsim me propozim për gjykatën që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit si i bazuar, dhe të refuzohet në tërësi propozimi për përmbarim i kreditorit dhe të anulohet Urdhri Përmbarimor P.nr. 942/18, i datës 27.11.2018, në kuptim të Nenit 43.4 të LPP –së, për shkak të parashkrimit të kërkesave.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke theksuar që prapësimi i debitorit është i pa argumentuar andaj ka propozuar që urdhri të mbetet në fuqi dhe nëse gjykata edhe pas përgjigjes në prapësim nga kreditori nuk është qartësuar lidhur me validitetin e përgjigjes së kreditorit në kuptim të Nenit 73 të LPP –së, të hapë seancë publike.

Gjykata Themelore në Pejë, me Aktvendimin Ep.nr.717/2019 të datës 03.11.2020, ka refuzuar ti të pabazuar prapësimin e debitorit duke lënë në fuqi Urdhrin Përmbarimor P.nr.942/18 të Përmbaruesit Privat, të datës 27.11.2018.

Pretendimet e debitorit se borxhi i kërkuar sipas dokumentit të besueshëm është i parashkuar, gjykata i ka refuzuar si të pa bazuara, për faktin se debitori ka bërë pagesa të kohëpaskohshme të borxhit të cilat kanë ndikuar në ndërprerjen e parashkrimit dhe rrjedhimisht edhe pranimin e borxhit nga ana e debitorit. Andaj, gjykata nuk i ka pranuar pretendimet e debitorit që gjykata është dashur t'i zbatojë dispozitat e Nenit 360 par 1 pika 1.1 dhe 2 të LMD –së, për arsye se në rastin konkret me pagesat e bëra nga debitori, dhe atë të fundit të datës 01.11.2018 kanë krijuar si rezultat ndërprerjen e parashkrimit. Gjykata ka theksuar faktin se propozimi i kreditorit për përmbarim është parashtruar me datë 26.11.2018, ende pa kaluar afati 1 vjeçar i përcaktuar me Nenin 360 të LMD –së, nga koha e fillimit të afatit të ri të parashkrimit, dhe atë duke u bazuar në dispozitën ligjore nga Neni 368 dhe 373 par. 6 të LMD –së.

Në rastin konkret, gjykata ka theksuar se vlen afati një vjeçar i parashkrimit për kërkesat e parashtruara në këtë rast konkret.

Kundër këtij aktvendimi, debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë, me propozimin që të aprovohet në tërësi ankesa e tij, të ndryshohet aktvendimi i atakuar dhe të refuzohet në tërësi propozimi për përmbarim për shkak të parashkrimit, ose të aprovohet ankesa si e bazuar, dhe të anulohet aktvendimi i kundërshtuar ashtu që çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr.1317/2022 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, të datës 09.09.2022 është aprovuar si e themeltë ankesa e debitorit, dhe është prishur Aktvendimi Ep.nr. 717/2019 i Gjykatës Themelore në Pejë, i datës 03.11.2020, duke u kthyer çështja në rishqyrtim dhe rivendosje pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Parë.

Sipas gjykatës ankimore, arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë se në këtë rast kemi pohim të borxhit nga ana e debitorit për shkak të pagesës së kohëpaskohshme, është i pathemeltë, për shkak se në këtë rast nuk bëhet fjalë për dhënien e kësteve, ngase pagesat e kohëpaskohshme të debitorit nuk mund të konsiderohen këste. Ato pagesa janë të papërcaktuara në shumat që dallojnë njëra nga tjetra dhe nuk lënë të kuptohet se për cilën periudhë debitori ka paguar borxhin, po ashtu në mes të palëve ndërgjyqësore nuk ka ekzistuar ndonjë marrëveshje që borxhi të paguhet me këste ose së paku në shkresa të lëndës nuk ekziston një dëshmi e tillë.

Për më tepër, gjykata ankimore ka vlerësuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike për nevojat shtëpiake, të cilat konform Nenit 360 të LMD –së, parashkruhen në afat një vjeçar, por kemi të bëjmë me raport komercial, pra kemi kreditorin si operator i cili ofron shërbime publike dhe debitorin si person juridik.

Nga kjo rrjedhë që gjykata gabimisht parashkrimin e ka vlerësuar në kuptim me Nenin 360 të LMD-së. E njëjta është dashur që institutin e parashkrimit ta vlerësoj në raport me Nenin 355 të LMD –së, i cili përcakton se: “Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”.

Megjithatë, ky vlerësim i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së , nuk është i unifikuar në praktikën gjyqësore të gjertanishme. Një vendosje ndryshe e kësaj gjykate lidhur me çështjen e ndërprerjes së parashkrimit, haset në Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.880/23 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, të datës 23.10.2023, ashtu siç haset vendosje ndryshe edhe në Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.71/22 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, të datës 25.05.2023, të cilat janë përfshirë më lartë në këtë përmbledhje.



KAPITULLI II

URDHRAT PËR SHITJE

8. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 63/2022 i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, i datës 25.08.2022.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka kompetencë të vendosë sipas ankesës së palës, të ushtruar kundër vendimit të gjykatës mbi të cilin është vendosur fati ligjor i prapësimit, përkitazi me Nenin 77 të LPP-së. Kjo kompetencë i takon vetëm gjykatës së shkallës së dytë.

Kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës, për kryerjen e shërbimeve për shitjen e shtyllave të betonit. Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të paraqitur nga kreditori, ka lejuar përmbarimin me Urdhrin Përmbarimor P.nr.147/2018, të datës 20.11.2018. Kundër këtij Urdhri Përmbarimor, debitori ka ushtruar prapësim.

Gjykata e shkallës së parë përmes Aktvendimit PP.nr.125/2018, të datës 19.01.2019, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbarimor.

Kundër këtij aktvendimi debitori ka ushtruar ankesë me pretendimin se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje, dhe se Urdhri Përmbarimor është lëshuar mbi bazën e një dokumenti të paqëndrueshëm, e të cilin supozohet ta këtë nënshkruar një personi i paautorizuar, e ku ndaj tij është iniciuar procedura penale.

Pas pranimit të ankesës, me datë 21.03.2019 gjykata e shkallës së parë ka marrë Aktvendimin PP.nr.125/2018 me të cilin në Pikën I të dispozitivit ka shfuqizuar aktvendimin paraprak të datës 11.02.2019 dhe njëkohësisht ka anuluar të gjitha pasojat juridike të prodhuara nga çasti i lëshimit të tij, ndërsa në Pikën II të dispozitivit i ka mundësuar debitorit që të ushtrojë ankesë pa paguar garancinë.

Kundër Aktvendimit PP.nr.125/2018, të datës 21.03.2019, kreditori ka ushtruar ankesë, me propozimin që gjykata e shkallës së dytë, të aprovojë si të bazuar këtë ankesë dhe të anulojë aktvendimin e ankimuar, dhe të lë në fuqi Aktvendimin PP.nr.125/2018, të datës 19.01.2019, dhe Aktvendimin PP.nr.125/2018, të datës 11.02.2019.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr.63/2022, të datës 25.08.2022, ka aprovuar si të themeltë ankesën e parashtuar nga debitori dhe ankesën e parashtuar nga kreditori, ku si rrjedhojë ka anuluar Aktvendimet PP.nr. 125/18 të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, të datës 19.01.2019 dhe 21.03.2019, dhe çështjen e ka kthyer në procedim të serishëm.

Gjykata Komerciale, vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta pranojë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se të dy aktvendimet e atakuar janë përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga Neni 182.2 pika (n) dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga Neni 183, paragrafi 1 të LPK-së

Sipas kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së parë nuk ka kompetencë që të anulojë vendimet e saja, përkatësisht të vendosë sipas ankesës së palës të paraqitur kundër vendimit të saj.

Kjo kompetencë në kuptim të Nenit 77 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, i takon vetëm gjykatës së shkallës së dytë, dhe në asnjë mënyrë nuk i takon gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së dytë ka konstatuar gjithashtu se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje me rastin e vendosjes sipas Aktvendimit PP.nr.125/2018 të datës 19.01.2019, kur ka vendosur që të refuzojë prapësimin e debitorit dhe të lë në fuqi Urdhrin Përmbarimor P.nr.147/2018 të datës 20.11.2018, pasi që nuk e ka vlerësuar në mënyrë të drejtë vërtetësinë e faturës të bashkëngjitur në propozimin për përmbarim.

Kjo pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se fatura derivon nga kontrata për shërbime të ndërmjetësimi, e lidhur në mes të debitorit dhe kreditorit, ku kontratën në emër të debitorit e ka nënshkruar personi X.X., deri sa nga certifikata e biznesit e lëshuar për kreditorin, rezulton se kreditori është biznes individual i regjistruar me datë 04.11.2009, me pronar Z.Z., i cili rezulton të jetë edhe person i vetëm autorizuar për biznesin e tij, deri sa personi i pretenduar X.X. nuk rezulton të ketë ndonjë autorizim në këtë biznes, e po ashtu nga shkresat e lëndës rezulton se për shkak të dyshimit të bazuar se me dashje ka kryer veprën penale falsifikim i dokumentit, duke nënshkruar pa autorizim kontratën nga e cila supozohet të derivon fatura ndaj X.X., është iniciuar edhe procedura penale dhe të njëjtit i është ngritur aktakuzë.

Për shkak të paqartësive lidhur me këtë faturë gjykata e shkallës së parë është udhëzuar që konform Nenit 73 të LPP-së, të hapë seancë dëgjimore për të kuptuar vlefshmërinë e prapësimi, dhe më pas të konstatojë nëse fatura i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm apo jo.

9. Aktvendimi K.DH.SHK.II.nr. 270/2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 06.06.2023.

Organi Përmbaues me rastin e vendosjes për kalimin e pronësisë së debitorit në emër të kreditorit, duhet të analizojë vlerën e caktuar të shitjes së paluajtshmërisë dhe vlerën e prestimeve të palëve, ashtu që të mos paraqitet disproporcion në mes të presimeve të palëve dhe vlerës së paluajtshmërisë.

Kreditori me datën 17.06.2016, ka ushtruar propozim për përmbarim ndaj debitorëve në bazë të dokumentit të besueshëm –Faturave.

Përmbauesi Privat, ka lejuar përmbarimin me Urdhrin Përmbarimor P.nr. 164/16 të datës 22.06.2016, me të cilin ka obliguar debitorin që kreditorit t’ia paguajë shumën e borxhit nga këto fatura në vlerën përkatëse, dhe në mungesë të mjeteve monetare në llogaritë bankare, përmbarimi i kreditorit të realizohet me regjistrim, vlerësim, sekuestrim dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme të debitorit. Në mungesë të sendeve të luajtshme, përmbarimi të realizohet me shënimin e përmbaimit në librin publik të paluajtshmërive, me përcaktimin e vlerës së paluajtshmërisë të cilat janë në emrin e debitorit, me shitjen e paluajtshmërisë që janë në emrin e debitorit dhe nga shuma e fituar nga shitja e sendeve të paluajtshme të paguhet shuma e borxhit, si dhe shpenzimet e përmbaimit.

Ndaj Urdhrit Përmbarimor prapësim ka ushtruar debitori për të cilin ka vendosur Gjykata Themelore në Ferizaj me Aktvendimin PPP.nr.77/2016 e datës 05.10.2018, për të cilin sipas ankesës ka vendosur Gjykata e Apelit me Aktvendimin Ac.nr.1238/2017 të datës 05.10.2018, duke vazhduar procedura më tej me ndërmarrjen e veprimeve procedurale nga Organi Përmbaues për shitjen publike të paluajtshmërisë, deri në nxjerrjen e urdhrit të atakuar.

Përmbauesi Privat, me Urdhrin P.nr. 151/20 e datës 08.07.2022 ka caktuar kalimin në pronësi të kreditorit $\frac{1}{2}$ e pjesës ideale të ngastrës kadastrale me të dhënat e saj, si dhe $\frac{1}{2}$ e pjesës ideale të ngastrës tjetër kadastrale me të dhënat përkatëse, të cilat janë aktualisht në shfrytëzim të pronarit - debitorit. Në pjesën e II-të të dispozitivit të këtij urdhri, Përmbauesi Privat i ka dorëzuar kreditorit paluajtshmëritë e përshkruara si në pikën I . Në pjesën e III-të të dispozitivit të këtij urdhri është urdhëruar Zyra Kadastrale që të bëjë regjistrimin e të drejtës së pronës në regjistrin e të drejtave të pronave të paluajtshme në emër të kreditorit për paluajtshmëritë si në pikën e I të dispozitivit, pasi të bëhet i formës së prerë ky urdhër.

Kundër këtij urdhri, brenda afatit ligjor debitorët kanë ushtruar ankesë, me propozimin që ky urdhër të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, pranë Organit Përmbaues të njëjtë.

Përgjigje në këto ankesa ka ushtruar kreditori, duke i kundërshtuar si të pabazuara pretendimet ankimore, me propozim që gjykata e shkallës së dytë t’i refuzojë si të pathemelta këto ankesa, urdhrin e shitjes ta lë në fuqi, dhe debitorin ta obligojë që kreditorit t’ia paguajë edhe shpenzimet për përgjigjen në ankesë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SHK.II.nr. 270/2023, të datës 06.06.2023, ka aprovuar të themeltë ankesën e debitorit, ka anuluar Urdhrin për Shitje P.nr. 151/20 të Përmbauesit Privat, të datës 08.07.2022, dhe ka kthyer çështjen në procedim të serishëm, pranë organit të njëjtë.

Sipas gjykatës ankimore, Organi Përmbaues ka bërë shkelje të dispozitave përmbauese kur i ka dorëzuar në pronësi paluajtshmerinë e debitorit duke e konsideruar këtu të përmbushur në tërësi kërkesën ndaj debitorit. Përmbauesi Privat referuar këtu dispozitave ligjore të Nenit 22 Ligjit nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit të Procedurës Përmbauese me të cilin është riformuluar Neni 234, ku në paragrafin 3 të këtij Neni është përcaktuar se:

“Ne qoftë se paluajtshmeria nuk ka mundur të shitet as në ankandin e dytë, atëherë me propozim të kreditorit, organi përmbaues merr vendim që paluajtshmeria t’i dorëzohet kreditorit duke kaluar në pronësi të tij me ç’rast edhe kërkesa ndaj debitorit konsiderohet e përmbushur në tërësi”.

Fakti se në seancën e ankandit të dytë të datës 08.06.2022, kreditori ka deklaruar se pasi nuk ka ofertues tjerë deri në këtë fazë, atëherë nuk ka ofertuar për blerjen e paluajtshmerisë - objekt i ankandit, por ka kërkuar që paluajtshmeritë e cekura në pikën I të dispozitivit të këtij urdhri, t’i dorëzohen në pronësi kreditorit. Organi Përmbaues me urdhër ka bërë kalimin e pronësisë se paluajtshmerisë se debitorit në kreditorin në shumën e propozuar nga kreditori.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka gjetur se organi përmbaues ka bërë shkelje të dispozitave ligjore, kjo sepse marrë parasysh vlerën e paluajtshmerisë së përcaktuar nga eksperti në ekspertizën e datës 15.11.2019 në vlerë prej 2,035,400.00 euro, organi përmbaues ka dorëzuar dhe kaluar në pronësi të kreditorit paluajtshmerinë për përmbushjen e detyrimit në tërësi në një shumë tjetër jo proporcionale në vlerë prej 88,647.86 euro. Gjykata ka gjetur se rezulton se kemi të bëjmë me disproporcion të presimeve në dëm të debitorit, sepse vlera e përcaktuar prej 88,647.86 euro nuk i përgjigjet dy të tretave të vlerës së përcaktuar të paluajtshmerisë të debitorit, ashtu siç do të duhej përkitazi me dispozitat ligjore në fuqi.

Lidhur me këtë çështje, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se organi përmbaues është dashur t’i referohet Nenit 247 par. 2 të LPP-së, i cili ka përcaktuar qartë se:

“Në rastin nga paragrafi 1 i këtij Neni, konsiderohet se kredia e kreditorit është përmbushur deri në shumën e cila i përgjigjet dy të tretave të vlerës së përcaktuar të paluajtshmerisë”.

10. Aktvendimi K.Dh.Shk.II.nr. 1266/2022 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 19.06.2023.

“Duke qenë se vlera e paluajtshmërisë është kontestuar në seancën e shitjes dhe është propozuar ekspertizë për caktimin e vlerës, organi përmbarues është dashur të caktojë ekspertizë përkatëse për caktimin e vlerës së paluajtshmërisë.”

Kreditori me datën 28.01.2020, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorëve në bazë të dokumentit përmbarues – Marrëveshjeve për Kredinë,7, Marrëveshjes mbi Pengun, Kontratës mbi themelimin e Hipotekës, dhe Aktvendimit mbi regjistrimin e Hipotekës, të lëshuar nga Zyra Komunale e Kadastrit, për shumën e detyrimit në vlerën përkatëse.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, me Urdhrin Përmbarimor P.nr. 89/20 të datës 29.01.2020, ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarimor.

Ndaj këtij urdhri debitorët e përmbarimit kanë parashtruar prapësim, ndaj të cilit kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësim.

Për prapësimin e debitorëve ka vendosur Gjykata Themelore në Gjakovë me Aktvendimin PPP.nr. 151/20, ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka prova se ndaj këtij aktvendimi është ushtruar ankesë në drejtim të Gjykatës së Apelit. Organi Përmbarues ka vazhduar më tej me procedurën e përmbarimit për shitjen publike të paluajtshmërisë deri në nxjerrjen e urdhrin të atakuar me ankesë.

Përmbaruesi Privat me urdhrin e atakuar P.nr. 89/20 të datës 28.10.2021, në Pjesën e I të dispozitivit të këtij urdhri ka konstatuar se kreditori, i janë shitur paluajtshmëritë e hipotekuara si ofertues i vetëm në ankandin e II-të verbal publik të mbajtur me datën 27.10.2021, ka ofertuar për: parcelë e evidentuar nga ngastrën kadastrale me të dhënat përkatëse, e evidentuar në emër të debitorit, në vlerën përkatëse, për përmbushjen e kredisë së kreditorit në vlerën përkatëse. Në pjesën e II-të të dispozitivit të këtij urdhri është përcaktuar se duke qenë se çmimi blerës i paluajtshmërive është më i madh se kredia e kreditorit, obligohet kreditori që pas plotfuqishmërisë së këtij urdhri, në afat prej 7 ditësh të depozitojë dallimin ndërmjet çmimit dhe kredisë së tij. Kjo diferencë duhet të paguhet në llogarinë e veçantë të organit përmbarues për t’iu kthyer më pastaj debitorit, përkatësisht hipoteklënësit. Në pjesën e III-të të dispozitivit të këtij urdhri, Përmbaruesi Privat ka shtuar se duke qenë se blerësi i sendit është kreditori, dhe nuk ekzistojnë persona të tjerë kreditë e të cilëve përmbushen para kredisë se tij nga çmimi me të cilin i është shitur paluajtshmëria, atëherë ai nuk është i detyruar ta depozitojë çmimin tek organi përmbarues që korrespondon me shumën e kredisë se tij, përveç vlerës së përcaktuar në pikën II të dispozitivit të këtij urdhri. Në pjesën e IV-të të dispozitivit të këtij urdhri, është urdhëruar debitorin që paluajtshmërinë e shënuar në Pikën e I-rë të këtij urdhri t’ia dorëzojë kreditorit në posedim dhe shfrytëzim në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij urdhri.

Në pjesën e V-të të dispozitivit të këtij urdhri, është urdhëruar Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër pranë Komunës përkatëse që pas plotfuqishmërisë së këtij urdhri, të bëjë ndryshimet në librat publik të paluajtshmërive ashtu që paluajtshmëria e shënuar në Pikën e I të këtij urdhri të regjistrohet në emër të kreditorit.

Kundër këtij urdhri, debitorët kanë ushtruar ankesë, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë në tërësi ankesën e debitorëve dhe Urdhrin për shitje ta prishë dhe ta obligojë kreditorin që t'ia kompensojë debitorit shumën në emër të përpilimit të ankesës. Debitorët kanë theksuar se në seancën e shitjes së paluajtshmërisë, të mbajtur me datë 27.10.2021, kanë kontestuar precizimin e borxhit, për faktin se ka qenë e paqartë se si ka ardhur deri te një vlerë e tillë e përcaktuar nga organi përmbarues dhe kreditori.

Përgjigje në ankesën e debitorëve ka ushtruar kreditori, me pretendimin së të gjitha veprimet përmbarimore janë në përputhje me dispozitat ligjore, andaj propozon që gjykata e shkallës së dytë ta refuzojë ankesën e debitorëve si të pabazuar ndërsa urdhri i shitjes të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.Dh.Shk.II.nr. 1266/2022, të datës 19.06.2023, ka aprovuar të themeltë ankesën e debitorëve, ka anuluar Urdhrin për Shitje P.nr. 89/20 të datës 28.10.2021, të Përmbaruesit Privat, dhe çështja është kthyer në procedim të serishëm para organit përmbarimor.

Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se në këtë rast organi përmbarues me rastin e vendosjes nuk ka trajtuar drejtë gjendjen e fakteve si dhe pretendimet e palës debitore, sepse nuk ka analizuar drejt dispozitat ligjore dhe atë Nenin 21 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore e cila dispozitë parasheh që *“Në rast të kontestimit të vlerës së paluajtshmërisë, të arritur nga palët para procedurës përmbarimore, organi përmbarues me propozim të palëve mund ta caktojë ekspertin përkatës për caktimin e vlerës së paluajtshmërisë”*, shtu kësaj pretendimin e palës debitore në seancën e datës 27.10.2021 kanë kontestuar precizimin e borxhit sepse nuk kanë ditur se si është bërë kalkulimi i kamatës se rregullt dhe asaj ndëshkuese si dhe metodologjia e saj, se nuk e dimë a është marrë për bazë rregullorja e BQK-së për kalkulimin e kamatëvonesave, dhe mbi këtë bazë debitorët kanë kërkuar ekspertizë financiare lidhur me precizimin e borxhit.

Organi Përmbarues nuk është lëshuar fare në trajtimin e kësaj kërkesë të palës debitore me rastin e vendosjes, ndërsa ka marrë Konkluzion që konform dispozitave të Nenit 242 të LPP-së do të nxjerrë Urdhër të veçantë për konstatimin se paluajtshmëria i është shitur blerësit të caktuar, andaj marrë parasysh këto arsye Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë ka vlerësuar se urdhri i atakuar anulohet, dhe kthehet sërish tek Organi Përmbarues.

Një vendosje të tillë të Gjykatës Komerciale - Dhomës së Shkallës së Dytë, do të mund ta gjeni edhe në Aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 322/23 të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, të datës 09.08.2023.

11. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 782/2022 i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, i datës 21.06.2023.

Nëse palët kanë caktuar vlerën e paluajtshmërisë në momentin e lidhjes së Kontratës Noteriale për Hipotekën, debitori nuk mund të kontestojë çmimin e përcaktuar të paluajtshmërisë, gjatë procedurës për shitjen e saj.

Kreditori, me datën 16.09.2019 ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbarimor - Kontratës për Hipotekë, të përpiluar dhe lidhur në zyrën e noterit, dhe të regjistruar në Zyrën Kadastrale përkatëse.

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.798/19 të datës 16.09.2019, ka lejuar përmbarimin në bazë të Kontratës për Hipotekën. Procedura përmbarimore ka vijuar tutje deri në nxjerrjen e konkluzioneve nga ana e Përmbaruesit Privat përmes të cilave është bërë konvokimi i seancave për shitjen e paluajtshmërive – objekt i përmbarimit

Organi përmbarues me datë 12.04.2021 ka nxjerrë Konkluzionin P.nr.798/19 për shitjen e parë të paluajtshmërisë. Ndërkaq me datën 12.04.2021 ka nxjerrë Konkluzion P.nr.798/19 për shitjen e dytë të paluajtshmërisë e cila është caktuar për datën 02.05.2021.

Me datë 28.04.2021, debitori ka paraqitur ankesë për parregullsi në procedurën përmbarimore duke theksuar se Përmbaruesi Privat ka vepruar në kundërshtim me Nenin 366 dhe 369 të LPP-së, pasi që në rastin konkret vlerësimi i pronës është kryer vetëm nga ana e kreditorit dhe atë me çdo kusht ta devalvojë dhe ulë çmimin e paluajtshmërisë së debitorit e cila kishte qenë objekt ankandi.

Andaj, debitori ka kërkuar që të anulohen të gjitha veprimet e deritanishme përmbarimore dhe konkluzioni P.nr.798/2019 i datës 12.04.2021, ashtu që të refuzohet kërkesa e kreditorit për caktimin e ankandit të II-të dhe tjetërsimin e pronës me çmimin e vlerësuar nga ana e kreditorit.

Gjykata Themelore në Pejë përmes Aktvendimit Ep.nr. 213/21, të datës 09.08.2021, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e debitorit, të paraqitur kundër veprimeve të Përmbaruesit Privat P.nr. 798/19 i datës 16.09.2019, me decedivisht duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij urdhri, debitori në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, me propozimin që të anulohet aktvendimi i kundërshtuar, ashtu që lënda të kthehet në riprocedim, ose të ndryshohet aktvendimi ashtu që të anulohen të gjitha veprimet e deritashme përmbarimore dhe konkluzioni P.nr.798/2019 i datës 12.04.2021, ashtu që të refuzohet kërkesa për caktimin e ankandit të II dhe tjetërsimit pronës me çmimin e vlerësuar nga ana e kreditorit, si dhe të detyrohet Përmbaruesi Privat që të caktojë ekspertize të paanshme dhe profesionale për caktimin e vlerës reale në treg të paluajtshmërisë kontestuese.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.782/2022, të datës 21.06.2023, ka refuzuar si të pathemeltë ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin Ep.nr.213/21 e Gjykatës Themelore në Pejë, të datës 09.08.2021.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me arsyetimin se duke u mbështetur në dispozitën e Nenit 220 të LPP-së përcaktohet se: *“Palët kanë të drejtë që me marrëveshje ta përcaktojnë vlerën e paluajtshmërisë”*, prandaj, duke u bazuar në këtë dispozitë, palët në këtë rast përmes Kontratës së Hipotekës, përkatësisht Nenit 3.4 të Kontratës mbi Themelimin e Hipotekës, të përpiluar dhe vërtetuar tek organi noterial, palët kishin përcaktuar vlerën e paluajtshmërive.

Kjo Gjykatë, pretendimet e debitorit lidhur me shitjen e paluajtshmërive për çmim më të vogël se vlera reale e tregut, i ka vlerësuar si të pabazuara, për arsye së shitja dhe çmimi minimal i ofertimit në procedurën përmbarimore janë përcaktuar me dispozitat e Nenit 22 të Ligjit për Plotësim dhe Ndryshim të LPP-së. Çmimin për shitjen e paluajtshmërisë, organi përmbarues, e cakton në seancën e parë të ankandit të shitjes së paluajtshmërisë, e cila shumë nuk mund të jetë nën 50% e vlerës së përcaktuar. Nëse paluajtshmëria nuk ka mundur të shitet në seancën e parë, organi përmbarues cakton seancën e dytë ku paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmim më të vogël se 1/3 e vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë.

Prandaj, kjo gjykatë vlerëson se procedura përmbarimore lidhur me këtë çështje përmbarimore lidhur me shitjen e paluajtshmërisë nuk ka pasur ndonjë parregullsi, të pretenduar nga debitori.

Megjithatë, një vendosje ndryshe e Gjykatës Komerciale të Kosovë – Dhomës së Shkallës së Dytë, haset në Aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 322/23 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, të datës 09.08.202 dhe në Aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 214/2023 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, të datës 22.09.2023.

12. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 340/2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 12.07.2023.

Përkundër insistimit të palëve që të caktohet çmimi i paluajtshmërive përmes një ekspertize financiare, Organi Përmbaues ka vazhduar tutje me shitjen dhe bartjen e paluajtshmërive në bazë të çmimit të përcaktuar nga vet palët, para se të fillonte procedura përmbaimore. Një veprim i tillë i Organit Përmbaimitor ka konsistuar në shkelje të dispozitave të LPP-së, pasi që Organi Përmbaimitor është dashur të caktojë ekspert përkatës për caktimin e saktë të vlerës së paluajtshmërisë.

Kreditori, me datën 29.04.2021, ka paraqitur propozim për përmbaimitor ndaj katër debitorëve në bazë të dokumentit përmbaimitor - Kontratës Kornizë për Biznes të datës 28.10.2016, Shtojcës së kësaj kontrate, Kontratës për Hipotekë të datës 31.10.2015, Aneks Kontratës mbi Hipotekën të datës 26.10.2017, Kontratave të Pengut, Aktvendim mbi regjistrimin e Hipotekave, lëshuar nga Zyra e Kadastrit, Procesverbaleve lidhur me vlerësimin e paluajtshmërive të datave 26.10.2017 dhe 24.10.2017. Përmbaimesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbaimitor të kreditorit, me Urdhrin Përmbaimitor P.nr. 267/21 të datës 29.04.2021, ka lejuar përmbaimitorin në bazë të dokumentit përmbaimitor. Nga shkresat në lëndë nuk ka prova se ndaj Urdhrit Përmbaimitor është ushtruar prapësim. Organi Përmbaimesi ka vazhduar me procedurën përmbaimore për shitjen publike të paluajtshmërisë deri në nxjerrjen e urdhrin të atakuar me ankesë.

Përmbaimesi Privat me Urdhrin P.nr.267/21 e datës 19.01.2022, në pjesën e I të dispozitivit të këtij urdhri ka konstatuar se shiten paluajtshmëritë e debitorëve me informata sikurse në shkresat e lëndës. Në pjesën e II-të të dispozitivit ka përcaktuar se paluajtshmëritë i shiten kreditorit, sipas kushteve mbi bazën e Konkluzionit për shitjen publike të datës 06.12.2021, me çmim përkatës të gjitha paluajtshmëritë. Në pikën III të dispozitivit të këtij urdhri janë detyruar debitorët dhe të gjithë mbajtësit e tjerë, që kreditorit t'ia lirojnë paluajtshmëritë lëndore nga njerëzit dhe sendet e tyre që ndodhen në to dhe t'ia dorëzojnë ato paluajtshmëri në posedim kreditorit. Në pjesën IV të dispozitivit të këtij urdhri, është urdhëruar Shërbimi Pronëso- Juridik pranë Drejtorisë Komunale për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ne Komunën përkatëse që të bëj fshirjen e të drejtave të pronësisë nga debitorët, dhe paluajtshmëritë nga Pika I e këtij urdhri t'i regjistrojë si pronë në emër të kreditorit - blerësit. Në pjesën V të dispozitivit të këtij urdhri është urdhëruar Shërbimi Pronëso- Juridik i Drejtorisë Komunale për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ne Komunën përkatëse, që në librin publik të paluajtshmërive të fshihen të drejtat dhe barrët e regjistruara, përpos atyre që mbetën për paluajtshmërinë edhe pas dorëzimit të saj blerësit ose të cilat ky i fundit i ka marrë përsipër, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Urdhri.

Kundër këtij urdhri, debitorët kanë ushtruar ankesë me pretendimin se çmimi i caktuar i paluajtshmërive është në joreal dhe nuk përkon me çmimin e saktë të tyre në treg, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën e debitorëve, dhe Urdhrin për shitje ta prishë ashtu që lëndën ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr. 340/2023, të datës 12.07.2023, ka aprovuar të themeltë ankesën e debitorëve, ka anuluar Urdhrin P.nr. 267/21 për Shitje të Përmbaruesit Privat, të datës 19.01.2022.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka vlerësuar se Organi Përmbarues ka bërë shkelje të dispozitave përmbarimore kur ka dorëzuar në pronësi të kreditorit paluajtshmëritë e debitorëve, ashtu që në seancën e ankandit të datës 06.12.2021, me konkluzion ka konstatuar shitjen e paluajtshmërive të debitorëve në kreditorin për shumën e propozuar nga kreditori i cili në seancë ka deklaruar se oferton për paluajtshmëritë e debitorëve, me çka organi përmbarues në bazë të këtyre çmimeve të ofruara nga kreditori, me urdhër ka bërë kalimin e të drejtës së pronësisë së paluajtshmërive në emër dhe në pronësi të kreditorit. Sipas Dhomës së Shkallës së Dytë, shkelja e dispozitave përmbarimore është realizuar me moscaktimin e ekspertit përkatës për vlerësimin e paluajtshmërisë.

Përkundër faktit se në bazë të Kontratave mbi Hipotekën, dhe procesverbaleve që gjenden në lëndë, është bërë vlerësimi paluajtshmërive për parcelat në fjalë, debitorët kanë kontestuar vlerën e caktuar të parcelave.

Sipas gjykatës ankimore, për shkak të papajtueshmërisë së debitorëve me vlerësimin e caktuar të paluajtshmërive, dispozitat ligjore kanë paraparë zgjidhje konkrete në këtë drejtim, e që në këtë rast Ligji mbi Procedurën Përmbarimore, ka rregulluar një çështje të tillë, ashtu që me rastin e kontestimit të vlerës së paluajtshmërive, mundësohet caktimi i një eksperti përkatës për vlerësim, çka organi përmbarues e ka neglizhuar një mundësi të tillë ligjore. Një gjë e tillë është përcaktuar qartë me Nenin 21 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore i cili parasheh qartë se:

“Në rast të kontestimit të vlerës së paluajtshmërisë, të arritur nga palët para procedurës përmbarimore, organi përmbarues me propozim të palëve mund ta caktojë ekspertin përkatës për caktimin e vlerës së paluajtshmërisë”.

Një vendosje të tillë të gjykatës së shkallës së dytë mund ta gjeni edhe në Aktvendimin K.Dh.Shk.II.nr. 214/2023, të datës 22.09.2023, Aktvendimin Kom. Dh.Shk.II.nr. 322/2023, të datës 12.07.2023, dhe në Aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 1266/23, të datës 19.06.2023.

13. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 322/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 09.08.2023.

Gjykata ka vendosur se me qëllim të mbrojtjes së dinjitetit të debitorit, çmimi i shitjes së paluajtshmërive duhet të caktohet përmes një ekspertize profesionale, përkundër faktit se palët më herët kanë përcaktuar vlerën e paluajtshmërive në Kontratat mbi Hipotekën.

Kreditori, me datë 21.06.2018 ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorëve - garantuesit dhe hipoteklënësit, në bazë të dokumentit përmbarues - Marrëveshjeve mbi Kreditë të datave 05.02.2016 dhe 04.04.2017, Marrëveshjeve mbi Pengun, Marrëveshjes mbi Mbi tërheqjen e Mundësuar, Kontratës mbi Hipotekën, dhe Aktvendimit mbi regjistrimin Hipotekës të datës 08.02.2016 lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, me Urdhrin Përmbarimor P.nr. 410/18 të datës 22.06.2018, ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarimor. Ndaj Urdhrit Përmbarimor nuk është ushtruar prapësim.

Organi Përmbarues ka vazhduar me procedurën përmbarimore për shitjen publike të paluajtshmërisë deri në nxjerrjen e Urdhrit për Shitje P.nr. 410/2018 të datës 23.03.2021.

Përmbaruesi Privat me urdhrin e lartcekur ka konstatuar se shiten paluajtshmëritë e debitorit garantues dhe hipoteklënës, të evidentuara sikurse në shkresat e lëndës. Në pjesën tjetër të urdhrin, Përmbaruesi Privat ka përcaktuar se paluajtshmëritë i shiten Kreditorit / Blerësit I me çmimin përkatës dhe paluajtshmëritë tjera i shiten Kreditorit / Blerësit II me çmimin përkatës, sipas kushteve mbi bazën e Konkluzioneve për shitjen publike të datës 19.03.2021 për çmim të përgjithshëm në shumë përkatëse të cilat paluajtshmëri do tu dorëzohen blerësve. Në piken e fundit të këtij urdhri është urdhëruar Drejtoria Komunale për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që të regjistrojë të drejtën e pronësisë se paluajtshmërive në emër të dy kreditorëve – blerësve, dhe është caktuar fshirja e të drejtave për të cilat është theksuar se do të fshihen me urdhrin për shitjen e këtyre paluajtshmërive.

Kundër këtij urdhri, debitori ka ushtruar ankesë duke kontestuar çmimin për të cilin janë shitur paluajtshmëritë e tij, se paluajtshmëritë janë vlerësuar me çmim më të ulët se sa çmimi real i tregut, dhe për këtë shkak i ka propozuar gjykatës së shkallës së dytë që ta ndryshojë urdhrin e atakuar ashtu që të refuzohet propozimi i kreditorit për përmbarim.

Ndaj ankesës se debitorit, kreditori ka ushtruar përgjigje me pretendimin se arsyet e dhëna nga debitori nuk qëndrojnë dhe janë vetëm deklarative.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 322/23, të datës 09.08.2023, ka aprovuar të themeltë ankesën e debitorit, ka anuluar Urdhrin për Shtitje P.nr. 410/2018 të Përmbaruesit Privat, të datës 23.03.2021, dhe ka kthyer çështjen në procedim të serishëm para të njëjtit organ.

Sipas Dhomës së Shkallës së Dytë, organi përmbarimor është dashur të përcaktojë çmimin e paluajtshmërive - objektit të kontestit, përmes caktimit të një ekspertize profesionale.

Gjykata ankimore ka pranuar faktin se bazuar në Kontratën mbi Hipotekën është bërë vlerësimi i paluajtshmërive që janë objekt i kësaj çështje, por megjithatë në rast të kontestimit të çmimit të vlerësuar nga palët, dispozitat ligjore kanë paraparë zgjidhje në këtë drejtim. Lidhur me këtë rrethanë, sipas gjykatës ankimore Neni 21 par. 2 i Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore ka përcaktuar qartë se:

“Në rast të kontestimit të vlerës së paluajtshmërisë, të arritur nga palët para procedurës përmbartimore, organi përmbartues me propozim të palëve mund ta caktojë ekspertin përkatës për caktimin e vlerës së paluajtshmërisë”.

Sipas gjykatës, një dispozitë e tillë në rastin konkret mundëson caktimin e ekspertit përkatës për caktimin e vlerës së paluajtshmërisë, andaj marrë parasysh pretendimet ankimore të debitorit se këto paluajtshmëri janë shitur nën çmimin real të tregut, dhe në pajtim me Nenin 9 të LPP i cili në paragrafin 1 thotë se: *“Gjatë zbatimit 4 të përmbartimit, duhet kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit të debitorit dhe përmbartimi të jetë sa më pak i dëmshëm që është e mundshme për debitorët”*, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së dytë ka vlerësuar se urdhri i atakuar duhet të anulohet dhe i njëjti të kthehet sërish tek organi përmbartues.

Një vendosje të tillë të gjykatës së shkallës së dytë mund ta gjeni edhe në Aktvendimin K.Dh.Shk.II.nr. 214/2023, të datës 22.09.2023, Aktvendimin Kom. Dh.Shk.II.nr. 340/2023, të datës 12.07.2023, dhe në Aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 1266/23, të datës 19.06.2023.

Megjithatë, një vendosje e tillë e kësaj gjykate nuk është e unifikuar. Me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 782/2022 të datës 21.06.2023, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, ka vendosur ndryshe në një rast pothuajse të njëjtë.

14. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 86/2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 05.09.2023.

Debitorët kanë pretenduar se vlera e paluajtshmërisë është shumë më e lartë se sa është vlerësuar për shitje, por gjykata këto pretendime i ka vlerësuar si të pabazuara dhe pa ndikim. Kjo për shkak se në dy ankandet e mbajtura, debitorët nuk kanë marrë pjesë në mënyrë që të shpalosin kërkesat dhe vërejtjet e tyre, edhe pse ishin të ftuar me rregull nga ana e Organit Përmbarrimor.

Kreditori, me datën 06.09.2017, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorëve - kredimarrësit dhe garantuesve, në bazë të dokumenteve përmbarruese - Marrëveshjeve mbi lejimin e kredive dhe marrëveshjeve mbi linjën e kredive, Marrëveshjeve mbi Pengun, Marrëveshjeve mbi Hipotekën, Aktvendimeve mbi Regjistrimin e Hipotekës, për shumën e detyrimit në vlerën totale përkatëse.

Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit, me Urdhrin Përmbarrimor P.nbr.451/17 dt.07.09.2017, ka lejuar përmbarrimin në bazë të dokumentit përmbarrimor.

Kundër këtij urdhri, debitorët kanë ushtruar prapësim ndaj te cilit kreditori ka ushtruar përgjigje ne prapësim. Për prapësimin e debitorëve ka vendosur Gjykata Themelore në Prizren me Aktvendimin nr. PPP.nr.238/2017 dt.27.10.2017 ashtu që ka refuzuar të njëjtin si të pabazuar dhe Urdhrin Përmbarrimor e ka lënë ne fuqi. Përmbarruesi Privat ka vazhduar me veprime procedurale, nxjerrjen e konkluzioneve e deri tek nxjerrja e urdhrin te atakuar nga Përmbarruesi Privat.

Përmbarruesi Privat, me Urdhrin P.nbr.451/17 të datës 28.01.2021 në Pjesën e I të dispozitivit ka konstatuar se blerës është kreditori, të cilit i është shitur në cilësinë e ofertuesit më të favorshëm i cili ka ofruar shumën më të lartë për paluajtshmërinë në pronësi të debitorit -hipoteklënësit, e identifikuar sikurse në shkresat e lëndës, e vlerësuar sipas Ekspertizës dhe Konkluzionit për përcaktimin e vlerës. Në Pjesën II të dispozitivit ka përcaktuar se paluajtshmëria është shitur për përmbushjen e pjeseshme të borxhit te debitori ndaj kreditorit ne shumën përkatëse, i cili ka ofruar këtë çmim e qe është shumë me e madhe se 1/3 e shumes se vlerësimit sipas konkluzionit të datës 30.11.2020 dhe dokumentacionit tjetër. Ne Pjesën e III të dispozitivit te këtij urdhri të shitjes Përmbarruesi Privat ka urdhëruar debitorin dhe të gjithë mbajtësit tjerë qe paluajtshmërinë e shënuar ne pikën e I të dispozitivit ta lirojnë nga njerëzit dhe sendet e tyre që ndodhen në to dhe t'ia dorëzojnë atë kreditorit në posedim dhe shfrytëzim në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij urdhri. Ne Pjesën e IV të dispozitivit të këtij urdhri Urdhërohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që paluajtshmërinë e shënuar si në Pikën I te këtij Urdhri ta regjistrojë në emër të blerësit –kreditorit.

Kundër këtij urdhri, debitori ka ushtruar ankesë me pretendimin se vlera e përcaktuar e paluajtshmërisë është shumë më e lartë se ajo e vlerësuar më herët, me propozim qe gjykata e shkallës së dytë urdhrin e atakuar ta anulojë dhe çështjen ta kthejë në rivendosje.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr. 86/2023, të datës 05.09.2023, ka refuzuar të pathemeltë ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Urdhrin për Shitje P.nbr. 451/17 të Përmbarruesit Privat, të datës 28.01.2021, si të drejtë dhe të ligjshëm.

Çmimin për shitjen e paluajtshmërisë, Organi Përmbaues, e cakton në seancën me Konkluzion sipas Ekspertizës – Raport Vlerësimit, të Ekspertit të licencuar pranë Ministrisë së Financave, i caktuar sipas Konkluzionit të datës 10.01.2020 ku është caktuar vlera e paluajtshmërisë si çmim i tërësishëm i vlerës se tregut në shumën përkatëse.

Sipas Nenit 22 të Ligjit Nr. 05/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbaimore me të cilin është riformuluar Neni 234 i ligjit bazik, përcaktohet qartë se paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmim që është me i ulët se 50% e vlerës së përcaktuar me vlerësimin e paluajtshmërisë, nëse paluajtshmëria nuk ka mundur të shitet në seancën e parë, organi përmbaues cakton seancën e dytë ku paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmim më të vogël se 1/3 e vlerës së përcaktuar e paluajtshmërisë, në rastin konkret shitja e paluajtshmërisë në shumën përfundimtare është mbi vlerën prej 1/3 e shumës së çmimit të tërësishëm të përcaktuar.

Sipas vlerësimit të gjykatës se shkallës së dytë, Urdhri për shitjen është i drejtë dhe konform dispozitës së Nenit 222 të LPP-së, ngase pasi të kryhet procedura për përcaktimin e vlerës së paluajtshmërisë, organi përmbaues jep konkluzion për shitjen e paluajtshmërisë me të cilin e cakton vlerën e paluajtshmërisë, mënyrën dhe kushtet e shitjes si dhe kohën dhe vendin e shitjes, po që se shitja bëhet me ankand publik. Organi përmbaues konform Nenit 223 të LPP-së, konkluzionin për shitjen e paluajtshmërisë e shpall në tabelën e organit përmbaues me vendimin e organit përmbaues dhe në mënyrë tjetër përkatëse.

Gjykata ankimore pretendimin e debitorit se Përmbauesi Privat ka bërë shkelje të dispozitave ligjore sepse vlera e paluajtshmërisë është shumë më e lartë se ajo e vlerësuar me herët, e ka gjetur të pabazuar dhe pa ndikim për një vendosje tjetër, sepse debitorët në dy ankandet e mbajtura me datën 30.11.2020 dhe 29.12.2020 nuk kanë marrë pjesë në seancat e këtyre ankandëve në mënyrë që t'i shpalosin kërkesat dhe vërejtjet e tyre, përkundër faktit që kanë qenë të ftuar me rregull nga ana e organit përmbaues.

15. Aktvendimi K.Dh.Shk.II.nr. 214/2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 22.09.2023.

Me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së dinjitetit të debitorit, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë, ka anuluar Urdhrin për Shitje të Përmbaruesit Privat dhe ka kërkuar nga ky organ që gjatë procedimit të serishëm, të përcaktojë vlerën e paluajtshmërive përmes një ekspertize profesionale, përkundër faktit se palët kanë përcaktuar vlerën e paluajtshmërive në Kontratat mbi Hipotekën, vlera e të cilave nuk është kontestuar gjatë seancave për shitjen e tyre.

Kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorëve në bazë të dokumenteve përmbarimore – Kontratave për Hipotekën.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas këtij propozim, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.2502/18, të datës 08.08.2018, ka lejuar përmbarimin në bazë të Kontratave mbi Hipotekën. Për shkak të mosparaqitjes së prapësimit, Organi Përmbarues ka vazhduar me procedurën për shitjen publike të paluajtshmërisë deri në nxjerrjen e urdhrin të ankimuar.

Përmbaruesi Privat, ka dorëzuar në pronësi të kreditorit paluajtshmëritë e debitorëve, ashtu që në seancën e ankandit të dytë publik të datës 29.04.2022 me konkluzion ka aprovuar kërkesat e ofertuesit – kreditorit për shitjen dy paluajtshmërive përkatëse të debitorëve J.Q. dhe V.B. të lëna hipotekë, për shumën e propozuar nga kreditori, me çka Përmbaruesi me urdhër ka bërë kalimin e të drejtës së pronësisë mbi këto paluajtshmëri.

Përmbaruesi Privat, me Urdhrin P.nr.502/2018, të datës 12.05.2022,

Në pjesën e I dhe II të dispozitivit ka konstatuar se shitet paluajtshmëria e debitorit J.Q. me të dhënat e tij, dhe të dhënat identifikuese të paluajtshmërisë. Në pjesën II të dispozitivit ka konstatuar se shitet paluajtshmëria e debitorit V.B. me të dhënat e tij sikurse në shkresat e lëndës dhe të dhënat identifikuese të paluajtshmërisë.

Në pjesën e III të dispozitivit është vendosur se paluajtshmëria e përcaktuar si në pikën nën 1) të dispozitivit të këtij urdhri i shitet blerësit – kreditorit Institucionit Bankar “X.X.” sipas kritereve të caktuara në bazë të konkluzioneve për shitjen publike, si dhe Paluajtshmëria e përshkruar si nën pikën 2) të dispozitivit të këtij urdhri i shitet kreditorit Institucionit Bankar “X.X.” sipas kritereve të caktuara në bazë të konkluzioneve për shitjen publike.

Kundër këtij urdhri, debitorët kanë ushtruar ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Në ankesën e ushtruar, debitorët kanë kontestuar vlerën monetare për të cilat i janë shitur paluajtshmëritë kreditorit. Nga analizimi i vendimit të Gjykatës së shkallës së dytë, ky pretendim i debitorëve, rezulton të jetë shprehur vetëm gjatë ushtrimit të ankesës dhe jo gjatë procedurës përmbarimore të ndjekur më herët para Përmbaruesit Privat.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vepruar sipas kësaj ankese, ka aprovuar si të themeltë këtë mjet juridik, dhe si rrjedhojë ka anuluar Urdhrin P.nr. 502/2018 për Shitje të Përmbauesit Privat, të datës 12.05.20222, dhe ka kthyer çështjen në riprocedim.

Kjo Gjykatë ka vlerësuar se Përmbauesi Privat me rastin e vendosjes nuk ka vërtetuar saktë gjendjen faktike dhe se nuk ka analizuar drejt Nenin 9 të LPP-së dhe Nenin 21 par. 2 të Ligjit nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbaimore, e cila dispozitë parasheh që:

“Në rast të kontestimit të vlerës së paluajtshmërisë, të arritur nga palët para procedurës përmbaimore, organi përmbaues me propozim të palëve mund ta caktoj ekspertin përkatës për caktimin e vlerës së paluajtshmërisë.”

Sipas Gjykatës, edhe pse në Kontratat mbi Hipotekën, rezulton se është bërë vlerësimi i paluajtshmërive, por që në rast të kontestimit të çmimit të vlerësuar, Neni i lartcekur parasheh për një çështje të tillë dhe në rastin konkret, mundëson caktimin e ekspertit përkatës për caktimin e vlerës së paluajtshmërisë.

Qëndrimi i organit përmbaues se përcaktimi i vlerës së paluajtshmërive, nuk është bërë në bazë të ekspertizës profesionale për faktin se palët me Kontratat për Hipotekën kanë caktuar vlerën e paluajtshmërive, vlerë kjo e cila nuk është kontestuar as në seancat për shitjen e paluajtshmërive, nuk qëndron, sepse Organi përmbaues duhet të zbatojë dispozitat ligjore përkitazi ndërmarrjes se veprimeve në mënyrë që debitorit të mos i shkaktohet dëm me rastin e zbatimit të procedurës përmbaimore, kjo bazuar në Nenin 9 të LPP i cili në par. 1 thotë se:

“Gjatë zbatimit të përmbaimit, duhet kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit të debitorit dhe përmbaimit të jetë sa me pak i dëmshëm që është e mundshme për debitorët”.

Një vendosje të njëjtë të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, do ta gjeni në Aktvendimin K.DH.SH.II nr. 322/23 të datës 09.08.2023.

Megjithatë, një vendosje ndryshe nga ky vendim, do ta gjeni në Aktvendimin K.DH. SH.II.nr. 782/2022 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, të datës 21.06.2023.



KAPITULLI III

URDHËRESAT ME GJOBA MANDATORE

16. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 749/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, i datës 18.09.2023.

Urdhëresa ndëshkimore me gjobë mandatore nuk plotëson kushtet ligjore për tu konsideruar dokument përmbarimor, nëse kjo urdhëresë nuk është origjinale apo kopje e vërtetuar noteriale, si dhe nëse nuk përmban vulën e ekzekutueshmërisë dhe plotfuqishmërisë, apo ndonjë mjet tjetër verifikues që do të provonte plotfuqishmërinë dhe ekzekutueshmërinë e saj.

Kreditori, me datë 07.02.2022, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbarimor - Urdhëresës për pagesë të ndëshkimit me gjobë mandatore.

Përmbaruesi Privat, me Urdhrin Përmbarimor P.nr:80/2022, të datës 08.02.2022, ka caktuar përmbarimin, duke vlerësuar se dokumenti përmbarimor, i plotëson kushtet ligjore përkatëse për përmbarim para organit përmbarimor.

Ndaj këtij urdhri debitori ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin për përmbarim për shkak se dokumenti në bazë të cilit është nxjerrë urdhri përmbarimor nuk përmban vulën e ekzekutueshmërisë dhe plotfuqishmërisë, dhe duke theksuar se urdhri ndëshkimor mbi bazën e të cilit është nxjerrë Urdhri Përmbarimor nuk i plotëson kushtet nga Neni 36 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Përgjigje në këtë prapësim ka parashtruar kreditori, duke theksuar se përmbarimi është iniciuar në përputhje me Nenin 24 par. 4 të LPP-së, për çka dokumenti i nxjerrë në procedurën kundërvajtës është bërë i përmbarueshem, ku kjo përcaktohet në Nenin 30 par. 4 të Ligjit për Kundërvajtje.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me Aktvendim KPPP. nr.1675/22, të datës 25.04.2023, ka pranuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke shfuqizuar Urdhrin Përmbarimor P.nr:80/2022 të datës 08.02.2022.

Gjykata ka vlerësuar se në dokumenti përmbarimor mbi të cilin është iniciuar procedura përmbarimore, gje gjësisht Urdhëresa e kreditorit për pagesë të ndëshkimit me gjobë mandatore, nuk plotëson kushtet për të qenë dokument përmbarimor me titull ekzekutiv, sepse nuk i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me Nenin 22 par. 1.2 dhe Nenin 36 par. 1 të LPP-së. Më konkretisht, urdhri ndëshkimor nuk përmban vulën e ekzekutueshmërisë dhe plotfuqishmërisë.

Kreditori, brenda afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të cenimit thelbësor të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa, aktvendimi i atakuar të ndryshohet, dhe të refuzohet propozimi i debitorit.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr.749/23, të datës 18.09.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e kreditorit, duke vërtetuar Aktvendimin KPPP.nr.1675/22 të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, të datës 25.04.2023.

Kjo gjykatë ka mbështetur qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë se urdhëresa për pagesë të ndëshkimit me gjobë mandatore, nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbarimor me titull ekzekutiv, për faktin se ky dokument nuk i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me Nenin 22 par. 1.2 dhe Nenin 36 par.1 dhe të LPP-së.

Gjykata ka vlerësuar se urdhri ndëshkimor i lëshuar nga kreditori nuk është dokument origjinal dhe nuk ka asnjë mjet verifikues, vulë, apo vendim tjetër me cilin do të mund dëshmohej plotfuqishmëria dhe ekzekutueshmëria e tij sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

17. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 748/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 26.10.2023.

Në mënyrë që urdhëresa për shqiptimin e gjobës mandatore të ketë cilësinë e dokumentit përmbarimor në bazë të të cilit mund të realizohet me sukses procedura përmbarimore, urdhëresa duhet të përmbajë vulat apo ndonjë mjet tjetër përmes të cilit mund të verifikohet plotfuqishmëria dhe përmbarueshmëria e asaj urdhërese.

Kreditori me datën 11.08.2022, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbarimor - urdhrit për pagesën e gjobës mandatore të lëshuar nga kreditori.

Përmbaruesi Privat, sipas propozimit të kreditorit, me Urdhrin Përmbarimor, të datës 12.08.2022, ka lejuar përmbarimin, me të cilin ka detyruar debitorin që në emër të gjobës, t'i paguajë kreditorit shumën përkatëse, si dhe pagesën e shpenzimeve tjera përmbarimore deri në pagesën definitive.

Kundër këtij Urdhri Përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 30.08.2022, duke theksuar se gjoba e lëshuar nga kreditori si dokument përmbarimor është marre në kundërshtim me gjendjen faktike dhe me dispozitat e LPP-së, e njëjta nuk mund të cilësohet si dokument përmbarues, pasi që nuk përmban vulën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë. Prandaj, ka propozuar që gjykata, këtë urdhër përmbarimor ta anulojë në tërësi.

Ndaj prapësimin të debitorit, kreditori ka parashtruar përgjigje duke arsyetuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit, dhe se vendimi përbën dokument ekzekutiv.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Parë, me Aktvendimin KPPP.nr. 2196/2022 të datës 25.04.2023, ka aprovuar si të bazuar prapësimin e paraqitur nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr. 682/22, të datës 12.08.2022, të lëshuar nga Përmbaruesit Privat.

Dhoma e Shkallës së Parë ka konstatuar se përmbarimi i lejuar është i kundërligjshëm për faktin se përmbarimi nuk është lejuar në bazë të dokumentit që ka cilësinë dokumentit përmbarimor, për faktin se urdhri për pagesën e gjobës mandatore nuk dihet a ka marrë formë të prerë dhe a është bere i ekzekutueshëm, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e Nenit 21 dhe 22 të njëjtit ligj.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe aktvendimin e atakuar ta anulojë.

Përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.748/23, të datës 26.10.2023, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, ka refuzuar të pabazuar ankesën e kreditorit, dhe si rezultat, ka vërtetuar Aktvendimin KPPP.nr. 2196/2022 e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Parë, të datës 25.04.2023.

Gjykata e shkallës së dytë, ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbareme kur ka aprovuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrit të Përmbaremit Privat, me të cilin është caktuar përmbaremi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbaremi nuk është lejuar në bazë të dokumentit që ka cilësinë dokumentit përmbaremit, duke qene se urdhri për pagesën e gjobës mandatore, nuk dihet a ka marrë forme të prerë dhe a është bërë i ekzekutueshëm, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e Nenit 21 dhe 22 të njëjtit ligj.



KAPITULLI IV

PLOTËSIMI I PROPOZIMIT PËR PËRMBARIM

18. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 437/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 15.02.2023.

Në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e Urdhrit Përmbarimor, pasi që dokumentet mbi të cilat është iniciuar procedura përmbarimore nuk janë origjinale apo kopje të vërtetuara.

Kreditori, me datën 09.06.2021, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorëve në bazë të dokumenteve përmbaruese - Marrëveshjes mbi Kreditë, Marrëveshjes mbi Pengun, Marrëveshjes mbi lëshimin dhe shfrytëzimin e Visa Biznes Kartelës, Konfirmimit të Regjistrimit, të lëshuar nga Zyra për Regjistrim të Pengut.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit ka lejuar përmbarimin me Urdhri P.nr.237/21, të datës 09.06.2021, për shumën e detyrimit të debitorëve ndaj kreditorit që rrjedhin nga marrëveshjet e sipër cekura, me kamatë të rregullt dhe kamatëvonesë deri në pagesën definitive.

Kundër këtij urdhri, me datën 17.06.2021, debitorët kanë ushtruar prapësim, me pretendimin se dokumenti në bazë të cilit është marrë Urdhri Përmbarimor është në kundërshtim të plotë me dispozitat e LPP-së pasi në momentin e lidhjes së kësaj kontrate në mes kreditorit dhe debitorëve nuk është paraparë asnjë nen që në rast të mos përmbushjes me kohë të kredisë, të iniciohet procedura përmbarimore, duke shtuar se Urdhri Përmbarimor nuk është nxjerrë në pajtim me Nenin 21 të LPP-së. Ligji i Procedurës Përmbarimore në mënyrë taksative përcakton se cilët janë titujt përmbarimor dhe dokumentet e besueshme, dhe se kontrata e sipërcekur nuk gjendet e listuar në këtë dispozitë, e aq më tepër e njëjta nuk ka klauzolë të përmbarueshmërisë dhe se kontratat nuk janë të vërtetuara tek noteri. Kontrata mbi pengun e cila është prezantuar si provë në propozimin për përmbarim nuk është në përputhje me Ligjin mbi regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme, pasi nga momenti i lidhjes së kontratës mbi kreditë dhe asaj për pengun, ka kaluar më shumë kohë që konform këtij ligji e njëjta është dashur që të lidhet me afat më të gjatë kohor.

Kreditori me datën 23.06.2021, ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke theksuar se pretendimet e debitorit janë të pabazuara, dhe se propozimi për përmbarim i plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara me Nenin 38 të LPP-së, referuar këtu edhe Nenin 22 të Ligjit 04/L-139 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L/118. Sipas kreditorit, debitorët janë kontaktuar dhe takuar në vazhdimësi nga zyrtarët përkatës, dhe atyre u është dhënë kohë për zgjidhje dhe shlyerje të vonesave të kësteve, por të njëjtit kanë rënë në vonesë.

Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Istog, me Aktvendimin PPP.nr.30/21 të datës 26.07.2021, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorëve të paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.237/2021, të datës 09.06.2021, duke shfuqizuar këtë Urdhër Përmbarimor.

Gjykata ka konstatuar se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e Urdhrit Përmbarimor në bazë të dokumentit përmbarues, për shkak se marrëveshja mbi kreditë dhe dokumentet e tjera mbi të cilat është iniciuar procedura përmbarimore nuk janë origjinale apo kopje të vërtetuara siç duhet të jenë përkitazi me dispozitat ligjore, prandaj të njëjtat nuk paraqesin dokumente përmbarimore.

Gjykata ka theksuar faktin se Përmbaruesi Privat është dashur të vërtetojë se a janë plotësuar kushtet dhe të gjitha prezumimet ligjore të kërkuara me Nenin 38 par. 1 të LPP-së, duke shtuar se organi përmbarues është dashur të veprojë konform Nenit 102 të LPK për mënjanimin e të metave të cilat janë të pranishme në një parashtrësë.

Kundër këtij aktvendimi, kreditori brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë si të bazuar ankesën e ushtruar dhe aktvendimin e atakuar ta anulojë dhe çështjen ta kthejë në shkallë të parë, në rivendosje.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 102.1437/22, të datës 15.02.2023, ka aprovuar të themeltë ankesën e kreditorit, ka anuluar Aktvendimin PPP.nr. 30/2021 e Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Istog, duke kthyer çështjen në Gjykatën Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë.

Në këtë aktvendim, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave ligjore, për faktin se dokumentet përmbarimore në bazë të të cilave është zhvilluar procedura përmbarimore e në bazë të cilave është lejuar përmbarimi, kanë qenë dokumente në kopje dhe jo në origjinal, gjykata e shkallës së parë është dashur të veprojë konform Nenit 73 të LPP-së dhe Nenit 102.1 të LPK-së, ashtu që gjykata e shkallës së parë është dashur të caktojë seancë dëgjimore lidhur me vlefshmërinë e prapësimit, si dhe është dashur t'i mundësojë kreditorit të sjellë dokumentet origjinale apo kopje të vërtetuara noteriale për të bërë plotësimin e propozimit për përmbarim.

19. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 303/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 12.04.2023.

Kopja e vulosur nga kreditori nuk mund të legjitimojë origjinalitetin e dokumentit, përderisa nuk i nënshtrohet procesit të verifikimit të origjinalit nga organi noterial, apo vulës përkatëse, me të cilën vërtetohet saktësia e dokumentit të kopjuar, e cila lëshohet nga institucioni përkatës.

Kreditori me datë 04.12.2018, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave të datave 13.11.2017 dhe 11.11.2016, për pagesën e borxhit në vlerën përkatëse.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas Propozimit të kreditorit, me datë 05.12.2018, ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.4242/18, me të cilin ka lejuar përmbarimin e propozuar, e ndaj të cilit debitori brenda afatit ligjor, ka paraqitur prapësim.

Gjykata e shkallës së parë me Konkluzionin e datës 15.06.2020, ka urdhëruar kreditorin që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij konkluzioni, të parashtrojë në gjykatë të dhënat për debitorin, respektivisht numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit si dhe faturat e datave 13.11.2017 dhe 11.11.2016 në origjinal apo kopjet e tyre të vërtetuara, në bazë të të cilave është propozuar përmbarimi, ose në të kundërtën propozimi për përmbarim do të hedhet poshtë si i paplotësuar.

Duke vendosur sipas konkluzionit, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PPP.nr.63/2019, e datës 04.09.2020, ka hedhur poshtë Propozimin për Përmbarim të datës 04.12.2018 të kreditorit për shkak të mosplotësimit, dhe si rrjedhojë ka anuluar Urdhrin për Përmbarim P.nr.4242/18, të datës 05.12.2018 të lejuar nga Përmbaruesi Privat.

Kundër aktvendimit të lartcekur, kreditori brenda afatit ligjor ka parashtuar ankesë me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit në tërësi si e bazuar dhe t'ia vazhdojë të drejtën për vazhdimin e procedurës përmbarimore ndaj debitorit, ose aktvendimin e atakuar ta prishë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr. 303/22 të datës 12.04.2023, ka refuzuar si të pathemeltë ankesën e kreditorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 63/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 04.09.2020.

Konkludimin e gjykatës së shkallës së parë se propozimi për përmbarim ka qenë i mangët ngase faturat që përbëjnë bazën për iniciimin e procedurës përmbarimore duhet të jenë në origjinal apo kopjet e tyre të vërtetuara, e ka mbështetur edhe Dhoma e Shkallës së Dytë.

Fakti se propozimi për përmbarim nuk ka përmbajtur të dhënat e biznesit dhe faturat origjinale apo kopje të vërtetuara konform parakushteve ligjore të parapara me Nenin 38 të LPP-së, e ka pranuar edhe Dhoma e Shkallës së Dytë.

Kjo gjykatë ka gjetur se kreditori ka dështuar që në afatin e dhënë ligjor të veprojë sipas konkluzionit të gjykatës, ndërkaq në këtë konkluzion kreditori ishte njoftuar për pasojat procedurale që krijohen ex lege po që se nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës.

Sipas interpretimit të ofruar nga Gjykata ankimore, dispozita e Nenit 38 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimor ka përcaktuar qartë parakushtet e nevojshme që një propozim për përmbarrim të jetë i rregullt. Në këtë drejtim është qëndrim edhe i kësaj gjykate se kopja e vulosur nga kreditori nuk mund të legjitimojë origjinalitetin e dokumentit, përderisa nuk i nënshtrohet procesit të verifikimit të origjinalit nga organi noterial apo vulës përkatëse me të cilën vërtetohet saktësia e dokumentit të kopjuar e cila lëshohet nga institucioni përkatës.

Rrjedhimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë ka vendosur se me faktin se rregullsia e propozimit për përmbarrim nuk është korrigjuar, gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur e ka hedhur si të paplotësuar propozimin e kreditorit.

20. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 729/2022 i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 20.04.2023.

Kopja e vulosur nga kreditori nuk mund të legjitimojë origjinalitetin e dokumentit, përderisa nuk i nënshtrohet procesit të verifikimit të origjinalit nga organi noterial, apo vulës përkatëse, me të cilën vërtetohet saktësia e dokumentit të kopjuar, e cila lëshohet nga institucioni përkatës.

Kreditori, me datën 19.08.2020, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, me Urdhrin Përmbarimor P.nr. 189/20 të datës 20.08.2020 ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përmes të cilit ka obliguar debitorin që kreditorit në emër të borxhit sipas faturës t'ia paguajë shumën përkatëse, me kamatë ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër këtij urdhri, debitori me datë 08.09.2020 ka ushtruar prapësim me propozimin që Gjykata të njëjtin ta aprovojë si të bazuar dhe ta anulojë Urdhrin Përmbarimor P.nr. 189/20, të datës 20.08.2020. Debitori ka pretenduar se borxhi i kërkuar nga kreditori nuk mbështetet me ndonjë kontratë të lidhur në mes të palëve lidhur me transportin e nxënësve dhe se pretendimet e kreditorit se provat e paraqitura vërtetojnë faktin se ka pasur kontratë të lidhur për periudhën kohore për të cilën kërkohet borxhi, janë të paqëndrueshme.

Kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësimin e debitorit, me arsyetimin se i njëjti është i pabazuar, dhe se pretendimet e debitorit janë të pambështetura në prova. Në përgjigje në prapësim, kreditori ka theksuar se është angazhuar nga vet debitori për kryerjen e shërbimit të transportit të nxënësve të Shkollës për periudhën dhe orët përkatëse, dakordimi dhe kryerja e shërbimit vërtetohen nga raporti i lëshuar nga drejtori i shkollës, fatura e dorëzuar për pagesë përmes formularit zyrtar të shkollës të debitorit, si dhe kontratat që ka pasur me debitorin dhe Kuotimet e Çmimeve përkatëse.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, me Aktvendimin PPP.nr.99/20, të datës 28.12.2020 ka hedhur poshtë propozimin e kreditorit për përmbarim për shkak të mosplotësisë, si dhe ka anuluar Urdhrin Përmbarimor P.nr.189/20 të datës 20.08.2020.

Gjykata në harmoni me Nenin 99 par. 2 dhe Nenit 102 të LPK-së, ka nxjerrë konkluzionin e datës 20.11.2020 me të cilin ka urdhëruar kreditorin që brenda afatit prej 7 ditëve nga dita e pranimit të konkluzionit, gjykatës t'ia dorëzojë provat - dokumentacionin e besueshëm në origjinal, ose kopjen e vërtetuar, duke njoftuar të njëjtin se po që se nuk vepruar sipas kërkesës së gjykatës, do të konsiderohet se propozimi për përmbarim është tërhequr, apo nëse dokumenti nuk i kthehet gjykatës brenda afatit ligjor ose i kthehet pa u korrigjuar ose pa plotësuar, propozimi do të hedhet poshtë.

Duke vepruar sipas këtij konkluzioni, kreditori me datën 30.11.202 ka dorëzuar në gjykatë një parashitje të cilës ia ka bashkangjitur një faturë, kërkesën drejtuar debitorit të datës 03.07.2019, dhe raportin e lëshuar nga debitori.

Sipas shkresave në lëndë, kreditori konkluzionin P.nr.99/2020 të datës 20.11.2020 e ka pranuar me datë 24.11.2020 dhe faturën e kërkuar nga gjykata, e ka sjellë ne gjykatë në kopje, vetëm se i ka vënë vulën dhe nënshkrimin e tij mbi të, por që të dhënat e palës debitore kanë mbetur përsëri vetëm kopje. Po ashtu, kreditori në lëndë ka bashkëngjitur faturën të cilën e ka noterizuar me datë 05.01.2021, çka tregon se e njëjta është noterizuar pas kalimit të afatit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë.

Kundër këtij aktvendimi, kreditori ka ushtruar ankesë, me propozimin që te hedhet poshtë si i pabazuar aktvendimi i atakuar, dhe lënda të kthehet ne rishqyrtim.

Përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.729/2022 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, të datës 20.04.2023 është refuzuar e pathemeltë ankesa e kreditorit dhe është vërtetuar Aktvendimi PPP.nr.99/2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, i datës 28.12.2020.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, duke vlerësuar ankesën e paraqitur është bazuar në Nenin 102 par. 1 të LPK i cili parasheh që: *“Kur një parashtrësë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të Nenit 99, gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë parashtrësën. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhë treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtrësës”* ndërsa par. 3 i këtij Neni thotë se: *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit te caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hidhet poshtë.”*

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, me Konkluzionin P.nr. 99/2020, të datës 20.11.2020 ka urdhëruar kreditorin që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij konkluzioni t'i dorëzojë gjykatës faturën në origjinal ose kopje të vërtetuar dhe nëse nuk vepron sipas këtij konkluzioni ne afatin e lartcekur, atëherë gjykata sipas Nenit 102 par. 3 të LPK-së propozimin e konsideron të tërhequr.



KAPITULLI V
MËNYRA E DORËZIMIT TË FATURAVE

21. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 68/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 21.07.2022.

Hierarkinë dhe organizimin zyrtar të pranimit të detyrimeve, qoftë me faturë apo qoftë në ndonjë mënyrë tjetër, e rregullon vet institucioni. Prandaj, jo vetëm kreditori, por as gjykata nuk ka mekanizëm ligjor për të vlerësuar çështjen e pranimit të faturave, përderisa ajo përmban nënshkrimin e zyrtarit të institucionit përkatës. Pretendimi që të identifikohet zyrtari adekuat, apo protokollin zyrtar, për të qenë fatura e pranueshme, i tejkalon kushtet ligjore me LPP-së, dhe i takon vet institucioneve që në mënyrë interne të caktojnë standardet e pranimit të faturave apo shkresave tjera.

Kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës së datës 11.11.2017.

Përmbaruesi Privat, sipas propozimit të kreditorit, me Urdhrin Përmbarimor P.nr. 212/18 të datës 24.01.2018, ka lejuar përmbarimin, me të cilën është detyruar debitori që në emër të borxhit që rrjedhë nga Kontrata për Furnizimin me Lampa për Detektimin e UV Sprej, kreditorit t'i paguajë shumën përkatëse.

Kundër Urdhrit Përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 05.02.2018, duke theksuar se vlera e faturës është mbi vlerën e kontratës se lidhur mes palëve dhe është në kundërshtim me Nenin 4.1, 4.2, 4.3, dhe 5.1 të vet kontratës ku çmimi i përafërt i furnizimeve është paguar në tërësi me datën 26.09.2017, me kupon të shpenzimit Nr. 2017-259553. Për shkak të mosrespektimit të kushteve të kontratës nga nenet e sipërcekura, obligimi në vlerën përkatëse euro nuk mund të procedohet për pagesë të rregullt dhe për të njëjtën nuk ka pasur përpjekje paraprake për krijimin e kushteve që obligimi të konsiderohet i rregullt. Tutje, debitori ka kontestuar validitetin e faturës së datës 11.2017, pasi që kjo faturë nuk është e protokolluar sipas procedurave të arkivimit të institucionit publik – debitorit.

Ndaj prapësimin të debitorit, me datë 06.02.2018 kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke arsyetuar se kundërshton pretendimet e debitorit duke theksuar se për çështjet që i ka ngritur i njëjti, kreditori disponon kontratën për shërbimet, shërbimi është kryer, përkatësisht malli është dorëzuar sipas kërkesës së vet debitorit. Kreditori tutje ka sqaruar se fatura është dorëzuar në mënyrë të rregullt te debitori, për mallin që i është dorëzuar dhe asnjëherë nuk është kundërshtuar nga debitori. Sa i përket protokollimit të faturës kjo është çështje e brendshme e subjektit.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin PPP.nr. 212/18 e datës 12.09.2019, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr. 212/18 24.01.2018, të Përmbaruesit Privat.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka theksuar se fatura e datës 11.11.2017 është dokument i besueshëm, të cilën e ka pranuar dhe nënshkruar debitori, pastaj nga këmbimi me e-mail i datës 26.10.2017 shihet se është dërguar kërkesa nga debitori në adresë të kreditorit nga e cila kërkesë është kërkuar që kreditori t'ia sjell debitorit 3400 UV Lampa.

Kundër këtij aktvendimi, debitori në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të aprovojë ankesën si të bazuar, dhe aktvendimin e ankimuar ta anulojë.

Gjykata Komeriale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 68/22, të datës 21.07.2022, ka refuzuar të pabazuar ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 212/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 12.09.2019.

Lidhur me pretendimin e debitorit se ka përmbushur detyrimin ndaj kreditorit me datën 26.09.2017 kur e ka bërë pagesën në shumën përkatëse me kuponin Nr. 2017-259553, kjo gjykatë vlerëson se është pretendim i paprovuar pasi që debitori nuk ka ofruar prova të qarta se detyrimi përfshihet apo është i njëjtë me borxhin që tanimë është objekt kontesti.

Sipas gjykatës ankimore, pretendimet e debitorit se pranimi i faturës është bërë nga zyra e arkivit dhe jo nga zyrtari përgjegjës financiar nuk është çështje që i takon kreditorit. Hierarkinë dhe organizimin zyrtar të pranimit të detyrimeve, qoftë me faturë apo në mënyrë tjetër, e rregullon vet institucioni. Prandaj, jo vetëm kreditori por as gjykata nuk ka mekanizëm tjetër ligjor për të vlerësuar çështjen e pranimit të faturës, përderisa ajo përmban nënshkrimin e zyrtarit të institucionit përkatës. Pretendimi që të identifikohet zyrtari adekuat, apo protokoli zyrtar për të qenë fatura e pranueshme i tejkalon kushtet ligjore me Ligjin për Procedurën Përmbartimore dhe i takon vet institucioneve që në mënyrë interne të caktojnë standardet e pranimit të faturave apo shkresave tjera.

22. Aktvendimi Kom.Dh.Sh.II.nr. 1309/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 22.08.2022.

Pretendimin se fatura e lëshuar nga kreditori nuk është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, gjykata e ka gjetur si të pabazuar, për faktin se faturën e lëshuar nga kreditori, debitori e ka pranuar përmes e-mailit.

Përmbauesi Privat me Urdhrit Përmbaues P.nr.47/17 të datës 06.03.2017, ka lejuar përmbauesin sipas propozimit të kreditorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës së datës 14.02.2017 në shumën përkatëse, së bashku me shpenzimet e procedurës, për mospërmbushje të detyrimeve ndaj kreditorit.

Kundër Urdhrit për Përmbaues, me datë 06.03.2017 debitori ka ushtruar prapësim, duke theksuar që urdhri i caktuar nga ana e Përmbauesit Privat është i pa bazuar pasi që fatura e prezantuar është e papranuar, mirëpo është fakt i pa kontestueshëm që debitori me datë 04.08.2014 ka lidhur kontratë për furnizim me pajisje për kabinet të fizikës, kimisë dhe biologjisë për shkollat e mesme, e cila është zbatuar në tërësi, mirëpo fatura nuk ka bazë ligjore për shkak se nuk është miratuar nga zyra e prokurimit me ç'rast kreditori shkëlur kontratën, andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit dhe të abroget urdhri përmbaues.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori, duke theksuar se në pretendimet në prapësim ka pasaktësi sepse realizimi i projektit nuk është bërë në tërësi siç thuhet në prapësim. Nga kontrata me debitorin për furnizim me pajisje shkollore ka mbetur pa u realizuar një shumë e konsiderueshme në vlerë prej 3,674.00€, andaj ka propozuar që të vazhdohet me Urdhrit Përmbaues.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin PPP.nr. 242/2017 të datës 02.07.2018 ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, të paraqitur kundër Urdhrit Përmbaues P.nr. 47/17 të datës 06.03.2017 të Përmbauesit Privat.

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata ka theksuar se urdhri i lejuar nga ana e Përmbauesit Privat bazohet në faturën e kreditorit të lëshuar me datë 14.02.2017, e cila është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, përmes e-mailit të datës 23.02.2017, andaj Urdhri Përmbaues është i ligjshëm, pasi që plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara në kuptim të Nenit 24, dhe 27 të LPP-së për të qenë një dokument i përmbaueshëm, dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbaues.

Kundër këtij aktvendimi, debitori në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, me propozimin që të aprovet ankesa, të anulohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr. 242/2017 i datës 02.07.2018 kurse lënda t'i kthehet Gjykatës Themelore në Prishtinë, apo që kjo gjykatë të vendosë në mënyrë meritore.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit Kom.Dh.Sh.II.nr. 1309/22, të datës 22.08.2022, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 242/2017 e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 02.07.2018.

Gjykata ankimore ka mbështetur qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë se në rastin konkret fatura, kontrata, po ashtu edhe propozimi për përmbnim përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara nga dispozitat e lartpërmendura, andaj si i tillë dokumenti i besueshëm – fatura, përmban tiparet e nevojshme të përmbnueshmërisë të përcaktuar sipas dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbnimore.

23. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 33/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 01.09.2022.

Në rastet kur palë në procedurën përmbarimore paraqitet institucioni publik i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga Avokatura Shtetërore, Organi Përmbarimor është i detyruar që për çdo veprim të ndërmarrë, të njoftojë Avokaturën Shtetërore si organ të autorizuar për ndërmarrjen e veprimeve në emër dhe në dobi të institucionit publik. Si rezultat, i tërë komunikimi duhet të realizohet përmes Avokaturës Shtetërore.

Kreditori, pranë Përmbaruesit Privat ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të titullit përmbarimor Aktgjykimit A.nr. 1355/2012, të datës 26.05.2015, i plotfuqishëm me datë 16.06.2015 dhe i ekzekutueshëm me datë 28.10.2015 me të cilin ka kërkuar që të caktohet përmbarimi dhe të detyrohet debitori që të marrë aktvendim përmes të cilit do t'i lejohej kreditorit qasja në të gjitha dokumentet dhe informatat e kërkuara në lidhje me shpenzimet e bëra nga ish kryeministri dhe ish zëvendësministrat e Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjatë periudhës kohore nga data 15.02.2011, e deri më datë 31.08.2012.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbarim të kreditorit, ka marrë Urdhrin P.nr 534/17 të datës 13.11.2017, me të cilin ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit, në bazë të Aktgjykimit A.nr. 1355/2012, të datës 26.05.2015.

Kundër Urdhrit P.nr 534/17 të datës 13.11.2017, debitori me datë 09.01.2018 ka ushtruar prapësim, duke theksuar se aktgjykimi në bazë të cilit është kërkuar përmbarimi është marrë në shkelje të procedurave ligjore, andaj i ka propozuar gjykatës që prapësimi të aprovohet si i bazuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin PPP.nr. 116/18, të datës 22.04.2020, ka hedhur poshtë prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr 534/17, të datës 13.11.2017, si të pasafatshëm. Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka theksuar se Urdhrin P.nr 534/17 e datës 13.11.2017, debitori e ka pranuar me datë 18.11.2017, ndërsa prapësimin e ka ushtruar me datë 09.01.2018, dhe atë pas plot 46 ditëve, që do të thotë pas skadimit të afatit të paraparë ligjor.

Kundër këtij aktvendimi, debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë, me propozimin që ankesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar të anulohet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje. Ndër të tjera, në ankesë pretendohet se Urdhri Përmbarimor, nuk është dorëzuar në mënyrë të rregullt, pasi që ky urdhër nuk është dorëzuar pranë përfaqësuesit të autorizuar të debitorit.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr. 33/22, të datës 01.09.2022 ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit, dhe ka prishur Aktvendimin PPP.nr. 116/18 e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 22.04.2020, dhe ka kthyer në rigjykim dhe në rivendosje lëndën para të njëjtës gjykatë.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga Neni 182 par. 2 pika (k) lidhur me Nenin 107 par. 1 të LPK-së.

Gjykata ankimore ka konstatuar se në cilësinë e debitorit është paraqitur një institucion publik, i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga Avokatura Shtetërore – Min istria e Drejtësisë, fakt ky i cili vërtetohet edhe nga prapësimi i ushtruar nga vet debitori, ku theksohet se debitori përfaqësohet nga Avokatura Shtetërore.

Sipas Dhomës së Shkallës së Dytë, për shkak të prezencës të rrethanave të tilla, gjykata e shkallës së parë ka qenë e detyruar që në lidhje me çdo veprim të ndërmarrë në këtë procedurë në drejtim të debitorit si institucion publik, të njoftojë Avokaturën Shtetërore, si organ i cili ka qenë i autorizuar të ndërmarrë veprime në emër dhe në dobi të debitorit.

Nga shkresat e lëndës, Gjykata ka vërtetuar se Përmbaruesi Privat Urdhrin për Përmbarim të datës 13.11.2017 e ka dorëzuar në adresë të debitorit, kur në fakt është dashur që ta njoftojë Avokaturën Shtetërore si organ i autorizuar për përfaqësimin e debitorit. Veprimet e tilla të ndërmarra nga gjykata e shkallës së parë janë në kundërshtim të plotë me dispozitën nga Neni 107 par.1 të LPK-së, ku parashihet se:

“Kur palën e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor apo me prokurë, shkresa i dorëzohet përfaqësuesit ligjor, përkatësisht përfaqësuesit me prokurë”.

Si pasojë e këtyre lëshimeve nga ana e gjykatës së shkallës së parë është dëmtuar interesi i debitorit, të cilës i është pamundësuar prapësimi brenda afatit ligjor.

24. Aktvendimi K.DH.SH.II nr. 308/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 12.10.2022.

Për shkak se e punësuar në personin juridik – debitorin, ka refuzuar pa ndonjë arsye të ligjshme të pranojë Urdhrin Përmbarimor të lëshuar nga Organi Përmbarimor, dorëzuesi ka lënë këtë shkresë në lokalet punuese të debitorit. Komunikimi i tillë i kësaj shkrese është konsideruar i ligjshëm nga ana e gjykatës, dhe afati shtatë (7) ditor për ushtrimin e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga dita e nesërme.

Kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim, ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm - faturave, në emër të borxhit.

Përmbaruesi Private ka lejuar përmbarimin me Urdhrin P.nr. 145/20 të datës 11.03.2020, ndaj të cilit urdhër debitori ka paraqitur prapësim me datën 27.03.2020, ndaj së cilit prapësim kreditori ka paraqitur përgjigje.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin PPP.nr. 551/20 e datës 12.11.2020, ka hedhur poshtë prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 154/20 të datës 11.03.2020, të lejuar nga Përmbaruesi Privat, për shkak të borxhit, si të pasafatshëm.

Gjykata ka vendosur që ta hedhë prapësimin e debitorit si të pasafatshëm, me arsyetimin se Urdhri për Përmbarim P.nr.154/2020 i datës 11.03.2020, në bazë të fletë-dërgesës që gjendet në shkresat e lëndës, shihet se debitorëve ju është lënë në ambientet e objektit të debitorit me datën 12.02.2020, në ora 13:20, pasi që urdhrin për përmbarim ka refuzuar ta nënshkruajë personi i cili ka qenë prezent në zyrën e debitorit, andaj ky dorëzim është konsideruar si i rregullt, e që në urdhrin për përmbarim është dhënë këshilla juridike se ndaj tij, debitori mund të ushtrojë prapësim në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit.

Gjykata ka shtuar se debitori prapësimin kundër urdhrit për përmbarim e ka dorëzuar pas afatit, me datën 23.03.2020 përmes shërbimit postar të Kosovës. Andaj, nga kjo gjendje gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se debitori prapësimin kundër Urdhrit Përmbarimor mbi lejimin e përmbarimit nuk e ka paraqitur brenda afatit ligjor ashtu sipas Nenit 70 të LPP-së, kështu që në bazë të Nenit 73 paragrafi 3 të LPP-së, ka vendosur sikurse në dispozitiv.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën e bazuar dhe aktvendimin e shkallës së parë ta anulojë dhe prapësimin e debitorit ta llogarisë si të afatshëm.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në ankesë dhe ka propozuar që ankesën e debitorit ta refuzojë si të pabazuar dhe aktvendimin e ankimuar ta vërtetojë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II nr. 308/22, të datës 12.10.2022, ka refuzuar të pathemeltë ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 551/20 e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 12.11.2020.

Sipas gjykatës ankimore, gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur ka hedhur poshtë si të pasafatshëm prapësimin e debitorit. Sipas Nenet 70 të LPP-së, përcaktohet se: *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve, pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrit përmbarues”,* në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur pas kalimit të afatit 7 ditor. Sipas gjykatës, Neni 112 i LPK-së ka përcaktuar qartë se:

“Kur personi të cilit i është dërguar shkresa, përkatësisht anëtar i rritur i familjes së tij, përkatësisht personi i autorizuar ose i punësuar në organin shtetëror apo në personin juridik, pa ndonjë arsye të ligjshëm refuzon ta marrë në dorëzim shkresën, dorëzuesi do t’ia lejë në banesë ose në lokalet në të cilat punon personi i tillë apo do t’ia bashkëngjis shkresën në derën e banesës apo lokalit të punës. Në fletë dërgesë do të shënohet dita, ora dhe shkaku i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë shkresa. Komunikimi i kryer në këtë mënyrë quhet i ligjshëm”.

Sikurse gjykata e shkallës së parë, edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, ka konsideruar se pranimi i shkresës është bërë në mënyrë të rregullt, dhe kjo është vërtetuar përmes fletë dërgesës për dorëzim personal, në të cilën është shënuar qartë se: *“Me datën 12.03.2020 ne ora 13:20 u bë tentimi për dorëzimin e urdhrit tek debitori. Prezent ishte punëtorja V.K. e cila e refuzoi nënshkrimin, urdhri iu la në ambientet e objektit të debitorit”.* Si rrjedhojë, afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 13.03.2020.

Andaj, fakti se debitori prapësimin e ka dorëzuar përmes postës me datën 23.03.2020 e që tek Përmbaruesi Privat është pranuar me datën 27.03.2020, rezulton se prapësimi është paraqitur pas afatit ligjor dhe si datë e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 19.02.2020, brenda të cilit afat debitori nuk ka vepruar, gjegjësisht nuk ka ushtruar prapësim brenda këtij afati të përcaktuara me dispozitat juridike të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

25. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 424/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 26.01.2023.

Përgjegjësia për rregullimin e mënyrës së pranimit të shkresave zyrtare, dhe për caktimin e rregullave dhe përgjegjësive për personat përgjegjës për pranimin e tyre, i përket individualisht secilit person juridik. Top of Form

Kreditori me datë 28.12.2020, ka paraqitur Propozim për Përmbarrim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës së datës 26.10.2020, në shumën përkatëse.

Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas Propozimit për Përmbarrim të datës 28.12.2020, ka marrë Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 217/2020 të datës 28.12.2020, përmes të cilit ka lejuar përmbarrimin e propozuar nga kreditori në bazë të faturës së datës 26.10.2020.

Debitori me datë 06.01.2020, ka pranuar propozimin për lejimin e përmbarrimit së bashku me Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 217/2020 të datës 28.12.2020. Kundër këtij Urdhri, debitori me datë 10.02.2021 ka paraqitur prapësim me të cilën ka kërkuar që të anulohet urdhri për përmbarrim, për faktin se i njëjti nuk është pranuar nga personi përgjegjës.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë, me Aktvendimin PPP.nr. 273/21 të datës 22.04.2021, ka hedhur poshtë si të pasafatshëm prapësimin e debitorit të parashtruar me datë 10.02.2021 ndaj Urdhrit për Përmbarrim P.nr. 217/2020, të datës 28.12.2020, për shkak se i njëjti është paraqitur pas kalimit të afatit të përcaktuar me Ligjin për Procedurën Përmbarrimore - LPP.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor debitori ka parashtruar ankesë me propozimin që të aprovohet në tërësi ankesa e tij si e bazuar dhe të konstatohet se prapësimi është paraqitur në afatin e paraparë ligjor, si dhe çështja të procedohet më tutje, ose të ndërpritet procedura përmbarrimore dhe çështja të referohet në kontest civil, respektivisht të shpallet jokompetente Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, dhe lënda të kalojë në kompetencë të Departamentit Ekonomik, të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr. 424/22, të datës 26.01.2023, ka refuzuar si të pathemeltë ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 273/21 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, të datës 22.04.2020. Dhoma e Shkallës së Dytë, ka vlerësuar se është vendosur drejtë kur është hedhur si i pasafatshëm prapësimi i debitorit.

Pra, konkludimin se prapësimi ka qenë i pasafatshëm e ka pranuar edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar se nga fletë-kthesa ekzistuese për dorëzim personal evidentohet se debitori, respektivisht përfaqësuesi i debitorit, ka pranuar propozimin për përmbarrim me datë 06.01.2020.

Përveç pranimit të këtij urdhri, Përmbarruesi Privat ka vazhduar procedurën e përmbarrimit duke marrë një sërë veprimesh tjera për të cilat debitori ka qenë i mirinformuar, ndër të cilat edhe procesverbalin mbi regjistrimin dhe vlerësimin e sendeve të datës 02.02.2020, të cilin debitori ka refuzuar ta nënshkruajë.

Përkundër këtyre veprimeve për të cilat debitori ka qenë në dijeni, i njëjti prapësimin e ka parashtruar me datë 10.02.2021, që nënkupton se debitori e ka atakuar urdhrin për përmbarrim të Përmbarruesit Privat jashtë çdo afati ligjor.

Kjo për faktin se debitori as me prapësim nuk ka qenë në gjendje dhe as nuk ka bërë ndonjë përpjekje të sqarojë se kur ka qenë koha e pranimit të propozimit për përmbarrim, respektivisht kur ka kuptuar për inicimin e procedurës përmbarrimore.

Në një gjendje të tillë të fakteve kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me faktin se me prapësim nuk është atakuar afatshmëria dhe as nuk është kërkuar kthimi eventual në gjendje të mëparshme, ka për detyrë që të kujdeset për afatin e parashtrimit të prapësimit.

Rrjedhimisht, gjykata e shkallës së parë me faktin se afatshmëria nuk është kontestuar me prapësim, ka vepruar drejtë kur e ka hedhur si të pasafatshëm prapësimin e debitorit, edhe për faktin se nëse pala nuk thirret në parregullsi, gjykata e shkallës së parë nuk ka tagër të përcaktojë afat të ri për debitorin, dhe të marrë si të mirëqenë pranimin e propozimit për përmbarrim.

Sipas pretendimeve ankimore të parashtruesit të ankesës koha e pranimit të urdhrit dhe propozimit për përmbarrim, dhe pranimi si i tillë nuk është kontestues, por kontestues është vetëm mënyra e dorëzimit, respektivisht se nuk është pranuar nga personi përgjegjës, me emër dhe mbiemër. Së këndejmi, Gjykata potencon se është më rëndësi fakti se as me prapësim dhe as me ankesë debitori nuk e konteston afatshmërinë e pranimit të propozimit për përmbarrim, çka nënkupton se nuk është mohuar asnjëherë pranimi i propozimit për përmbarrim, por kontestohet vetëm se shkresa nuk është pranuar nga personi përgjegjës.

Gjykata ankimore ka vlerëson se nuk i takon gjykatave të bëjnë vlerësime individuale të nënshkrimit të pranuesit të shkresave, respektivisht i takon secilit person juridik individualisht që të bëjë rregullimin e brendshëm të mënyrës së pranimit të shkresave zyrtare dhe të caktojë rregullat dhe përgjegjësitë për personat përgjegjës për pranimin e shkresave.

Në këtë drejtim Dhoma e Shkallës së Dytë çmon se kjo gjykatë ka tagër për të shqyrtuar vetëm shkaqet e paraqitura ankesë, gjë që pretendimi se propozimi për përmbarrim nuk është pranuar nga personi me emër e mbiemër nuk mund të qëndrojë, përderisa debitori sipas të njëjtit pranim ka ushtruar prapësimin e pasafatshëm.

Një vendosje të tillë e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, do ta gjeni edhe në Aktvendimin Kom.Dh.Shk.II.nr.777/22 e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, të datës 26.01.2023.

26. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 777/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës
- Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 26.01.2023.

Pretendimi se propozimi për përmbarim nuk është pranuar nga pronari i personit juridik nuk mund të jetë shkak ankimor, përderisa personi tek debitori ka marrë përsipër pranimin e shkresave, në emër dhe llogari të debitorit – si person juridik.

Kreditori me datë 18.10.2018, ka paraqitur Propozim për Përmbarim ndaj debitorëve në bazë të dokumentit përmbarimor – Kredisë Hipotekare.

Debitori në adresën e selisë së personit juridik ka pranuar propozimin për lejimin e përmbarimit me datë 26.10.2018. Kundër këtij urdhri, debitori me datë 04.12.2018 ka paraqitur prapësim me të cilën ka kërkuar që të anulohet urdhri për përmbarim.

Gjykata Themelore në Mitrovicë me Aktvendimin PPP.nr. 271/2018 të datës 18.11.2020, ka hedhur poshtë si të pasafatshëm prapësimin e debitorit të paraqitur me datë 04.12.2018 ndaj Urdhrit për Përmbarim P.nr. 399/2018 të datës 18.10.2018, të Përmbaruesit Privat.

Kundër aktvendimit të lartcekur, debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë, me propozimin që të aprovohet ankesa e debitorit në tërësi si e bazuar, dhe të vendoset prapësimi i ushtruar është paraqitur brenda afateve ligjore, dhe të merret parasysh fakti se dorëzimi nuk është bërë në mënyrë të rregullt pasi që propozimi për përmbarim nuk është pranuar nga pronari, por nga një person tjetër i paautorizuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr. 777/22, të datës 26.01.2023, ka refuzuar si të pathemeltë ankesën e debitorit të parë, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 271/2018 e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, të datës 18.11.2020.

Konkludimin e gjykatës së shkallës së parë se prapësimi ka qenë i pasafatshëm e ka pranuar edhe Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar se nga fletë-kthesa është evidentuar se debitori, respektivisht personi të cilin debitori e ka lënë në këtë adresë, me datë 18.10.2018 ka pranuar propozimin për përmbarim. Debitori e ka parashtruar prapësimin ndaj urdhrit të Përmbaruesit Privat me datë 04.12.2021, që nënkupton se debitori e ka atakuar urdhrin për përmbarim të Përmbaruesit Privat jashtë çdo afati ligjor. Kjo Gjykatë ka përmendur gjithashtu faktin se Përmbaruesi Privat ka vazhduar procedurën e përmbarimit duke marrë një sërë veprimesh, ndër të cilat edhe bllokimin e llogarive bankare, për të cilat ka qenë i vetëdijshëm edhe vet debitori.

Pretendimi se propozimi për përmbarim nuk është pranuar nga pronari i personit juridik nuk mund të jetë shkak ankimor, përderisa personi tek debitori ka marrë përsipër pranimin e shkresave në emër dhe llogari të personit juridik, këtu debitorit.

Gjykata vlerëson se nuk i takon gjykatave të bëjnë vlerësime individuale të nënshkrimit të pranuesit të shkresave, respektivisht i takon secilit person juridik siç është këtu debitori, që individualisht të bëjë rregullimin e brendshëm të mënyrës së pranimit të shkresave zyrtare dhe të caktojë rregullat dhe përgjegjësitë për personat përgjegjës për pranimin e shkresave.

27. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 26/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 21.03.2023.

Propozimi për Përmbarrim duhet tu dorëzohet personalisht debitorit. Anëtarëve të familjes së debitorëve apo edhe fqinjëve, dorëzimi i shkresave mund tu bëhet vetëm nëse personi që duhet dorëzuar shkresa, nuk gjendet në banesën e vet në kohën e caktuar sipas njoftimit të lënë nga dorëzuesi, përkitazi me Nenin 110 dhe 111 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Kreditori, me datë 16.10.2017 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbarrimit ndaj debitorëve, në bazë të dokumentit përmbarrues: Kontratave për Kredinë të datave 26.06.2012, 17.06.2011, 22.12.2011, aneksi i ri i programimit të kredisë sipas kontratës së kredisë të datës 26.06.2012 dhe kontratës mbi hipotekën, të datës 26.06.2012 për borxhin në shumën përkatëse.

Përmbarruesi Privat duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit, me Urdhrin Përmbarrimor P.nr.302/17, të datës 16.10.2017, ka lejuar përmbarrimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitorët me datë 02.11.2017 kanë ushtruar prapësim duke theksuar se vlerësimi i pronave të hipotekuara nuk është bërë drejtë, dhe të njëjtit kanë kërkuar që të caktohet vlerësues i licencuar i paluajtshmërive.

Gjykata Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec me Aktvendimin PPP.nr. 62/17, të datës 22.05.2020, e ka hedhur poshtë si të pasafatshëm prapësimin e debitorëve të parashtruar kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr.302/17 të Përmbarruesit Privat, të datës 16.10.2017.

Gjykata ka theksuar se në shkresat e lëndës ka gjetur se në rastin konkret debitori e ka paraqitur prapësimin pas kalimit të afatit ligjor prej 7 ditëve e që një fakt të tillë gjykata e ka vërtetuar nga flet-kthesa ekzistuese dhe nga e cila konstatohet se debitori urdhrin me të cilin është caktuar përmbarrimi sipas propozimit të kreditorit të njëjtin e ka pranuar më datë 21.10.2017, ndërsa prapësimin e ka paraqitur përmes postës rekomandë, me datë 02.11.2017, që i bie në ditën e njëmbëdhjetë (11).

Kundër këtij aktvendimi debitorët brenda afatit ligjor kanë ushtruar ankesë, me propozimin që Aktvendimin PPP.nr. 62/17 e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec, të datës 22.05.2020 ta anulojë, dhe si rezultat të anulojë Urdhrin e Përmbarruesit Privat, dhe propozimin për përmbarrim ta refuzojë si të pa bazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr. 26/22, të datës 21.03.2023, ka aprovuar ankesën e debitorëve, dhe si rezultat ka prishur Aktvendimin PPP.nr. 62/17 të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, të datës 22.05.2020, duke kthyer çështjen në rigjykim dhe rivendosje, pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka vlerësuar se propozimi për përmbarrim nuk është pranuar në mënyrë të rregullt, pasi që me datë 21.10.2017, propozimi për përmbarrim është pranuar nga familjarët e debitorëve, gjegjësisht djali dhe vëllai i debitorëve, dhe për këtë shkak ligjor Urdhri Përmbarrimor nuk mund të ekzekutohet, për shkak se propozimi për përmbarrim, është pranuar në mënyrë jo të rregullt nga familjarët e debitorëve.

Gjykata ankimore, në kuptim të Nenit 110 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka konstatuar se propozimi për përmbarim bën pjesë në shkresat të cilat debitorëve duhet tu dorëzohet personalisht.

Kjo gjykate ka vlerësuar se anëtareve të familjes u bëhet dorëzimi i shkresave vetëm po që se personi që duhet dorëzuar shkresa, nuk gjendet në banesën e vet, konform Nenit 110 të LPK-së. Pra, për tu aplikuar mundësia e përcaktuar me Nenin 111 të LPK-së, paraprakisht duhen konsumuar përcaktimet e ofruara me Nenin 110 të po këtij ligji, gjegjësisht së pari personit të cilit duhet t'i dorëzohet personalisht shkresa dhe u cili nuk gjendet në adresën ku duhet të bëhet dorëzimi, dorëzuesi njoftohet se kur dhe ku do mund ta gjejë këtë person, dhe do t'i lë njoftimin për pranimin e shkresës në kohën dhe vendin e caktuar.

Vetëm në rast se dorëzuesi nuk e gjen personin në vendin dhe kohën e caktuar sipas njoftimit të lënë adresatit, ai do të veprojë sipas Nenit 111 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, dorëzimi do të bëhet duke iu dhënë shkresa ndonjë anëtar të rritur të familjes së tij, e po që se as këta nuk gjenden në banesë, shkresa do t'i jepet fqinjit, po që se pajtohet me një gjë të këtillë.

28. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 378/2022 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 14.04.2023.

Dorëzimi i shkresave nga Përmbauesi Privat për Administratën Tatimore të Kosovës në filialin e saj në Ferizaj, është konsideruar si jo i rregullt nga ana e gjykatës, për faktin se Përmbauesi Privat ka qenë i informuar se shkresat në drejtim të ATK-së duhet të dorëzohen vetëm në selinë e saj në Prishtinë, dhe jo në një filial të saj në ndonjë qytet tjetër.

Kreditori me datën 08.10.2020, ka paraqitur propozim për përmbaerim ndaj debitorit – Administratës Tatimore të Kosovës, në bazë të dokumentit përmbaerimor, Vendimit – Raportit të Kontrollit të 23.11.2017.

Përmbauesi Privat duke vepruar sipas propozimit për përmbaerim të kreditorit, me Urdhrin Përmbaerimor P.nr.286/20 të datës 08.10.2020, ka lejuar përmbaerimin me të cilën është detyruar debitori që kreditorit në emër të rimbursimit të TVSH-së brenda afatit prej 60 ditëve pas paraqitjes se kërkesës për rimbursim, t'ia paguaj shumën përkatëse, me kamatëvonesë prej 8% nga data 06.02.2018 ,si edhe shpenzimet përmbaerimit.

Kundër këtij urdhri, me datën 22.10.2020 debitori ka ushtruar prapësim se bashku me kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme, duke pretenduar se shkresat në të cilat është thirrur kreditori dhe mbi të cilat është lejuar përmbaerimi, nuk paraqesin dokumente të besueshme. Sipas debitorit, Raporti i datës 23.11.2017 dhe Formulari i Deklarimit të TVSH-së, nuk janë dokumente të besueshme për faktin se efekti juridik i tyre është pezulluar me shkresën e datës 31.01.2021 me të cilën kreditori është njoftuar se rimbursimi është në mbajtje për qëllim të verifikimit – hetimit, për arsye se ATK ka informata se faturat të cilat me kontroll janë pranuar si fatura të rregullta, dyshohen se janë fatura fiktive dhe si të tilla do të verifikohen nga njësia e Hetimeve Tatimore, me autorizim të Prokurorit të Shtetit. Ndërkaq, kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme është paraqitur me arsyetimin se debitori ka humbur afatin e rregullt për paraqitje të prapësimi, për shkak se organi përmbaerimor nuk ka realizuar si duhet komunikimin e shkresave në drejtim të debitorit, gjegjësisht nuk ka dorëzuar Urdhrin Përmbaerimor në selinë qendrore të debitorit, por në filialin e saj në Komunën e Ferizajit.

Gjykata Themelore në Ferizaj me Aktvendimin PPP.nr. 335/20 të datës 19.03.2021, ka hedhur poshtë si të pasafatshëm prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbaerimit P.nr. 286/2020 të datës 08.10.2020 të lëshuar nga Përmbauesi Privat. Gjykata ka arsyetuar se debitori ka pranuar Urdhrin Përmbaerimor me datë 12.10.2020, ndërsa prapësim e ka ushtruar me datë 22.10.2020, pra duke vlerësuar se debitori ka ushtruar prapësim jashtë afatit të paraparë ligjor.

Kundër atij aktvendimi, debitori në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar dhe aktvendimin e ankimuar dhe Urdhrin Përmbaerimor ta anulojë, dhe çështjen ta kthejë në shkallë të parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 378/2022, të datës 14.04.2023, ka aprovuar të themeltë ankesën e debitorit, ka anuluar Aktvendimin PPP.nr. 335/20 të Gjykatës Themelore në Ferizaj, dhe ka kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje, pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Parë.

Gjykata ka ardhur në një vendosje të tillë për faktin se në shkresat e lëndës gjendet emali i komunikimit, gjegjësisht kërkesa e ATK-së drejtuar Odës së Përmbauesve Privat, lidhur me adresimin e shkresave që duhet tu dorëzohen Administratës Tatimore të Kosovë selinë qendrore të saj, dhe jo në ndonjë filial tjetër të saj. Ky e-mail mbanë datën 02.07.2020, dhe përmban kërkesën sikurse në vijim:

“Ju lutemi qe tua shpërndani të gjithë Përmbauesve Privat në tërë territorin e Republikës së Kosovës këtë kërkesë me qellim që të gjitha shkresat (Urdhër, Konkluzione, Kërkesa etj.) që ndërliken me Administratën Tatimore të Kosovës, t’i adresojnë në formë zyrtare, në formë fizike përmes protokollit, në adresën: ‘Këndi i Rrugëve Dëshmoret e Kombit dhe Bill Clinton’ për Departamentin e Shërbimeve Juridike - Divizioni për Përfaqësime dhe Bashkëpunim Ndërinstitucional në objektin e Drejtorisë së Përgjithshme të ATK-së, në Prishtinë”.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka vlerësuar se debitori nuk është njoftuar në mënyrë të ligjshme sipas dispozitave të Nenit 104 të LPK-së, dhe komunikimi me palën ka qenë jo i rregullt, ngase edhe përkundër faktit se debitori e ka njoftuar odën e përmbauesve për mënyrën dhe adresën në të cilën do të komunikohet, Përmbauesi Privat gabimisht e ka dërguar shkresën në filialin e saj në Ferizaj, dhe jo në selinë qendrore ku është dashur të pranohet shkresa. Rrjedhimisht, debitori nuk është njoftuar me kohë për urdhrin, respektivisht i është humbur afati për paraqitje e prapësimit.

Sipas gjykatës ankimore, gjykata e shkallës e parë ka shpërfillur këtë fakt dhe nuk e ka trajtuar fare, rrethanë kjo e cila ka shkaktuar që vendimi i gjykatës së shkallës së parë të jetë i paqëndrueshëm.

29. Aktvendimi K.DH.Shk II.nr. 36/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 10.05.2023.

Konsiderohet se faturat në bazë të të cilave është iniciuar përmbarimi, janë dorëzuar në mënyrë të rregullt te debitori i përmbarimit, përkundër faktit se debitori ka pranuar të njëjtat vetëm përmes vendosjes së nënshkrimit, pa vendosur vulën e subjektit të tij afarist në këto fatura.

Kreditori me datë 21.04.2022, ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave të datave 15.07.2021, 30.07.2021, 15.08.2021, 15.09.2021, 30.09.2021, 15.10.2021, dhe 30.11.2021 në shumën përkatëse.

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me Urdhrin Përmbarimor P.nr. 205/22, të datës 22.04.2022, ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim duke theksuar se faturat me të cilat është lejuar propozimi përmbarim nuk përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbarimit siç është përcaktuar me Nenin 21, 29, par 1.13 dhe par.3 të LPP-së sepse nuk janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, ngase nuk janë të vulosura nga debitori, dhe urdhri për lejimin e përmbarimit është nxjerrë mbi bazën e dokumenteve të cilat nuk kanë qenë në origjinal por kopje, e që kjo është në kundërshtim me dispozitën e Nenit 36 pika 1 të LPP-së.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori brenda afatit ligjor duke theksuar se janë të pa bazuara pretendimet e debitorit në prapësim pasi që të gjitha faturat janë të nënshkruara nga debitor. Po ashtu, ka theksuar se dokumenti në bazë të cilit është propozuar përmbarimi – faturat, janë në origjinal dhe i përmbajnë të gjitha elementet e nevojshme të parapara me Ligjin për Procedurën Përmbarimore.

Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PPP.nr. 470/22 të datës 27.09.2022, ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr. 205/22 të datës 22.04.2022.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka theksuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim të dokumenteve të besueshme, të cilat janë pranuar nga debitori, gjegjësisht janë nënshkruar nga ana e tij.

Kundër këtij aktvendimi, debitori në afatin ligjor ka ushtruar ankesë me pretendimin se faturat nuk janë pranuar nga ai. I njëjti ka propozuar që Gjykata e Shkallës së Dytë të aprovojë ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr. 470/22, i datës 27.09.2022, apo i njëjti të anulohet.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.Shk II.nr. 36/23, të datës 10.05.2023, ka refuzuar të pathemeltë ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 470/22 e Gjykatë Themelore në Prishtinë, të datës 27.09.2022.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit lidhur me atë se faturat nuk janë të pranuar nga ana e debitorit, për faktin se nga shkresat e lëndës, vërtetohet se faturat si dokumente të besueshme, mbi bazën e së cilave është lejuar përmbartimi janë të nënshkruara dhe të pranuar nga ana e debitorit, dhe rrjedhimisht, të njëjtat mund të konsiderohen si dokument i besueshëm për përmbartim në kuptim të dispozitës së Nenit 29 dhe 21 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Megjithatë, një vendosje e tillë e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë nuk është e unifikuar, për faktin se një vendosje krejtësisht ndryshe të kësaj gjykate në një rast pothuajse identik, mund ta gjeni në Aktvendimin K.DH. SH.II.nr. 175/23, të datës 07.07.2023.

30. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1342/2022 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 22.05.2023.

Gjatë realizimit të procedurës përmbartimore, duhet t'ikushtohet rëndësi të veçantë dorëzimit personal të shkresave nga organi përmbartimor, dhe pranimit të tyre nga palët në procedurën përmbartimore, në adresat e tyre të sakta.

Kreditori me datën 18.12.2019 ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave, të datave 14.09.2016, 12.01.2017, 20.02.2017, 03.02.2017, 28.02.2017, 28.02.2017, 01.04.2017, 24.04.2017, 15.07.2019, 15.07.2019.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, me Urdhrin Përmbartimor P.nr.304/2019, të datës 18.12.2019, ka lejuar përmbartimin me të cilën debitori është detyruar që kreditorit në emër të borxhit nga faturat, t'i paguajë shumën përkatëse me kamatë prej 8% nga dita e arritshmërisë së kërkesës deri në pagesën përfundimtare, si dhe tërë shpenzimet e përmbartimit.

Kundër këtij urdhri, me datën 03.01.2020, debitori ka ushtruar prapësim, duke theksuar se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar propozimi për përmbartim nuk e përmbajnë kohën e përmbushjes së detyrimit monetar, pastaj fatura e datës 14.09.2016 vlerësuar datën e ushtrimit të propozimit për përmbartim dhe datën e kësaj fature del se në këtë rast kemi parashkrim të kësaj kërkesë nga kjo faturë sepse kemi kalim të afatit prej më tepër se tre (3) vite kjo bazuar në Nenin 355 të LMD-së. Sipas debitorit, kreditori me asnjë provë nuk ka dëshmuar se faturat janë lëshuar në bazë të një kontrate ose marrëveshje, detyrimi përmbushjen e të cilit e kërkon kreditori nga fatura e datës 14.09.2016 është parashkruar dhe e cila po të shikohet me vëmendje përmban një firmë pranimi që dallon krejtësisht nga firma e pranimit të faturave tjera nga debitori. Andaj, debitori është i bindur se as këtë faturë nuk e ka pranuar, andaj propozon që gjykata ta aprovojë në tërësi këtë prapësim, ta anulojë Urdhrin Përmbartimor dhe kreditori të obligohet t'i paguajë të gjitha shpenzimet përmbartimore.

Kreditori me datën 06.01.2020, ka ushtruar përgjigje në prapësimin e debitorit, me arsyetimin se debitori ka qenë i njoftuar rregullisht me shumën e borxhit ndaj kreditorit, të gjitha faturat e lëshuara janë të bazuara në kontrata të nënshkruara nga kreditori dhe debitori. Këto kontrata janë të nënshkruara me datë 30.09.2016, 07.10.2016, 23.04.2017. Të gjitha faturat janë të pranuar nga debitori, duke shtuar edhe faktin se debitori ka kontaktuar kreditorin përmes rrjeteve sociale me qëllim të negociimit lidhur me procesin e kthimit të borxhit. Si rezultat, ka propozuar që gjykata ta anulojë prapësimin e debitorit, dhe Urdhrin Përmbartimor ta lë ne fuqi.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin PPP.nr. 17/2020, të datës 12.04.2021, ka konsideruar të tërhequr Propozimin për Përmbartim të datës 18.12.2019 të kreditorit, ndërsa ka anuluar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 304/19 të datës 18.12.2019.

Gjykata ka arsyetuar se me datën 12.03.2021, ka nxjerrë konkluzion me të cilin ka vendosur se të gjitha dorëzimet ndaj kreditorit do të bëhen përmes afishimit në tabelën e shpalljeve, ku dorëzimet do të konsiderohen të kryera në afatin prej shtatë (7) ditëve nga dita e publikimit në tabelën e shpalljeve.

Një konkluzion i tillë i gjykatës, ka ardhur si rezultat i flet-kthesës së pranuar nga posta, në të cilën nëpunësi postar ka shënuar se: *“Pala është shpërngulur, lokali është mbyll – dt.01.10.2020”*.

Gjykata përmes tabelës së shpalljeve, ka kërkuar nga kreditori që të plotësojë propozimin për përmbarim, gjegjësisht të dorëzojë në origjinal apo kopje të vërtetuara dokumentet në të cilat është mbështetur propozimi për përmbarim. Pasi që kreditori nuk ka vepruar sipas kërkesës së gjykatës për plotësimin e propozimit brenda këtij afati, gjegjësisht nuk ka dorëzuar në origjinal apo kopje të vërtetuara dokumentet në të cilat është mbështetur propozimi për përmbarim, atëherë gjykata në përputhje me Nenin 102 par. 3 të LPK-së, ka konsideruar se i njëjti ka tërhequr propozimin për përmbarim.

Kundër këtij aktvendimi, kreditori brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktvendimin e ankimuar ta ndryshojë apo lëndën ta kthejë në rishqyrtim apo rivendosje.

Përmes Aktvendimit të datës 22.05.2023, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, ka aprovuar të themeltë ankesën e kreditorit, ka anuluar Aktvendimin PPP.nr. 17/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 12.04.2021, dhe ka kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Parë.

Për Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i papranueshëm. Kjo për faktin se në shkresat e lëndës gjendet fletë-kthesa e datës 08.11.2021 me të cilën kreditorit i është dorëzuar Aktvendimi P.nr. 17/2020 i datës 12.04.2021 përmes Postës, të cilën fletë kthesë kreditori e ka pranuar me datën 10.11.2021, dhe nga kjo shihet se kjo adresë është e njëjta sikur në fletë kthesën e mëhershme të datës 25.09.2020 me të cilën kreditorit i është dorëzuar përmes postës Konkluzioni i datës 15.09.2020, në të cilën postieri ka konstatuar se *“Pala është shpërngulur, lokali është mbyll – dt.01.10.2020”*. Pra, bëhet fjalë për të njëjtën adresë.

Sipas gjykatës ankimore, gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar drejtë dhe me seriozitet për analizimin e fakteve dhe konstatimin e gjendjes, por bazuar në konstatimin e ofruar nga nëpunësi postar, ka vendosur ta konsiderojë të tërhequr propozimin për përmbarim të kreditorit.

31. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1320/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 16.06.2023.

Fatura në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi ka një nënshkrim por e njëjta është e pavulosur me vulën e protokollit nga organi kompetent i debitorit si Institucion Publik, element ky bazë që shpreh vërtetësinë dhe autenticitetin e një dokumenti, se i njëjti është pranuar në mënyrë të rregullt dhe është evidentuar ne regjistrat e institucionit publik (debitorit).

Kreditori me datën 26.08.2020, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës së datës 15.05.2020.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me Urdhrit Përmbarimor P.nr. 197/20 të datës 26.08.2020, ka lejuar përmbarimin, me të cilën është detyruar debitori që kreditorit në emër të borxhit nga fatura e cila rrjedh nga Kontrata e datës 14.03.2019, t'ia paguaj shumën përkatëse, me kamatë prej 8% si dhe shpenzimet përmbarimore.

Kundër Urdhrit Përmbarimor, debitori ka paraqitur prapësim me datën 18.09.2020, me pretendimin se fatura nuk është e protokolluar, nga kjo arsye i mungon edhe data e pranimit, si rrjedhojë e njëjta nuk është pranuar dhe dorëzuar tek organi kompetent - Drejtoria e Prokurimit ku së bashku me faturën ka qenë dashtë të jete edhe raporti i menaxherit (libri për ditët e kryera) i nënshkruar nga të dyja palët. Fatura nuk e ka titullin e dokumentit të besueshëm siç është përcaktuar me Nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Ndaj prapësimin të debitorit, me datën 21.09.2020, kreditori ka parashtruar përgjigje, duke arsyetuar se pretendimet e debitorit ne prapësim janë parashtruar vetëm sa për ta bërë konfuze çështjen sepse nga vet prapësimi i debitorit vërehet se as vet ai nuk e ka të qartë se mbi çfarë baze e kundërshton borxhin ndaj kreditorit. Tutje, ka shtuar se fatura është dorëzuar në origjinal dhe e nënshkruar nga debitori ndërsa është bashkangjitur edhe pranimi teknik profesional i punimeve dhe certifikata e pranimit të punimeve.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega ne Lipjan, me Aktvendimin PPP.nr. 50/20 të datës 16.04.2021, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr. 197/20 të datës 026.08.2020, të lëshuar nga Përmbaruesi Privat.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se fatura është e përshtatshme për përmbarim ngase i përmban të gjitha elementet e parapara me dispozita ligjore nga Neni 27 i LPP-së, fatura është në origjinal, e nënshkruar dhe përmban datën e pranimit dhe debitori ka qenë i detyruar ta bëj pagesën e detyrimit ndaj kreditorit. Gjykata ndër të tjera ka theksuar se debitori me asnjë provë nuk ka argumentuar të kundërtën e asaj që është vendosur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe aktvendimin e atakuar ta prishë dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesën e debitorit ka ushtruar kreditori me pretendimin se nuk qëndrojnë arsyet e dhëna nga debitori, andaj ka propozuar që gjykata e shkallës së dytë ta refuzojë ankesën e debitorit dhe aktvendimin e atakuar ta vërtetojë, ndërsa ta detyrojë debitorin t'i paguajë shpenzimet e procedurës përmbare.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 1320/22 , të datës 16.06.2023, ka aprovuar të themeltë ankesën e debitorit, ka anuluar Aktvendimin PPP.nr. 50/20 e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, e datës 16.04.2021, dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomën e Shkallës së Parë.

Sipas gjykatës ankimore, fatura e datës 15.05.2020, në bazë të cilës është lejuar përmbaremi, ka një nënshkrim por e njëjta është e pavulosur me vulën e protokollit nga organi kompetent i debitorit si Institucion Publik, element ky bazë që shpreh vërtetësinë dhe autenticitetin e një dokumenti, pra faktin se i njëjti është pranuar në mënyrë të rregullt dhe është evidentuar në regjistrat e institucionit.

Nga kjo ka rezultuar se kjo faturë si e tillë, nuk është në pajtim me Nenin 29 të LPP-së i cili qartë ka përcaktuar se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbaremi po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Një vendosje të tillë të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, mund ta gjeni edhe në Aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr. 355/23 të datës 19.06.2023, dhe në Aktvendimin K.Dh.shk.II.nr. 890/23, të datës 10.10.2023.

32. Aktvendimi K.Dh.Sh.II.nr. 355/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 19.06.2023.

Faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbartimi, nuk plotësojnë kushtet sipas ligjit për të qenë dokument i besueshëm, pasi që të njëjtat nuk janë të pranuar dhe të protokolluara nga debitori, si institucion publik.

Kreditori, me datën 05.12.2018 ka paraqitur propozimin për përmbartim ndaj debitorit (institucion publik) në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave të datave 26.07.2012, 28.08.2012, 26.10.2016, dhe 08.08.2017 në shumën përkatëse në emër të borxhit, me kamatë prej 8% duke filluar nga dita kur ka qenë i obliguar të paguajë obligimin e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit me Urdhrin Përmbartimor P.nr. 419/18 të datës 05.12.2018, ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori ka ushtruar prapësim duke theksuar se kemi të bëjmë më parashkrim të borxhit, porse edhe sikur mos të kemi të bëjmë me parashkrim e konteston në tërësi si të pa bazuar urdhrin për lejimin e përmbartimit, ngase të gjitha faturat pranohen në drejtorinë për buxhet dhe financa të cilat vulosen me një vulë katrore dhe protokollohen, ka shtuar se këto fatura nuk vërtetohen se janë dorëzuar ndonjëherë tek debitori pasi që të njëjtat as nuk janë vulosur e as nuk janë të protokolluara në mënyrë që kreditori të vërtetonte se të njëjtat janë dorëzuar tek debitori. Po ashtu ka theksuar se faturat në fjalë nuk janë në origjinal as kopje të vërtetuara siç duhet të jenë. Debitori i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i tij si i bazuar, dhe të anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar kreditori dhe ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Parë, me Aktvendimin KPPP. nr. 131/2022, të datës 21.11.2022, ka aprovuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit, ka shfuqizuar Urdhrin për Përmbartim P.nr. 419/18 e datës 05.12.2018, të lëshuar nga Përmbartuesi Privat, dhe ka përfunduar në tërësi përmbartimin në këtë çështje përmbartimore.

Një vendosje e tillë ka ardhur për faktin se faturat mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbartim e mbi bazë e të të cilave Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin nuk i plotësojnë kushtet ligjore sipas Nenin 29 par. 1 të LPP-së. Të njëjtat nuk përmbajnë vulën e pranimit dhe të protokollimit e cila kërkohet sidomos te faturat e dërguara në Institucionet Shtetërore, siç është në këtë rast debitori. Gjykata ka theksuar se faturat përmbajnë nënshkrimin e pranimit mirëpo nuk dihet se kush i ka pranuar, konkretisht nuk dihet cilësia e personit që ka pranuar ato dhe nënshkrimi i së cilës gjendet në fatura a është person kompetent brenda debitorit për pranimin e tyre.

Kundër këtij aktvendimi, kreditori në afatin ligjor ka ushtruar ankesë me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit si e bazuar, të prishet aktvendimi i ankimuar dhe të mbetet në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr. 419/2018 i datës 05.12.2018, dhe ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.Dh.Sh.II.nr. 355/23, të datës 19.06.2023, ka refuzuar të pathemeltë ankesën e kreditorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin KPPP.nr. 131/2022 e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Parë, të datës 21.11.2022.

Gjykata e shkallës së dytë ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me çështjen e faturave. Edhe sipas gjykatës ankimore, faturat nuk i plotësojnë kushtet sipas ligjit për të qenë dokument i besueshëm, pasi që të njëjtat nuk janë të pranuar dhe të protokolluara nga debitori.

Për më tepër, përveçse faturat nuk janë të protokolluara nga debitorit, të njëjtat nuk përmbajnë as kohën e përmbushjes së detyrimeve monetare dhe nuk janë të vulosura nga debitori, elemente këto të parapara me dispozitat ligjore të LPP-së, e të cilat duhet plotësuar në mënyrë kumulative që të konsiderohen si dokumente të besueshme. Sipas dispozitës së Nenit 29, paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, përcaktohet se:

“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.

Një vendosje të tillë të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, mund ta gjeni edhe në Aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 1320/22, të datës 16.06.2023.

33. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 179/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 05.07.2023.

Në propozimin për përmbarrim, kreditori ka bashkëngjitur faturat në kopje të noterizuara, mirëpo të njëjtat nuk plotësojnë kushtet ligjore për tu përmbarruar sepse janë të panëshkruara dhe të pavulosura me vulën e protokollit nga organi kompetent i debitorit si Institucion Publik, element ky bazë që shpreh vërtetësinë dhe autenticitetin e një dokumenti, se i njëjti është pranuar në mënyrë të rregullt dhe është evidentuar në regjistrat e institucionit publik.”

Kreditori, me datë 02.12.2020 ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – tre Faturave të datës 28.10.2020.

Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 3052/20 të datës 02.12.2020, ka lejuar përmbarrimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedhë nga faturat, t'i paguajë shumën përkatëse, me kamatë prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër Urdhrit për lejimin e përmbarrimit, debitori me datën 08.12.2020, ka paraqitur prapësim, me pretendimin se faturat mbi të cilat bazohet propozimi për përmbarrim nuk janë dokumente të besueshme dhe nuk paraqesin titull ekzekutiv. Sipas debitorit, kreditori ka dështuar t'i bashkëngjisë provat e nevojshme propozimit për përmbarrim dhe në këtë rast ka bashkëngjitur vetëm faturat kopje, të cilat nuk i plotësojnë kushtet esenciale të parapara me Nenin 29 të LPP-së. Tutje ka shtuar se faturat nuk janë të nënshkruara nga palët, janë të paprotokolluara dhe janë të një-anshme, andaj i ka propozuar gjykatës të pranojë prapësimin, dhe Urdhrin Përmbarrimor ta shfuqizojë.

Përgjigje ndaj prapësimit të debitorit ka ushtruar kreditori me datën 15.12.2020, me arsyetimin se prapësimi i debitorit është i pabazuar ngase nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet nga Neni 71 i LPP-së. Kreditori ka shtuar se faturat për të cilat debitori pretendon se nuk janë të nënshkruara, ka deklaruar se ato janë të nënshkruara dhe të pranuar nga debitori, dhe se të njëjtat janë të noterizuara asht siç kërkohet me dispozitat ligjore.

Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PPP nr.106/2021 të datës 09.03.2022, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, të parashtruar ndaj Urdhrit Përmbarrimor P.nr.3052/20 të datës 02.12.2020, të lejuar nga Përmbarruesi Privat.

Gjykata ka arsyetuar se faturat në bazë të cilave është lejuar përmbarrimi janë në origjinal, janë të noterizuara, si dhe janë të nënshkruara nga debitori. Sipas kësaj gjykate, nuk ekziston asnjë nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të duhet të anulohet Urdhri Përmbarrimor.

Kundër këtij aktvendimi, debitori në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta pranojë këtë ankesë si të bazuar ndërsa aktvendimin e ankimuar ta anulojë, dhe çështjen ta kthejë në rivendosje në shkallë të parë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.179/23, të datës 05.07.2023, ka aprovuar ankesën e debitorit, ka anuluar Aktvendimin PPP.nr. 106/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 09.03.2022, dhe lëndën ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Parë.

Gjykata ankimore ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka analizuar saktë gjendjen faktike përkitazi çështjes së faturat në bazë të cilave është lejuar përmbarimi, se këto fatura a i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme në bazë të të cilave mund të realizohet përmbarimi.

Faturat, në bazë të cilave është lejuar përmbarimi edhe pse janë kopje të noterizuara të njëjtat nuk i plotësojnë kushtet ligjore për tu ekzekutuar sepse janë të panëshkruara dhe të pavulosura nga ana e debitorit, e që në rastin konkret, faturat janë të pavulosura me vulën e protokollit nga organi kompetent i debitorit si Institucion Publik, element ky bazë që shprehë vërtetësinë dhe autenticitetin e një dokumenti, se të njëjtat janë pranuar në mënyrë të rregullt dhe janë evidentuar në regjistrat e institucionit publik – në këtë rast debitorit.

34. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 175/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 07.07.2023.

Pranimi i faturës me vetëm vendosje të nënshkrimit, pa emër dhe mbiemër të personit i cili ka pranuar faturën, nuk paraqet bazë ligjore me të cilën do të konsiderohej se fatura është dorëzuar në mënyrë të rregullt, sepse e njëjta nuk përmban as vulën e debitorit.

Kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit (Shoqëri Tregtare) në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturave të datave 04.03.2020, 27.03.2020, 06.03.2020, 04.03.2020, 04.03.2020 dhe kartelës e subjektit nga data 01.01.2020 deri me datën 16.07.2020, me të cilat ka kërkuar që në emër të borxhit, t'ia paguajë shumën përkatëse, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit ka lejuar përmbarimin me Urdhrin P.nr.425/20, të datës 17.07.2020, ndërsa kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim, duke theksuar se Urdhri Përmbarimor është mbështetur në faturë e cila është kopje dhe nuk është vërtetuar në harmoni me ligjin në fuqi, dhe se nuk janë pranuar e konfirmuara nga debitori. Për këto shkaqe, ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, si i bazuar.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori, duke i propozuar gjykatës që ta refuzojë prapësimin e debitorit ndërsa urdhrin e Përmbaruesit Privat ta lejë në fuqi.

Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PPP.nr. 830/20, të datës 14.09.2020, ka vendosur të refuzojë si të pabazuar prapësimin e debitorit, të paraqitur kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.425/2020, i datës 20.07.2020, i lejuar nga Përmbaruesi Privat.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka theksuar se faturat në bazë të së cilave është lejuar përmbarimin, janë dokumente të besueshme dhe përbëjnë bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i kanë plotësuar kushtet ligjore nga Neni 29 të LPP-së, dhe ndër të tjera, ka theksuar se nuk janë plotësuar asnjëra nga shkaqet e parapara me Nenin 71 të LPP-së, për anulimin e urdhrit të Përmbaruesit Privat.

Kundër këtij aktvendimi debitori në afatin ligjor ka parashtruar ankesë, për çka i ka propozuar gjykatës së shkallës së dytë që ta aprovojë ankesën e debitorit dhe të anulohet aktvendimi i ankimuar, dhe ta kthejë lëndën në rivendosje, si dhe ta shfuqizojë Urdhrin Përmbarimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 175/23, të datës 07.07.2023, ka aprovuar të bazuar ankesën e debitorit, ka anuluar Aktvendimin PPP.nr. 830/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 14.09.2020, dhe ka kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomave të Shkallës së Parë.

Në lidhje me çështjen e dorëzimit të faturave, sipas gjykatës ankimore, nuk mund të kuptohet se si ka ardhur deri te një vendosje e tillë, për faktin se faturat e datës 04.03.2020, 27.03.2020, 06.03.2020, 04.03.2020, si dhe ajo e datës 04.03.2020, nuk mund të konsiderohen dokumente të besueshme në bazë të cilave mund të caktohet përmbartimi, përderisa nuk përmbajnë vulën nga ana e debitorit, dhe se nuk dihet qartë se kush i ka pranuar faturat në fjalë, duke marrë parasysh edhe faktin se të njëjtat, nuk kanë të cekur emrin dhe mbiemrin e pranuesit, por vetëm janë të nënshkruara, pa qenë e qartë se kush i ka nënshkruar këto fatura.

Sipas Dhomës së Shkallës së Dytë, pranimi vetëm me një nënshkrim, e cila nuk dihet emër dhe mbiemër nga personi i cili ka pranuar faturën nuk paraqet bazë ligjore me të cilën do të konsiderohej se fatura është dorëzuar në mënyrë të rregullt sepse e njëjta nuk përmban as vulën e debitorit.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka udhëzuar gjykatën e shkallës së parë që eventualisht të ftojë palët në seancë, për të vërtetuar nënshkrimin e faturës dhe pretendimet e tjera të palëve.

Megjithatë, një vendosje ndryshe të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë në një rast pothuajse identik, mund ta gjeni në Aktvendimin K.DH.Shk II.nr. 36/23, të datës 10.05.2023.

35. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1709/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 24.08.2023.

Gjykata ka vlerësuar se dorëzimi dhe pranimi i faturës është realizuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, për faktin se nga fletë-kthesa postare është konfirmuar se kreditori në adresë të debitorit ka dorëzuar faturën, paragonat, autorizimin, dhe kërkesën për pagesë, dhe nga kjo fletë-kthesë shihet qartë se debitori ka pranuar këto shkresa, në po të njëjtën datë.

Kreditori me datë 17.07.2020, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës së datës 25.12.2017. P

Përmbaruesi Privat sipas propozimit të kreditorit, me Urdhrit Përmbarimor P.nr. 135/2020 të datës 17.07.2020, ka lejuar përmbarimin me të cilën është detyruar debitori që kreditorit në emër të borxhit nga fatura, t'ia paguaj shumën përkatëse, me kamatë ligjore prej 8 % si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër Urdhrit Përmbarimor, debitori ka paraqitur prapësim duke deklaruar se obligimi nuk i përket debitorit, nuk ka asnjë element se është pranuar nga ai, që do të thotë se nuk ka vulë apo nënshkrim të personave të autorizuar brenda debitorit, si subjekt afarist.

Përgjigje në prapësimin e debitorit ka paraqitur kreditori, duke kundërshtuar në tërësi si të pabazuara pretendimet e debitorit, pasi që faturën ia ka dorëzuar debitorit përmes postës dhe të njëjtën debitori e ka pranuar me datën 06.07.2020, dhe përsëri nuk e ka përmbushur obligimin, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit, të lejohet përmbarimi sipas Urdhrit Përmbarimor.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktvendimin PPP.nr. 500/2020 e datës 04.02.2021, ka refuzuar si të bazuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 135/2020 të datës 17.05.2020. Në arsyetim të aktvendimit theksohet se Fatura i plotëson kushtet e parapara me ligj. Nga fletë kthesa e datës 06.07.2020, konfirmohet se kreditori në adresë të debitorit me datën 06.07.2020 ka dorëzuar faturën përkatëse dhe paragonat, autorizimin dhe kërkesën për pagesë, dhe nga e njëjta shihet se debitori e ka pranuar më të njëjtën datë.

Kundër këtij aktvendimi, debitori ka paraqitur ankesë, për shkak se obligimi nuk i përket firmës së debitorit, dhe se nuk ka asnjë provë se është pranuar nga debitori, që do të thotë se nuk ka vulë apo nënshkrim të personave të autorizuar të debitorit.

Në përgjigjen në ankesë, kreditori ka kundërshton pretendimet e debitorit, sipas tij, nuk është argumentuar se cilat dispozita ligjore janë shkelur, e as nuk është provuar ndonjë fakt relevant për t'i argumentuar pretendimet e tij.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.1709/22, të datës 24.08.2023, ka refuzuar të pabazuar ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 500/10 e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, të datës 04.02.2021.

Sikurse gjykata e shkallës së parë, edhe Dhoma e Shkallës së Dytë ka konstatuar se përmbartimi është lejuar në bazë të Faturës së datës 25.12.2017, të lëshuar nga kreditori, e cila është në origjinal, dhe të njëjtën e ka pranuar debitori përmes postës e cila dëshmohet përmes fletë-kthesës së datës 06.07.2020, e pranuar dhe nënshkruar nga debitori.

Kjo faturë ka cilësinë e dokumentit të besueshëm konform Nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së, dhe si e tillë paraqet bazë juridike për caktimin e përmbartimit, sepse i përmban elementet siç kërkohet me paragrafin 3 të këtij Neni, i cili thotë se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”* si dhe është në pajtim me Nenin 37 të LPP-së i cili thotë se *“kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit të bashkëngjitet dokumenti i tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Pretendimet e debitorit se fatura nuk i përket debitorit, gjykata ankimore e ka vlerësuar si të papranueshme dhe të pabazuar, sepse propozimi për përmbartim është bërë në bazë të faturës së cilës paraqet titull juridik për realizimin e kërkesës në të holla sipas Nenit 29 paragrafi 1 nënpar. 1.3 të LPP-së. Meqenëse në këtë faturë janë të përfshira të gjitha informatat e palëve kontraktuese, numri fiskal i debitorit, selia e punëdhënësit - debitorit, përshkrimi i punimeve apo shërbimeve, sasia e furnizimit, vlera totale me TVSH-në, dhe afati i pagesës nga data e faturimit, në këtë rast debitori në ankesë nuk ka kontestuar asnjë nga këto të dhëna të faturës, dhe nuk ka dhënë informacion nëse këto të dhëna të faturës ndryshojnë nga të dhënat tjera që ka debitori i regjistruar pranë organeve kompetente, për t'i vërtetuar pretendimet se adresa, numri fiskal, në faturë, nuk i përket debitorit.

36. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 993/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës
- Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 20.09.2023.

Vetëm dërgimi postar pa specifikuar përmbajtjen e shkresës që do pranohet debitori është shkelje e kushteve ligjore dhe e pranueshmërisë së detyrimit që përmbajnë faturat. Pranimi i dërgesave të tilla për të cilat nuk dihet përmbajtja e tyre – se çfarë shkresë konkrete është, për gjykatën nuk mund të konsiderohet si pranim i faturës, edhe nëse debitori ka vënë nënshkrimin mbi dëftesën përkatëse.

Kreditori, me datë 20.10.2021 ka paraqitur propozim për përmbarim për lejimin e përmbarimit kundër debitorit mbi bazën e faturës së datës 21.09.2021, në cilësi të dokumentit të besueshëm.

Përmbaruesi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit me datë 20.10.2021 ka caktuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 1000/21, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës së datës 21.09.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në emër të borxhit sipas faturës, kreditorit t'ia paguajë shumën përkatëse, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së propozimit për përmbarim si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij Urdhri, debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke kontestuar ligjshmërinë e Urdhrit dhe mënyrën e pranimit të tij.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë me Aktvendimin KPPP. nr. 777/22 të datës 25.05.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, dhe ka anuluar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 1000/2021, të datës 20.10.2021, të lejuar nga Përmbaruesi Privat, ashtu që e ka përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Në arsyetim të këtij aktvendimi, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se dokumenti – Fatura e datës 21.09.2021, në bazë të cilave është lejuar propozimi për përmbarim nuk plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin e pranuesit – debitorit, andaj, meqenëse debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, ndërsa nga dëftesa për pranimin e dërgesës e datës 22.09.2021, nuk mund të konstatohet si dorëzim i rregullt, ngase te lloji i dërgesës nuk ka shënim se cilat dokumente janë dorëzuar por figuron vetëm shkronja R, pra në dërgesën e nënshkruar nuk shkruan faturë.

Kundër këtij aktvendimi, kreditori në afatin ligjor ka ushtruar ankesë me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr. 777/22 të datës 25.05.2023, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit ashtu që të prishet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, dhe të refuzohet prapësimi i debitorit

Përgjigje në ankesa ka parashtruar debitori me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë ta refuzojë ankesën e kreditorit si të pabazuar, dhe ta vërtetojë aktvendimin e ankimuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr.993/23, të datës 20.09.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e kreditorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin KPPP.nr. 777/22 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Parë, të datës 25.05.2023.

Sipas vlerësimit të gjykatës ankimore, Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka vlerësuar kur ka konstatuar se fatura e lëshuar nga ana e kreditorit nuk është pranuar me rregull, ngase të njëjtat nuk janë të nënshkruara nga debitori – gjë që e bën faturën të papranueshme dhe si e tillë e njëjta nuk i përmbush kushtet e dokumentit të besueshëm.

Sipas interpretimit të ofruar nga Dhoma e Shkallës së Dytë, bazuar në kushtet e përcaktuara me dispozitën ligjore të Nenit 29 par. 3 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, fatura nuk mund të ketë fuqinë e dokumentit të besueshëm nëse mungon ndonjë nga kriteret që e bën atë të përshtatshme për përmbartim. Për shkak se debitori nuk e ka pranuar faturën me nënshkrimin e tij, nuk i jep faturës fuqinë e dokumentit të besueshëm dhe i njëjti, nuk mund të jetë i përshtatshëm për përmbartim.

Sipas qëndrimit juridik të Dhomës së Shkallës së Dytë, në procedurën përmbartimore që vie si rezultat i një raporti afarist, palët duhet t'i mbështesin pretendimet e tyre mbi dokumente të cilat janë të pranueshme për ndjekjen e procedurës në gjykatë.

Së këndejmi, fakti se njëra palë i ka dërguar disa fatura përmes dërgesës postare tek pala tjetër nuk nënkupton dërgim të rregullt, përderisa debitori nuk ka pasur njohuri konkrete se çfarë përmbajtje ka dërgesa e pranuar. Kjo mënyrë e të dorëzuarit të faturave, ndonëse pala i pranon fizikisht faturat në dërgesë, nuk nënkupton se ka pranuar detyrimin që bartin ato me vete. Pra, që faturat të kenë fuqinë e dokumentit të besueshëm do të duhej që të njëjtat të jenë të nënshkruara nga debitori.

Në të kundërtën, vetëm dërgimi i tillë postar pa u specifikuar se çfarë pranon debitori është devijim i kushteve ligjore dhe pranueshmërisë së detyrimit që përmbajnë faturat, dhe për gjykatën nuk paraqet pranim të faturës.

Lidhur me çështjen e dorëzimit të faturës, një vendosje të tillë të Dhomës së Dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, mund ta gjeni edhe në Aktvendimin K.DH.SH.II nr. 89/22, të datës 04.01.2023.

37. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1398/2022 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 28.09.2023.

Në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë provë përmes së cilës dëshmohet se debitori ka pranuar propozimin për përmbarrim dhe Urdhrin Përmbarrimor nga Përmbarruesi Privat, si pasojë, të njëjtit i është pamundësuar të informohet se ndaj tij është iniciuar procedura përmbarrimore. Kjo rrethanë më pas ka reflektuar edhe në ushtrimin e së drejtës ligjore për paraqitjen e mjetit juridik, gjegjësisht prapësimin.

Kreditori me datën 13.01.2020, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave të datave 31.08.2019, 02.09.2019, 04.09.2019, 06.09.2019, 07.09.2019, 12.09.2019, 14.09.2019, 23.09.2019, 14.10.2019, 20.11.2019, 06.12.2019, 07.12.2019, dhe 20.12.2019.

Përmbarruesi Privat, sipas propozimit për përmbarrim ka lejuar përmbarrimin, me të cilin ka obliguar debitorin që kreditorit ne emër të borxhit sipas faturave t'ia paguajë shumën përkatëse, me kamatë vonesë prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër Urdhrit Përmbarrimor, debitori ka paraqitur prapësim me arsyetimin se kreditori ka ushtruar propozim për përmbarrim me datën 13.01.2020 ndërsa përmbarrimi është lejuar me datën 13.01.2020, dhe është bërë i formës së prerë që nga data 29.01.2020. Debitori ka deklaruar se ketë propozimin për përmbarrim dhe urdhrin për lejimin e përmbarrimit asnjëherë nuk e ka pranuar në mënyrë që të mund t'i ofrohet mundësia për parashtrimin e prapësimin. Me datë 31.01.2020, debitori është njoftuar nga institucionet bankare se i janë bllokuar xhirrollogaritë sipas Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 05/2020. Ka shtuar se përmes përfaqësuesve të tij të autorizuar, ka tentuar të marrë informata nga Përmbarruesi Privat por i njëjta, përkundër premtimit se do të ofrojë informata për rastin, nuk ka bërë një gjë të tillë. Tutje, debitori ka shtuar se faturat në bazë të cilave është lejuar përmbarrimi nuk kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm, ndërsa ka treguar se ka ushtruar padi vërtetimi me datën 23.01.2020 për kompensim dëmi në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Debitori, krahas prapësimin ka ushtruar edhe kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme.

Përgjigje në prapësimin e debitorit, ka ushtruar kreditori duke arsyetuar se kërkesa dhe arsyetimi i debitorit janë të pabazuara, prapësimi i debitorit është i pasafatshëm, Urdhri Përmbarrimor është i ligjshëm. Sipas tij, debitori nuk ka dhënë asnjë provë që do të arsyetonte prapësimin e tij.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin PPP.nr. 146/20 e datës 12.05.2021, ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, ka anuluar Urdhrin Përmbarrimor P.nr.05/20 të datës 13.01.2020 të caktuar nga Përmbarruesi Privatë, që ka të bëjë me pagesën e borxhit në shumën përkatëse.

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata ka theksuar se pretendimet e debitorit janë të pranueshme dhe se faturat mbi bazën e të cilave është iniciuar procedura e përmbarrimit, janë në kundërshtim me Nenin 27, 29 par. 3, 38 par. 1 të LPP-së, sepse shikuar nga shkresat e lëndës Përmbarruesi Privat e ka dorëzuar Urdhrin Përmbarrimor në një tjetër adresë, dhe jo në adresën e saktë të debitorit.

Si rrjedhojë, në fletë-kthesë është konstatuar se debitori nuk gjendet në këtë adresë, andaj urdhri përmbarues është lejuar në shkëlqje të Nenit 110 dhe 111 të LPK-së dhe Nenit 17 të LPP-së, për atë se Urdhri Përmbarimor nuk i është dorëzuar debitorit në adresën e saktë të tij. Gjykata ka konstatuar se nuk është bërë dorëzimi i drejtpërdrejtë dhe as në mënyrë indirekte, andaj duke qenë se debitorit nuk i është dorëzuar Urdhri Përmbarimor në adresën e saktë, atëherë nuk mund të aplikohet dispozita e Nenit 114 të LPK.

Kundër këtij aktvendimi, kreditori në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, me propozim që gjykata e shkallës së dytë këtë ankesë ta aprovojë si të bazuar, aktvendimin ta ndryshojë dhe prapësimin e debitorit ta hedhë poshtë si i pasafatshëm.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 1398/2022, të datës 28.09.2023, ka refuzuar të pathemeltë ankesën e kreditorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 146/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 12.05.2021.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nga fletë-kthesat postare rezulton se debitorit nuk i janë dorëzuar propozimi për përmbarim, e as Urdhri Përmbarimor. Përkitazi me këtë çështje, Neni 47 par. 2 i LPP-së ka qartë theksuar se: *“Aktvendimi për përmbarimin apo urdhri për përmbarim i dërgohet kreditorit dhe debitorit apo përfaqësuesve të tyre”*, e po ashtu edhe Neni 110 par.1 i LPK-së, parasheh që: *“Padia, përgjigjja në padi, letërthirrja për në seancë, urdhërpagesa, aktgjykimi dhe aktvendimi, kundër të cilit lejohet ankimi i veçantë, mjeti i goditjes së vendimit, i dorëzohet personalisht palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit me prokurë të saj. Shkresat e tjera do t’i dorëzohen personalisht adresatit kur një gjë e këtillë shprehimisht parashihet me këtë ligj apo kur gjykata konkludon se për shkak të dokumenteve origjinale që i janë bashkangjitur shkresës që duhet 4 dorëzuar, ose nga ndonjë shkak tjetër, nevojitet kujdes i shtuar”*. Sipas gjykatës ankimore, për shkak se në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë provë se debitori ka pranuar propozimin për përmbarim dhe Urdhrin Përmbarimor nga Përmbaruesi Privat, të njëjtit i është pamundësuar të informohet se ndaj tij është iniciuar procedurë përmbarimore, e cila me pastaj ka reflektuar edhe në ushtrimin e së drejtës ligjore për paraqitjen e mjetit juridik, gjegjësisht prapësimin.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka gjetur gjithashtu se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi, nuk janë në përputhje me Nenin 29 par. 3 të LPP-së i cili parasheh qartë se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, si dhe Nenin 20 të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2010 për zbatimin e Ligjit 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, sepse të njëjtat janë të panënskruara dhe të pavulosura nga ana e debitorit.

38. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 905/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 02.10.2023.

Në raportet e ndërsjella afariste, mjafton që fatura të pranohet nga debitori. Edhe në rast të mungesës së nënshkrimit në faturë, pranimi i saj vetëm me vulën e subjektit nuk e zhvleftëson mënyrën e pranimit të saj.

Kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim kundër debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit ka nxjerrë Urdhrin Përmbarimor P.nr.583/21 të datës 20.09.2021, me të cilin e ka lejuar përmbarimin sipas faturave, duke e detyruar debitorin që ne emër të detyrimit nga këto fatura t'ia paguajë kreditorit shumën përkatëse me kamatë ligjore prej 8% nga data e lëshimit të faturës e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e përmbarimit .

Kundër Urdhrit Përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim, me pretendimin se dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbarimi nuk është dokument i besueshëm sipas LPP, nuk është i rregullt sepse nuk e ka nënshkrimin e debitorit.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori, me pretendimin se asnjë nga kushtet për anulimin e Urdhrit Përmbarimor nuk ekzistojnë pasi i njëjti është nxjerr konform LPP-së, pasi që faturat i plotësojnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas Nenit 29 par. 3 të LPP-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PPP.nr. 1273/21 e datës 25.02.2022, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 583/21 të datës 20.09.2021 të Përmbaruesit Privat dhe ka refuzuar si të pabazuar propozimin për përmbarim, ndërsa Urdhrin Përmbarimor të Përmbaruesit Privat e ka shfuqizuar.

Gjykata ka theksuar se Urdhri Përmbarimor është nxjerrë pa plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e tij sepse dokumentet e besueshme - faturat në bazë të cilave është kërkuar përmbushja e detyrimit nuk përbëjnë bazën juridike për përmbarim, sepse të njëjtat nuk janë të nënshkruara nga debitori dhe në shkresat e lëndës nuk kemi dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga i njëjti.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën si të bazuar ndërsa aktvendimin e ankimuar ta anulojë, dhe Urdhrin Përmbarimor ta vërtetojë.

Përgjigje ndaj ankesës së kreditorit ka ushtruar debitori me pretendimin se arsyet e dhëna nga kreditori në ankesë janë të pabazuara, andaj ka propozuar që gjykata ta refuzojë si të pabazuar ankesën e kreditorit, ta vërtetojë aktvendimin e shkallës së parë dhe ta obligojë kreditorin të paguajë shpenzimet e shkaktuara të procedurës.


Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.905/23, të datës 02.10.2023, ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit, ka prishur Aktvendimin PPP.nr. 1273/21 e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 25.02.2022, dhe ka kthyer çështjen në rigjykim dhe rivendosje pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Parë.

Dhoma e Shkallës së Dytë, nuk ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me mospranimin e faturave si të panënshkruara, për faktin se kjo e fundit nuk ka marrë në konsideratë faktin se debitori i ka vulosur këto fatura. Ndonëse faturat të cilat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarrim, nuk janë të nënshkruara, të njëjtat janë të vulosura me vulë të debitorit.

Sipas gjykatës ankimore, në raportet e ndërsjella afariste, mjafton që fatura të pranohet nga subjekti, pavarësisht faktit se nuk është vendosur nënshkrimi në faturë, pranimi i saj me vulë të subjektit nuk e zhvleftëson mënyrën e pranimit.

Në këtë rast, faturat paraqesin bazë për lejimin e përmbarrimit në kuptim të dispozitave ligjore të Nenit 29 të LPP-së, përderisa mënyra e pranimit bëhet në formë të dëshmisë zyrtare goftë me vulë apo nënshkrim, përderisa të mos provohet se një gjë e tillë është keqpërdorur nga ndonjë nga subjektet. Andaj, tani për tani, Dhomat e Shkallës së Dytë nuk kanë mundur të vijnë deri te një konkludim se faturat janë të papranuara apo se rregullsia e pranimit nga ana e debitorit nuk ka qenë e ligjshme.

Gjykata ankimore ka udhëzuar gjykatën e shkallës së parë që në riprocedurë të vlerësojë pretendimet e debitorit se në vështrim të cilave shkelje apo lëshime konsideron se vula si mënyrë e pranimit të dokumenteve nuk është e vlefshme, respektivisht të vlerësojë se a janë plotësuar kushtet për lejimin e përmbarrimit sipas dokumenteve të besueshme – faturave të cilat debitori i ka vulosur.



KAPITULLI VI GARANCONI FINANCIAR

39. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1420/2022 i Gjykatës Komerciale të Kosovës
- Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 02.11.2022.

Me rastin e ushtrimit të ankesës kundër vendimit përmes të cilit është refuzuar prapësimi i tij (debitorit), debitori duhet të paguajë garancinë në të holla në vlerën e caktuar nga gjykata, ose përndryshe ankesa e tij do të hedhet poshtë si e palejuar, dhe nuk do të shqyrtohen fare pretendimet ankimore të tij.

Kreditori, me datë 17.08.2020 ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm - Fatura së datës 08.09.2017 e pranuar dhe nënshkruar nga debitori.

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.303/20 të datës 24.08.2020 ka lejuar përmbarimin në bazë të Faturës së datës 08.09.2017, në shumën përkatëse.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin PPP.nr. 1185/2020 të datës 09.11.2020 ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr. 303/2020 të datës 24.08.2020 të lëshuar Përmbaruesi Private.

Ndërkohë, Gjykata Themelore në Prishtinë me datë 26.01.2021 ka nxjerrë Aktvendim PPP.nr. 1185/2020 përmes të cilit ka caktuar garancinë në të holla, si parakusht për ankesën e parashtruar kundër Aktvendimit PPP.nr. 1185/20 të datës 09.11.2020, dhe ka urdhëruar debitorin që të deponojë në llogari të veçantë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përmes arkës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, garancinë në të holla në afat prej tre (3) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Në këtë aktvendim është përcaktuar se nëse debitori nuk e deponon garancinë brenda afatit, do të konsiderohet se ankesa nuk është dorëzuar fare.

Kundër Aktvendimit PPP.nr.1185/2020 të datës 09.11.2020, debitori ka paraqitur ankesë për shkak se dokumenti i besueshëm në bazë të së cilit është nxjerrë urdhri për lejimin e përmbarimit nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, për faktin se malli i ofruar nuk ka pasur kualitetin e dakorduar, me propozimin që gjykata e shkallës së dytë këtë ankesë ta aprovojë si të bazuar, aktvendimin ta anulojë dhe çështjen ta kthejë në rivendosje. Debitori ka theksuar se me kohë ka paraqitur vërejtjet lidhur me mallin dhe brenda afateve të parapara në kuptim të dispozitave të LMD-së, me kërkesë që mallin me të meta kreditori ta zëvendësonte, por kreditori asnjëherë nuk e kishte bërë një gjë të tillë.

Përgjigje në ankesën e debitorit ka ushtruar kreditori, me pretendimin se debitori nuk e ka paguar garancinë në të holla si parakusht për parashtrimin e ankesës, e që parashihet me Nenin 78 të LPP-së.

Ndër të tjera, kreditori ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se dokumenti i besueshëm nuk ka tipare të përmbarueshmërisë sepse malli i ofruar nuk ka pasur kualitetin e dakorduar.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.1420/2022, të datës 02.11.2022, ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e debitorit të paraqitur kundër Aktvendimin PPP.nr. 1185/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 09.11.2020.

Deri te një vendosje e tillë ka ardhur për faktin se Dhoma e Shkallës së Dytë nuk ka gjetur ndonjë dëshmi se debitori ka deponuar garancinë në llogari të KGJK-së, siç ka urdhëruar Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PPP.nr.1185/20 të datës 26.01.2021. Tutje, gjykata ankimore nuk ka gjetur se debitori ka bërë kërkesë për lirim nga pagesa e garancisë nga shkaqet e cekura si në dispozitën e Nenit 78 paragrafi 2 i LPP-së. Andaj bazuar në Nenin 78 par. 4 të LPP ku përcaktohet qartë se *“nëse pala ankuese dështon të paguajë shumën e garancisë të caktuar nga Gjykata, ankesa konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese”*. Për shkak të një fakti të tillë, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se nuk mund të shqyrtohen pretendimet ankimore të debitorit, për arsye se ligjvënësi një rast të tillë e ka konsideruar sikurse nuk është paraqitur fare ankesa nga ana e debitorit.

40. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1432/2022 i Gjykatës Komerciale të Kosovës
- Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 15.11.2022.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e ushtruar nga kreditori kundër vendimit përmes të cilit është vendosur fati i prapësimit, për shkak se kreditori nuk ka paguar garancinë e caktuar nga ana e gjykatës për ushtrimin dhe shqyrtimin e ankesës.

Kreditore me datë 22.01.2021, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm - ekstraktit nga librat e kontabilitetit.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, me Urdhrin Përmbarimor P.nr. 130/21, të datës 25.01.2021, ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm - ekstraktit të verifikuar nga librat e kontabilitetit.

Përmes Aktvendimit PPP.nr. 272/2021, të datës 28.09.2021, Gjykata Themelore në Prishtinë ka aprovuar pjesërisht të bazuar prapësimin e debitorit, dhe ka shfuqizuar pjesërisht Urdhrin Përmbarimor P.nr. 130/20, të datës 25.01.2021, për shkak të parashkrimit të kërkesës për periudhën kohore 31.12.2013 deri më 31.12.2017, ndërsa pjesa tjetër e Urdhrit Përmbarimor, është lënë në fuqi. Po ashtu, kjo gjykatë ka caktuar garancinë në të holla, si parakusht për parashtrimin e ankesës kundër aktvendimit PPP.nr. 272/2021 të datës 28.09.2021, dhe ka paralajmëruar se në qoftë se pala ankuese dështon që ta paguajë shumën e garancisë brenda afatit, do të konsiderohet se ankesa nuk është dorëzuar fare kundër këtij aktvendimi. Kjo gjykatë arsyeton se Neni 78 par. 4 i LPP-së përcakton se nëse garancinë nuk paguhet, atëherë konsiderohet se nuk është dorëzuar fare ankesa nga pala ankuese, në këtë rast debitori.

Kundër Aktvendimit PPP.nr.272/21 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 28.09.2021, kreditore ka paraqitur ankesë, me propozim që gjykata e shkallës së dytë këtë ankesë ta aprovojë si të bazuar, ose ta ndryshojë aktvendimin e kundërshtuar. Pretendimet ankimore të kreditorit konsistojnë në faktin se Gjykata nuk ka trajtuar fare pretendimet e kreditorit se ka ndërprerje të parashkrimit sipas Neni 368 të LMD-së. Gjykata nuk ka marrë parasysh faktin se debitori në vazhdimësi ka bërë pagesa ndaj kreditorit, dhe nuk është fjala për një pagesë, por për dhjetëra pagesa në shuma të ndryshme të njëpasnjëshme nga viti 2013 e deri 2021. Gjykata gabimisht ka interpretuar parashkrimin sepse debitori deri me 31.05.2018 borxhin e ka pasur të ri programuar me këste dhe atë në vlerë prej 7.41€, pra nuk qëndron konstatimi i gjykatës së është parashkruar borxhi, nuk është i besueshëm kur ka arsyetuar sepse debitori me dt.25.01.2021 ka parashtruar propozim ndërsa debitori deri me 31.05.2018 e ka pasur borxhin të riprogramuar sipas kontratës.

Përmes Aktvendimit të datës 15.11.20223, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër Aktvendimit PPP.nr. 272/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 28.09.2021.

Dhoma e Shkallës së Dytë, ka vendosur si në dispozitivin e tillë për faktin se në shkresat e lëndës nuk ka gjetur dëshmi se kreditori ka deponuar garancinë financiar në llogari të KGJK-së, siç urdhëron Gjykata Themelore në Prishtinë me

Aktvendimin PPP.nr.272/21, të datës 28.09.2021, apo se ka bërë kërkesë për lirim nga pagesa e garancisë nga shkaqet e cekura si në dispozitën e Nenit 78 paragrafi 2 i LPP-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë, ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë, me të drejtë ka obliguar palët ankuese të paguajnë garancinë bankar si parakusht për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesës, duke i'u referuar dispozitës ligjore nga Neni 78 paragrafi 1 të LPP-së, që parasheh se: *“Gjykata e shkallës së parë, ne rastet kur debitori dëshiron të parashtojë ankesë kundër vendimit me të cilin është refuzuar prapësimi i tij në lidhje me propozimin për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm, urdhëron palën ankuese që të paguajë garancinë në të holla, si parakusht për parashtrimin e ankesës, përveç nëse pagesa e garancisë i shkakton dëm të pariparueshëm palës ankuese dhe nëse dëmi është i ndryshëm ose nuk është i lidhur me humbjen që do të shkaktohej me rastin e pagesës së kredisë”*.

Andaj bazuar në Nenin 78 par.4 te LPP ku përcaktohet se *“Nëse pala ankuese dështon të paguajë shumën e garancisë të caktuar nga Gjykata, ankesa konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese”*.

Për shkak të një situatë të tillë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, nuk ka shqyrtuar fare pretendimet ankimore të kreditorit, të paraqitura në ankesën e ushtruar.

41. Aktvendimi K.DH.Shk II.nr. 1402/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës
- Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 04.04.2023.

Garancia për ushtrimin e ankesës kundër vendimit përmes të cilit është vendosur lidhur me prapësimin, duhet deponuar vetëm nëse propozimi për përmbarrim është iniciuar sipas dokumentit të besueshëm, dhe jo nëse është iniciuar sipas dokumentit përmbarrues.

Kreditori, me datë 20.02.2020, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbarrues - Aktgjykimit EK.nr. 559/2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 17.07.2018, të ekzekutueshëm nga data 10.12.2019.

Përmbarruesi Privat ka lejuar përmbarrimin me Urdhër P.nr. 41/20 e datës 21.02.2020 ndërsa kundër këtij urdhri debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin ka kërkuar që të aprovohet prapësimi dhe të refuzohet propozimi për përmbarrim.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim përmes së cilës ka kërkuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PPP.nr. 362/2020 e datës 07.12.2020, ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbarrim P.nr. 041/20, të datës 21.02.2020, të Përmbarruesit Privat. Në Pikën II të dispozitivit, Gjykata ka urdhëruar palën ankuese që konform Nenit 78 par. 1 të LPP-së, paraprakisht të deponojë garancinë në të holla në shumën përkatëse si parakusht për ushtrimin e ankesës, në të kundërtën gjykata konform Nenit 78 par. 4 të LPP-së, do të konsiderojë se ankesa nuk është dorëzuar fare.

Në arsyetim të vendimit, gjykata ka theksuar se përmbarrimi i lejuar nga Përmbarruesi Privat bazohet në titullin ekzekutiv – Aktgjykimin Ek.nr. 559/2018 e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 17.07.2019, i plotfuqishëm që nga data 08.11.2019, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 10.12.2019, andaj, i njëjti është dokument përmbarrues sepse plotëson kushtet ligjore nga Neni 24 dhe 27 i LPP-së, për të qenë i përmbarrueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarrim.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, me propozim drejtuar Gjykatës së Shkallës së Dytë që të aprovohet ankesa dhe të refuzohet si i pa bazuar propozimi për përmbarrim i kreditorit. Sa i përket Pikës II të dispozitivit të aktvendimit ku gjykata e ka detyruar palën ankuese të deponojë garancinë në rast se parashtron ankesë ndaj vendimit të gjykatës, debitori ka theksuar se është në kundërshtim me Nenin 78.1 të LPP-së pasi që vendimi i Gjykatës nuk është dokument i besueshëm, por dokument përmbarrues.

Kreditori ka ushtruar përgjigje në ankesë duke theksuar se Aktvendimi PPP.nr. 362/2020 është dhënë në bazë të dokumentit të përmbarrueshëm dhe të formës së prerë, ndërsa ka shtuar se debitori nuk ka dëshmuar se ka paguar garancionin ndaj vendimit të gjykatës dhe nuk ka dëshmuar se ka bërë kërkesë ndaj vendimit të gjykatës që të përjashtohet nga pagesa e garancionit.

Gjykata Komerçiale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.Shk II.nr. 1402/22, të datës 04.04.2023, ka refuzuar të pathemeltë ankesën e debitorit dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 362/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 07.12.2020.

Gjykata e shkallës së dytë ka shqyrtuar pretendimet ankimore të debitorit lidhur me çështjen e deponimit të mjeteve në emër të garancionit, të cilat i ka konsideruar pretendime të arsyeshme dhe të bazuara, pasi që garancioni duhet deponuar vetëm nëse propozimi për përmbarim është iniciuar sipas dokumentit të besueshëm, ndërsa në rastin konkret propozimi për përmbarim është iniciuar në bazë të dokumentit përmbarues - Aktgjykimit Ek.nr. 559/2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 17.07.2019.

42. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 402/2022 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 26.04.2023.

Debitori në cilësinë e palës ankuese nuk ka paguar shumën e garancisë të caktuar nga gjykata për ushtrimin e ankesës, prandaj Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë ka hedhur ankesën e debitorit si të palejuar, dhe nuk ka shqyrtuar fare pretendimet e vendosura në të.

Kreditori me datën 03.02.2015 ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturave si në propozimin për përmbarim.

Përmbaruesja Private, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, me Urdhriin Përmbarimor P.nr.13/2015, të datës 03.02.2015, ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave.

Kundër këtij urdhri me datën 23.04.2015, debitori ka ushtruar prapësim, duke theksuar se faturat në bazë të së cilave është marr Urdhri Përmbarimor janë jo reale, pavarësisht faktit se kreditori dhe debitori kanë pasur bashkëpunim dhe kanë mbetur në pozicione të hapura dhe të pa shlyera që nuk janë shlyer nga kreditori, përkundër faktit se debitori ka përmbushur në tërësi obligimet e tij ndaj kreditorit.

Përgjigje në prapësimin e debitorit ka ushtruar kreditori, duke e kundërshtuar në tërësi prapësimin e paraqitur nga debitori. Kreditori ka theksuar se në përgjigjen në prapësim ka bashkëngjitur dokument përmes të cilit evidentohet gjendja financiare dhe faturat e përmendura nga ana e debitorit. Prandaj kreditori ka konsideruar se prapësimi i paraqitur nga ana e debitorit është i pabazuar sepse nuk ka ndonjë dëshmi se debitori ka përmbushur borxhin e kërkuar nga kreditori.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin PPP.nr.757/2015, të datës 25.07.2017 ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr. 13/2015 të datës 03.02.2015, të lejuar nga Përmbaruesi Privat. Sipas kësaj gjykate, prapësimi i debitorit nuk rezultoi të jetë i mbështetur në prova siç kërkohet me Nenin 69 dhe 73 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Kundër Aktvendimit PPP.nr.757/2015, të datës 25.07.2017, debitori ka paraqitur ankesë, me propozimin që të aprovohet ankesa e tij si e si e bazuar, të ndryshohet Aktvendimi PPP.nr. 757/15 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i datës 25.07.2017 në atë mënyrë që të pranohet prapësimi i debitorit, dhe të shfuqizohet Urdhri për lejimin e përmbarimit i lëshuar nga Përmbaruesi Privat.

Ndërkohë, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PPP.nr. 757/2015 të datës 23.10.2019, ka caktuar garancinë në të holla në lartësi të kërkesës si parakusht për parashtrimin e ankesës kundër Aktvendimit PPP.nr. 757/2015 të datës 25.07.2017.

Tutje, gjykata ka urdhëruar debitorin si parakusht për shqyrtimin e ankesës së parashtruar, të deponojë në llogari të veçantë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës garancinë, në afat prej tre (3) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit dhe nëse debitori i përmbarimit nuk e deponon garancinë brenda afatit, do të konsiderohet se ankesa nuk është dorëzuar fare.

Gjykata Komerçiale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.402/2022, të datës 26.04.2023, ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e debitorit të paraqitur kundër Aktvendimit PPP.nr. 757/2015 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 25.07.2017.

Sipas arsytimit të ofruar nga gjykata ankimore, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se nuk ka ndonjë provë se debitori ka bërë pagesën e shumës së garancisë siç urdhëron Gjykata Themelore në Prishtinë me Vendimin PPP.nr.757/15 të datës 23.10.2019 konform dispozitave ligjore. Po ashtu është konkluduar se debitori nuk ka ofruar ndonjë provë që i njëjti ka ushtruar kërkesë ose ka ofruar ndonjë dëshmi për lirim nga pagesa e garancisë.

Andaj, bazuar në Nenin 78 par. 4 të LPP-së në të cilin përcaktohet se *“Nëse pala ankuese dështon të paguaj shumën e garancisë të caktuar nga Gjykata, ankesa konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese”*, Gjykata Komerçiale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë ka vlerësuar se ankesa e debitorit konsiderohet e palejuar, prandaj ka vendosur që të njëjtën ta hedhë poshtë si të tillë.

43. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 489/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 24.08.2023.

Pala ankuese ka dështuar të paguajë shumën e garancisë të caktuar nga Gjykata, dhe mbi këtë fakt, ankesa është hedhur poshtë si e palejueshme, e njëjta konsiderohet se nuk është ushtruar fare. Gjykata nuk ka pranuar që garancia në të holla, të zëvendësohet me sende të tjera.

Kreditori, me datë 12.10.2021 ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave të datave 21.01.2020, 10.06.2021, 10.06.2021, 03.08.2021, 12.08.2021, 19.08.2021, 19.08.2021, 19.08.2021, dhe .10.08.2021.

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, me Urdhrin Përmbarimor P.nr. 316/2021 të datës 12.10.2021 ka lejuar përmbarimin në bazë të faturave si dokument të besueshëm, përmes se cilit ka obliguar debitorin që kreditorit në emër të borxhit sipas faturave t'ia paguajë shumën përkatëse, dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër këtij urdhri, debitori ka ushtruar prapësim me pretendimin se debitori ka përbushur obligimin ndaj kreditorit, në bazë të fletë-transferëve bankare dhe të paguara në kesh, prandaj propozimi i kreditorit është i pabazuar, i ka propozuar gjykatës që të miratohet prapësimi i debitorit si i bazuar, ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr. 316/2021 i datës dt.12.10.2021 të anulohet, dhe refuzohet propozimi për përmbarim i kreditorit.

Kreditori në përgjigje në prapësimin e debitorit ka deklaruar se debitori ka paraqitur disa transaksione bankare që nuk kanë lidhshmëri mes vete dhe nuk dëshmojnë që kemi të bëjmë me pagesën e faturave të cilat janë objekt i propozimit për përmbarim.

Gjykata Themelore në Ferizaj, pas mbajtjes së seancës gjyqësore me datë 17.05.2022, me Aktvendimin PPP.nr. 326/21, e datës 03.11.2022, ka hedhur poshtë si të palejueshme ankesën e ushtruar nga debitori të ushtruar kundër Aktvendimit PPP.nr. 326/21, të datës 03.06.2022.

Kundër këtij aktvendimi, debitori ka ushtruar ankesë me propozimin që ankesa e tij të miratohet si e bazuar, dhe që aktvendimi ankimor të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim pranë gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu, me datën 15.06.2022, debitori në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur Kërkesë për lirim nga pagesa e Garancisë.

Gjykata Themelore në Ferizaj, duke vendosur sipas kërkesës së debitorit për lirim nga pagesa e garancinë për ushtrimin e ankesës, me datë 21.06.2022, ka marrë Konkluzion me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e debitorit për lirim nga pagesa e garancinë, dhe ka detyruar debitorin që ta paguajë garancinë për ushtrimin e ankesës kundër Aktvendimit PPP.nr. 326/21 të 03.06.2022, në afatin prej 7 ditëve, në të kundërtën do të konsiderohet se ankesa nuk është ushtruar fare.

Debitori përmes parashtrësës së datës 27.06.2022, ka kërkuar nga gjykata e shkallës së parë, që shumën e garancisë ta zëvendësojë me automjete (kamion) me të dhënat e përshkruara në këtë Kërkesë.

Gjykata Themelore në Ferizaj duke vendosur sipas kërkesës së debitorit për zëvendësimin e garancisë, për lirim nga pagesa e garancisë, ka marrë Konkluzionin PPP.nr. 326/21 të datës 28.06.2022, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e debitorit, me të cilën ka kërkuar që të zëvendësohet shumën e garancisë me automjete, dhe të mundësohet përcjellja e ankesës për në gjykatën e Apelit, si ka detyruar debitorin ta paguajë garancinë për ushtrimin e ankesës, brenda afatit prej shtatë ditëve.

Me datën 15.09.2022 debitori sërish ka ushtruar ankesë në gjykatën e shkallës së parë, kundër Aktvendimit PPP.nr. 326/21 të datës 03.06.2022, dhe gjykata me Aktvendimin e atakuar PPP.nr. 326/21 të datës 02.11.2022, ka hedhur poshtë si të palejueshme ankesën e ushtruar nga debitori.

Në arsyetim të vendimit, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se debitori sipas Konkluzionit të datës 28.06.2022 nuk ka deponuar shumën e borxhit në afat prej 7 ditësh, dhe është konsideruar se ankesa është e palejueshme, duke iu referuar dispozitës së Nenit 78 par. 4 të LPP-së.

Kundër këtij aktvendimi, debitori ka ushtruar ankesë me propozimin që ankesa e tij të miratohet si e bazuar, dhe që aktvendimi ankimor të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim pranë gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 489/23, të datës 24.08.2023, ka refuzuar të pathemeltë ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 326/21 e Gjykatës Themelore në Ferizaj, të datës 03.11.2022.

Sipas gjykatës ankimore, në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore nga Neni 78 par. 4 të LPP-së, për hedhjen poshtë të ankesës, për shkak se debitori në cilësinë e palës ankuese, nuk ka paguar shumën e garancisë në të holla, përkundër faktit se me konkluzionin e datës 28.06.2022, debitori në cilësinë e palës ankese, është paralajmëruar që paraprakisht të paguajë garancinë në të holla në shumën e borxhit, si parakusht për parashtrimin e ankesës, ose në të kundërtën gjykata do të konsiderojë se ankesa nuk është dozuar fare.



KAPITULLI VII
CAKTIMI I RADHËS SË DEBITORËVE

44. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 772/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 17.05.2023.

Në rastet kur procedura përmbartimore është iniciuar në bazë të dokumentit përmbartimor - Kontratës për Dorëzimin, Gjykata duhet të marrë parasysh faktin nëse kreditori ka kërkuar përmbartjen e detyrimit nga debitorët kryesorë, në mënyrë që paraprakisht të shterojë mjetet juridike dhe ligjore për të kërkuar detyrimin ndaj debitorët tjerë jo kryesorë - garantuesve.

Kreditori me datë 09.07.2019, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorëve, në bazë të dokumentit përmbartues: Marrëveshjes se Limitit Kreditor për Sistemin e Debitimit Direkt, Marrëveshjes mbi Pengu, Listës së pengut, Marrëveshjes mbi Mbitërheqjen e Mundësuar, dhe Konfirmimin e regjistrimit të pengut, lëshuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë - Zyra për Regjistrim të Pengut.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit me Urdhrin Përmbartimor P.nr. 2148/19 të datës 10.05.2019, ka lejuar përmbartimin për shumën e detyrimit të debitorit ndaj kreditorit që rrjedh nga marrëveshjet e sipër cekura.

Kundër këtij urdhri, debitorët kanë ushtuar prapësim, me pretendimin se dokumentet në bazë të cilave është mbështetur Urdhri Përmbartimor nuk e kanë titullin ekzekutues ose nuk kanë tipare të ekzekutueshmërisë. Debitorja (garantuesja) ka pretenduar se kreditori është dashur se pari ta kërkojë borxhin nga debitorët e parë, të dytë dhe të tretë, e në fund në rast të dështimit të pagesës së borxhit nga tre debitorët, të drejtohet tek unë si garantuese në këtë marrëdhënie juridike. Andaj edhe ka propozuar që gjykata të anulohet si të pabazuar Urdhrin Përmbartimor, dhe debitorët t'i lirojë nga pagesa e borxhit, si dhe ta detyrojë kreditorin t'i paguajë shpenzimet e kësaj procedure.

Me datën 23.07.2019 dhe 25.07.2019 përgjigje në prapësimet e debitorëve ka paraqitur kreditori, me pretendimin se banka i ka provuar të gjitha mundësitë që me mirëkuptim të paguhet obligimi, por ne qoftë se nuk ka vullnet të debitorëve, atëherë mënyra e vetme për ta kthyer obligimin është procedura gjyqësore, në këtë rast nuk kemi prioritet në përmbartje, por kreditori kudo që gjen mjete për të kthyer obligimin e tij, mund ta bëjë nga cilido debitor. Debitorëve iu ka dhënë disa atëherë mundësi për të paguar detyrimet por kjo mundësi ka rezultuar e pasuksesshme.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë, me Aktvendimin PPP.nr. 269/2019 të datës 03.09.2019, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorëve të paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 2148/19, të datës 10.05.2019 të Përmbartuesit Privat.

Kjo gjykatë ka gjetur se debitorët në prapësimet e tyre nuk janë thirrur në dispozita të Nenit 71 të LPP-së ku janë të përshkruara shkaqet e prapësimit, ashtu që prapësimet nuk plotësojnë asnjë nga shkaqet e parapara me këtë nen.

Marrëveshjet mbi të cilat është bazuar propozimi për përmbartim paraqesin titull ekzekutiv dhe se kontrata mbi pengun është e paraparë me bazë të Nenit 22 par. 1, 1.7 a) të LPP-së dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kanë ushtruar ankesë debitorët, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë këtë ankesë, dhe aktvendimin e ankimuar ta anulojë ashtu që çështja të kthehet në shkallë të parë në rivendosje.

Përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.772/22, të datës 17.05.2023, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë ka aprovuar të themeltë ankesën e debitorëve, dhe ka anuluar Aktvendimin PPP.nr. 369/2019 e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, të datës 03.09.2019.

Kjo gjykatë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e ka gjetur të parregullt dhe jo të ligjshëm, dhe ka konstatuar se vendimi i atakuar është marrë në shkelje thelbësore të dispozitave të Nenit 182 par. 1 të LPK-së, dhe Nenit 38 par. 1 të LPP-së.

Gjykata ankimore ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka analizuar saktë dhe drejtë gjendjen e fakteve me rastin e vlerësimit se prapësimet e debitorëve janë të pabazuara, sepse gjykata e shkallës së parë me asnjë provë nuk ka argumentuar se nga cilat fakte është bindur për një vendim të tillë. Kjo sepse bazuar në shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së dytë nuk ka hasur në ndonjë provë që dëshmon se kreditori ka tentuar që përmbushjen e detyrimit ta kërkojë fillimisht nga debitorët kryesor, e që më pastaj të krijoheshin kushtet që arkëtimin e kredisë ta kërkojë nga debitorët tjerë - garantuesit.

Kjo gjykatë ka vlerësuar Nenin 1009 të LMD-së i cili parasheh që *“Me kontratën mbi dorëzanimë, obligohet dorëzani ndaj kreditorit se do ta përmbushë detyrimin e plotfuqishëm të debitorit të rrjedhur për pagesë, në qoftë se ky nuk e bën këtë”*, pastaj Neni 1016 par. 1 i LMD i cili parasheh *“Prej dorëzimit mund të kërkojë përmbushja e detyrimit vetëm pasi debitori kryesor të mos e përmbush brenda afatit të caktuar në thirrjen e drejtuar me shkrim (dorëzania subsidiare)”*, e që nga shkresat e lëndës nuk rezulton se kreditori e ka shterur këtë fakt ligjor.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka udhëzuar gjykatën e shkallës së parë që të konstatojë nëse kreditori ka kërkuar përmbushjen e detyrimit nga debitorët kryesorë, në mënyrë që të shterojë mjetet juridike dhe ligjore për të kërkuar detyrimin ndaj garantuesve, dhe të caktojë seancë dëgjimore në të cilën palët do të deklarohen rreth pretendimeve të tyre.

45. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 366/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës, - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 01.06.2023.

Nuk kemi të bëjmë me parashkrim pasi që propozimi për përmbarim në bazë të Aktvendimit të formës së prerë të marrë me datë 24.01.2021, dhe të ekzekutueshëm që nga data 08.02.2021, është paraqitur brenda afatit prej dhjetë (10) viteve, ndërkaq Urdhri Përmbarimor është lëshuar me datën 21.07.2021.

Kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të vendimit të kreditorit, të datës 14.12.2020, i formës së prerë me datë. 24.01.2021 dhe i ekzekutueshëm nga të datës 08.02.2021 për mos pagesë të rentës, me të cilin debitori është obliguar që në emër të rentës minerare t'ia paguajë vlerën përkatëse.

Përmbaruesi Privat, sipas propozimit të kreditorit me Urdhrit Përmbarimor P.nr. 206/21 të datës 21.07.2021, ka lejuar përmbarimin duke vlerësuar se vendimi i kreditorit, i datës 14.12.2020, i formës së prerë me datë 24.01.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 08.02.2021 për mos pagesë të rentës, i plotëson kushtet si vendim përmbarues i dhënë në procedurë administrative.

Kundër Urdhrit Përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim duke theksuar se dokumenti në bazë të cilit kërkohet përmbarimi nga ana e kreditorit, nuk është dokument i besueshëm pasi që aktvendimi mbi mos pagimin e rentës është i datës 13.07.2021, ndërsa licenca ka qenë me Nr. 1046/KPMM/2021, ndërsa firma nuk është aktive nga viti 2013 muaji i 12 që do të thotë se kërkesa është parashkruar.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Parë, me Aktvendimin KPPP. nr.1474/22, të datës 20.10.2022, ka vendosur që të aprovojë pjesërisht prapësimin e debitorit, dhe ka anuluar pjesërisht Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr. 206/21 të datës 21.07.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat, dhe atë për pjesën e interesit mujor për 2%, ndërsa për pjesën tjetër ka vendosur që të mbetet në fuqi pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr. 206/21 të datës 21.07.2021, për pjesën e detyrimit kryesor, dhe në fund ka vendosur që të përfundojë pjesërisht procedurën përmbarimore të kreditorit, sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr.206/21 të datës 21.07.2021 për pjesën e interesit mujor për 2% në emër të interesit mujor.

Gjykata ka theksuar se përmbarimi është lejuar në bazë të dokumentit përmbarimor - aktvendimit të kreditorit, të datës 14.12.2020, të formës së prerë me datë 24.01.2021 dhe të ekzekutueshëm nga data 08.02.2021 për mos pagesë të rentës, i cili i plotëson kushtet si dokument përmbarimor konform dispozitave nga Neni 22 par 1 nën par 1.2 të LPP -së. Ndërsa sa i përket obligimit të debitorit për pagesën e kamatës së përcaktuar në Urdhrit Përmbarimor, gjykata ka gjetur se debitori është i obliguar të paguajë borxhin në emër të rentës minerare shumë përkatëse, por jo edhe kamatën mujore prej 2%.

Kundër këtij aktvendimi, debitori ka parashtruar ankesë, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta pranojë ankesën si të bazuar, dhe të marrë një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur kreditori, i cili ka propozuar që të refuzohet ankesa e debitorit dhe të vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale- Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1474/22, i datës 20.10.2022.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.366/23, të datës 01.06.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin KPPP.nr. 1474/22 e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Parë, të datës 20.10.2022.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se aktvendimi i lëshuar nga kreditori për mos pagesë të rentës, në rastin konkret është dokument përmbarues, duke plotësuar të gjitha kushtet nga Neni 21, 22, 24, dhe 36 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore, se ky dokument është ka cilësinë e titullit ekzekutiv dhe se është i përmbarueshëm.

Lidhur me çështjen e parashkrimit, gjykata ankimore ka vlerësuar në këtë çështje nuk kemi të bëjmë me parashkrim pasi kjo çështje është përcaktuar qartë me Neni 361 par. 1 të LMD-së, nga çka rezulton se propozimi për përmbarim është paraqitur brenda afatit prej dhjetë (10) viteve, pasi që Urdhri Përmbarimor është lëshuar me datën 21.07.2021 ndërsa aktvendimi ka marrë formën e prerë me datë 24.01.2021, dhe është bërë i ekzekutueshëm me datën 08.02.2021.



KAPITULLI VIII
KUSHTET LIGJORE PËR PËRSHTATSHMËRINË E FATURAVE

46. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 328/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 27.10.2022.

Në rast se afati për përmbushje të borxhit është përcaktuar me dispozitat kontraktuale në mes të palëve, debitori nuk mund të godasë Urdhrin për lejimin e Përmbarimit me pretendimin se në faturë nuk është caktuar afati për pagesën e borxheve që rrjedhin nga kontrata e lidhur në mes të palëve.

Kreditori, me datën 24.10.2019 ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës së datës 13.08.2019 në shumën përkatëse që rrjedhë si produkt i raportit kontraktual ekzistues në mes të palëve, si dhe ka kërkuar t'i paguhen shpenzimet e procedurës përmbarimore, taksat dhe shpenzimet e tjera të përmbaruesit.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me Urdhrin Përmbarimor P.nr.789/2019 të datës 24.10.2019, ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datë 04.11.2019, ka ushtruar prapësim duke propozuar që të pranohet i njëjti, dhe të anulohet urdhri për përmbarim.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori me datë 05.11.2019, duke pretenduar që prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe i pa argumentuar, si dhe ka propozuar që të mbetet në fuqi Urdhri i Përmbaruesit Privat për caktimin e përmbarimit P.nr. 789/2019 i datës 24.10.2019.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktvendimin PPP.nr.1008/19, e datës 09.01.2020, ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbarimit të paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor të Përmbaruesit Privat P.nr. 789/2019 i datës 24.10.2019.

Një vendosje e tillë e gjykatës ka ardhur për faktin se prapësimi i ushtruar nuk përmbushë asnjë nga kushtet ligjor e parapara me Nenin 71, ngase fatura mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarimi është dokument i besueshëm - titull ekzekutiv, konform Nenit 29 paragrafit 1, nënpar. 1.2 dhe 1.3 të LPP-së.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor debitori ka ushtruar ankesë duke pretenduar se nuk ka arritur ende afati për pagesë e që sipas Ligjit për Prokurimin Publik, afati për pagesë është 30 ditë, me propozimin që të aprovohet ankesa dhe të anulohet në tërësi Aktvendimi PPP.nr. 1009/2019 të datës 09.01.2020, i Gjykatës Themelore në Mitrovicë. Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar kreditori.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr. 328/22, të datës 27.10.2022, ka refuzuar të pathemeltë ankesën, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 1008/19 e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, të 09.01.2020.

Lidhur me pretendimin e debitorit se ende nuk ka arritur afati për pagesë, gjykata ankimore e ka gjetur si të pabazuar, për faktin se duke u bazuar në Kontratën e lidhur në mes të palëve, atë të datës 03.07.2019, në pjesën e parimeve të përgjithshme në Nenin 20 par. 3, është përcaktuar qartë se:

“Shumat duhet të paguhen jo më shumë së 30 ditësh kalendarik nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës, ku data e pagesës do të jete data në të cilën debitohet llogaria e institucionit dhe së kërkesa për pagese nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore”.

Sipas Dhomës së Shkallës së Dytë, në rastin konkret, debitorit me datën 15.08.2019 i është dorëzuar fatura për pagesën e borxhit, ku maksimumi i afatit për pagesë bazuar në kontratë ka qenë përcaktuar të jetë 30 ditë, ndërsa nga data e pranimit të faturës ka kaluar afati brenda të cilit debitori është dashur që të përmbushë obligimin e tij.

47. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1282/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 15.11.2022.

Kur nga dokumenti i besueshëm nuk shihet se a është bërë e kërkueshme kredia, atëherë përmbarimi caktohet vetëm në qoftë se kreditori paraqet deklaratë me shkrim se kredia e tij është bërë e kërkueshme.

Kreditore, më datë 08.06.2018 ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturave të datave 11.08.2016, 15.08.2016, 02.09.2016, 08.09.2016, dhe atë të datës 13.09.2016.

Përmbaruesja Private, sipas propozimit të kreditorit me Urdhrin Përmbarimor P.nr. 392/18 të datës 08.06.2018, ka lejuar përmbarimin me të cilën është detyruar debitori që kreditorit në emër të borxhit për furnizim me produkte, t'i paguajë vlerën përkatëse, me kamatë ligjore prej 8 % deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër Urdhrit Përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 19.06.2018, me pretendimin se organi përmbarues me dashje apo nga pakujdesia ka injoruar në tërësi dispozitat ligjore nga Neni 29 par. 3 i LPP-së sepse në rastin konkret dokumentet e besueshme nuk janë të përshtatshme për përmbarim sepse nuk kanë përmbushur kushtin ligjor, përkatësisht nuk e kanë të shënuar afatin e pagesës. Në dokumentet e besueshme nuk shihet kërkueshmëria e kredisë siç përcaktohet me dispozitat ligjore, andaj ka propozuar që gjykata ta aprovojë prapësimin dhe ta anulojë Urdhrin Përmbarimor.

Përgjigje në prapësimin e debitorit ka paraqitur kreditore me datën 25.06.2018, me arsyetimin se pretendimet e debitorit nuk i referohen kërkesave të Nenit 71 të LPP-së, si shkaqe për paraqitjen e prapësimin. Kreditore ka shtuar se faturat janë të përshtatshme për përmbarim konform Neni 29 të LPP-së. Sa i përket kohës së përmbushjes së detyrimit, kreditore ka deklaruar se nëse nuk ka arritur koha e përmbushjes, atëherë si ka mundësi që debitori të ketë paguar disa nga pagesat, të cilat edhe i janë bashkangjitur prapësimin të tij. Po ashtu, kreditore ka deklaruar se me rastin e inicimit të procedurës përmbarimore ka paraqitur edhe deklaratën e arritshmërisë së kërkesës. Për këto shkaqe, i ka propozuar gjykatës të refuzojë si të pathemeltë prapësimin e debitorit, dhe të lë në fuqi Urdhrin.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin PPP.nr.760/18 të datës 13.03.2019, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr. 392/18 të datës 08.06.2018.

Sa i përket pretendimit të debitorit se në dokumentet e besueshme nuk shihet kërkueshmëria e kredisë, saktësisht faturat si të tilla kanë mungesë të elementit - afatit për përmbushje vullnetare, ky pretendim është gjetur si i paqëndrueshëm nga ana e gjykatës.

Sepse kreditore përmes deklaratës së bërë me datën 04.06.2018, ka deklaruar se borxhi sipas dokumenteve të besueshme - faturave tatimore, është bërë i kërkueshëm në ditën e lëshimit të secilës faturë, dhe për secilën faturë. Pra, përmes kësaj deklarate është konstatuar kërkueshmëria e kërkesave të kreditorit.

Kundër këtij aktvendimi, debitori në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, me propozimin që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë këtë ankesë, aktvendimin e ankimuar ta anulojë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje në shkallë të parë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.1282/22 të datës 15.11.2022, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 760/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 13.03.2019.

Edhe sipas gjykatës ankimore, faturat në rastin konkret kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm e si të tilla paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbartimit, sepse i përmbajnë të gjitha elementet siç kërkohet me paragrafin 3 të Nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, i cili thotë se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbartjes se detyrimit monetar”*.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka përkrahur qëndrimin se kreditori përmes deklaratës me shkrim të lëshuar me datë 04.06.2018 borxhi sipas faturave është bërë i kërkueshëm në ditën e lëshimit të secilës faturë, për secilën faturë.

48. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 89/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 04.01.2023.

Kreditori duhet të bëj faturimin veç e veç për secilin shërbim apo që të gjitha shërbimet t'i përshkruajë në faturën në bazë të së cilës do të kërkojë përmbarimin. Përveçse fatura duhet të plotësojë kushtet nga Neni 29 i LPP-së, në qarkullimin afarist, fatura duhet të jetë kthyese, që nënkupton se debitori duhet të pranojë të njëjtën.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, për faktin se në dëftesën për pranimin e dërgesës është përdorur shprehja "letra", një dorëzim i tillë nuk mund të konsiderohet i rregullt, pasi që nga kjo dëftesë nuk mund të vërtetohet se a është fjala për faturën kontestuese apo për ndonjë dokument tjetër!

Kreditori me datë 14.01.2019, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës së datës 18.12.2018.

Përmbaruesi Privat sipas propozimit të kreditorit, me Urdhrin Përmbarimor P.nr. 58/19 të datës 14.01.2019, ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedh nga Marrëveshja për Punimet shtesë të kanalizimit në trasenë Task - A, dhe Task - B, t'ia paguajë shumën përkatëse.

Kundër Urdhrit Përmbarimor debitori me datën 11.02.2019 ka paraqitur prapësim, me pretendimin se fatura e kreditorit nuk është e nënshkruar dhe e pranuar nga debitori. Fatura nuk përmban objektin, përkatësisht përshkrimin për punët të cilat janë kryer, dhe nuk është në pajtim me Nenin 29 par. 2 dhe 3 të LPP, duke shtuar se debitori e kishte lajmëruar kreditorin në lidhje me mungesën e përshkrimeve të faturës dhe arsyet bazë për lëshimin e kësaj fature përmes emalit të datës 04.01.2019 duke kërkuar shpjegime lidhur me siguracionet teknike, të lart cituar por që nuk ka marrë fare përgjigje nga ana e kreditorit.

Kreditori ka lëshuar faturë pa bazë andaj edhe nuk mund të rrjedh obligimi debitorit për t'ia paguar këto fatura. Kreditori ka dështuar të prezantoj pranimin teknik si provë e cila do të dëshmonte kryerjen e punëve nga ana e tij për të cilat punë kreditori ka lëshuar faturë si dhe ta provojë pretendimin e tij mbi bazën e të cilit është lëshuar fatura, andaj propozon që gjykata ta aprovojë prapësimin e debitorit, ta anulojë Urdhrin Përmbarimor dhe të gjitha veprimet e kryera në këtë procedurë, si dhe ta detyrojë kreditorin t'i kompensoj shpenzimet procedurale debitorit.

Me datë 14.02.2019, kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësim, me arsyetimin se prapësimi është i pabazuar sepse fatura ka ardhur si rezultat i punëve të kryera dhe se nuk qëndron pretendimi se fatura nuk ka detaje tjera se si ka ardhur tek ai si obligim. Fatura është e rregullt, ato punë janë realizuar dhe pranuar nga zyrtari përgjegjës, e njëjta i është dërguar debitorëve në dy mënyra edhe përmes postes elektronike edhe përmes postës në kopje fizike. Bazuar në provat e ofruara prapësimi i debitorit nuk i plotëson asnjërin nga kriteret e kërkuara me Nenin 71 të LPP pasi nuk ekziston asnjëra nga bazat e kërkuara që një prapësim duhet t'i ketë në mënyrë që të trajtohet si i bazuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PPP.nr. 313/19 të datës 21.05.2020, ka aprovuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit, ka shfuqizuar Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 58/19 të datës 14.01.2019 të lëshuar nga Përmbarruesi Privat, dhe ka anuluar të gjitha veprimet e ndërmarra deri me tani në këtë çështje përmbarrimore, ndërsa ka vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Në arsyetim të vendimit, gjykata ka theksuar se fatura në bazën e së cilës është lejuar përmbarrimi është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori, e njëjta nuk është nënshkruar nga debitori dhe së nuk ka prova se fatura i është dorëzuar ndonjëherë debitorit.

Fatura në bazë të cilës është lejuar përmbarrimi në përshkrimin e saj referohet në "Punimet shtesë të kanalizimit në trasenë Task - A dhe Task - B në sasi 1.00 e çmim" përkatës ndërsa në shkresat e lëndës gjendet një listë përfundimtare e punimeve shtesë për të cilat thuhet se janë të konfirmuara dhe mbetet për tu diskutuar çmimi. Kreditori do të duhej të bënte faturimin veç e veç për secilin veprim apo të gjitha t'i përshkruante në faturën në bazë të së cilës ka kërkuar përmbarrimin, por i njëjti ka dështuar ta bëjë një gjë të tillë, andaj kjo faturë nuk mund të konsiderohet si dokument i besueshëm sepse nuk i plotëson kushtet e parapara me Nenin 21 dhe 29 par. 1 nënpar.1.3 dhe par. 3 të LPP.

Kundër këtij aktvendimi, kreditori në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë ta prishë dhe lëndën ta kthejë në shkallë të parë në rivendosje ose aktvendimin e ankimuar ta ndryshojë dhe duke e aprovuar Urdhrin Përmbarrues të Përmbarruesit Privat P.nr.58/19, të datës 14.01.2019

Përgjigje ndaj ankesës se kreditori ka parashtruar debitori, me pretendimin se nuk qëndrojnë arsyet e dhëna të kreditorit, andaj ka propozuar që gjykata e shkallës së dytë ta refuzojë këtë ankesë, aktvendimin e ankimuar ta vërtetojë dhe ta detyrojë kreditorin që t'i paguajë shpenzimet procedurale sipas tarifës së OAK.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 89/22, të datës 04.01.2023, ka refuzuar të pabazuar ankesën e kreditorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 313/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 21.05.2020.

Dhoma e Shkallës së Dytë, ka mbështetur qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me vendosjen në këtë rast konkret. Lidhur me çështjen e pranimit të faturës, gjykata ankimore ka aplikuar Nenin 20 par. 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2010 për zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, i cili në Nenin 20 par.1 nënpar.1.17 ka paraparë që: "Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore", konsideron se fatura si dokument në sajë të së cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se është e pranuar nga debitori, e njëjta nuk është e vulosur nga debitori e as e nënshkruar nga ana e tij në mënyrë që të konsiderohet si dokument i besueshëm.

Andaj, në rastin konkret nuk plotësohen kushtet e parapara me Nenin 29 paragrafi 1, pika 1.1 të LPP, ku në qarkullimin afarist fatura duhet të jetë kthyesë, që nënkupton që debitori duhet t'i pranojë të njëjtat, për të plotësuar kushtin si dokument i besueshëm.

Kjo gjykatë ka vlerësuar pretendimet ankimore në lidhje me dërgimin e faturës, ndërsa në shkresa të lëndës gjenden dëftesa për pranimin e dërgesës së datës 18.12.2018, në bazë të së cilës pretendohet se debitori i ka pranuar faturën kontestuese, mirëpo në dërgesë shkruan se brenda saj ka “letra”, por shprehja “letra”, nuk mund të vërtetohet se a është fjala për faturën kontestuese në fjalë, pasi që nuk shkruan numri i faturës apo ndonjë inicial tjetër që nënkupton se brenda dërgesës për pranim gjendet fatura si dokument përmbarimor.

Lidhur me çështjen e dorëzimit të faturës, një vendosje të tillë të Dhomës së Dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, mund ta gjeni edhe në Aktvendimin Kom.Dh.Shk. II.nr. 993/23 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, të datës 20.09.2023.

49. Aktvendimi Kom Dh.Shk.II.nr. 435/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 15.02.2023.

Gjykata i ka pranuar si të rregullta faturat të cilat nuk janë të vulosura dhe as të nënshkruara, por të cilat debitori i ka paguar pjesërisht, ashtu që përmes pagesës së tyre është vërtetuar pranimi i tyre.

Kreditori me datë 04.05.2020, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturave të datave 23.05.2019, 24.12.2019, dhe 04.02.2020, të lëshuara në emër të punëve të kryera, secila pjesërisht e paguar nga ana e debitorit. Meqenëse debitori nuk e ka paguar shumën e tërësishme të borxhit, kreditori ka kërkuar edhe pagesën e kamatës prej 8% nga dita e ushtrimit të propozimit e deri në pagesën përfundimtare, si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbarimore në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit.

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit ka lejuar përmbarimin me Urdhrin P.nr.62/20, të datës 04.05.2020, ndërsa kundër këtij urdhri debitori me datën 09.06.2020 ka ushtruar prapësim, duke theksuar se dy nga fatura nuk janë të përshtatshme për përmbarim sepse nuk janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori dhe si të tilla nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë, për shkak se të njëjtat duhet të jenë të nënshkruara dhe të vulosura. Tutje, një faturë mbi të cilën është lejuar përmbarimi është paguar përmes dy pagesave nga debitori, fakt ky i cili vërtetohet përmes dëshmimeve të bashkëngjitura, megjithatë sipas debitorit kjo faturë nuk plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, në bazë të të cilës mund të realizohet përmbarimi i propozuar nga ana e kreditorit. Sipas debitorit, vetëm një faturë e lëshuar nga kreditori plotëson kumulativisht kushtet për përmbarim.

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri- Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin CPP.nr.437/20 e datës 25.01.2021, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit si të bazuar ashtu që ka anuluar pjesërisht Urdhrin P.nr. 62/20 e Përmbaruesit Privat mbi lejimin e përmbarimit, të datës 04.05.2020 në atë mënyrë që është detyruar debitori, që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimi, t'ia paguajë kreditorit shumën përkatëse, në emër të borxhit të papaguar.

Në arsyetim të vendimit, gjykata ka theksuar se një faturë është e pranuar dhe nënshkruar nga debitori, porse nuk është paguar në tërësinë e saj. Tutje, gjykata ka gjetur se një faturë nuk ka nënshkrim dhe vulë, mirëpo debitori ka pohuar se është bërë pagesa e pjesshme e kësaj fature dhe atë përmes dy herëve, andaj pretendimi i debitorit se kjo faturë nuk është dokument i besueshëm, nuk qëndron, dhe është në kundërshtim me provat e prezantuara nga vetë debitori, respektivisht dëshmitë e pagesave të pjesshme, për shkak se debitori pjesërisht ka përmbushur detyrimet e përcaktuar në të.

Ndërsa sa i përket faturës për të cilën debitori ka pohuar se është pranuar në mënyrë të rregullt me vulë dhe nënshkrim, është deklarim i saktë i debitorit, mirëpo detyrimet e saj nuk janë përmbushur nga debitori.

Kundër këtij aktvendimi, debitori në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa e tij, të anulohen Aktvendimi CPP.nr.437/20 i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, i datës 25.01.2021, dhe Urdhri P.nr. 62/2020 për lejimin e përmbarimit, i datës 04.05.2020, dhe rrjedhimisht të refuzohet propozimi për përmbarim i kreditorit, si dhe të obligohet kreditori t'ia paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore debitorit.

Në ankesën e ushtruar, debitori ka pretenduar se gjykata gabimisht ka konstatuar se pretendimet e debitorit sikurse në prapësim janë në kundërshtim me veprimet e tij për shkak se debitori ka përmbushur obligimin e tij që rrjedhin nga kjo faturë e kontestuar. Ndërkaq, sa i përket dy faturave të tjera, sipas debitorit nuk kanë qenë të nënshkruara, të pranuar e as të vulosura nga personi kompetent pranë debitorit, dhe si të tilla këto fatura vazhdojnë të mos jenë të përshtatshme për përmbarim.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit Kom Dh.Shk.II.nr.435/22, të datës 15.02.2023, ka refuzuar të pathemeltë ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin CPP.nr. 437/20 e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, të datës 25.01.2021.

50. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1274/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 17.05.2023.

Përcaktimi në faturë i afatit paritiv për përmbushjen e detyrimeve është kusht i domosdoshëm që fatura të mund të fitojë cilësinë e dokumentit të besueshëm. Në rast të mospërcaktimit të një afati të tillë në faturë, kreditori duhet të paraqesë deklaratë me shkrim përmes të cilës kumton arritshmërinë e kërkesës në pajtim me Nenin 30 të LPP-së.

Kreditore, me datë 26.05.2020 ka paraqitur propozimin për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave të datave 28.01.2015, 10.07.2015, 05.10.2015 dhe atë të datës 02.06.2017, në vlerën përkatëse.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.182/2020 të datës 26.05.2020 ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditore, ndërsa debitorit brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me arsyetimin se faturat nuk përmbajnë afat paritiv, duke i propozuar kështu gjykatës që prapësimin ta aprovojë si të bazuar, të anulojë Urdhrin Përmbarimor, dhe të refuzojë propozimin e kreditorit.

Kreditore, brenda afatit ligjor ka ushtruar përgjigje në prapësim nëpërmjet të cilit i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzojë si të pabazuar dhe të vërtetojë urdhrin përmbarimor të Përmbaruesit Privat.

Gjykata Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, me Aktvendimin PP.nr. 182/2020 të datës 01.07.2021, ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbarim P.nr.182/2020, të datës 26.05.2020 të Përmbaruesit Privat, dhe procedura përmbarimore është përfunduar sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr.182/2020.

Gjykata ka theksuar se faturat nuk përmbajnë afatin paritiv të përmbushjes së detyrimit andaj këto fatura nuk janë në harmoni me Nenin 29 par.3 të LPP-së.

Kundër këtij aktvendimi, kreditore në afatin ligjor ka ushtruar ankesë me propozimin që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të ndryshohet Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, PP.nr.182/2020 i datës 01.07.2021, apo që ky aktvendim të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.1274/22, të datës 17.05.2023, ka refuzuar si të pathemeltë ankesën e kreditorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PP.nr. 182/20 e Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, të datës 01.07.2021.

Gjykata ankimore ka përkrahur qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë se në rastin konkret faturat në bazë të të cilave është kërkuar realizimi i përmbarimit, nuk përmbajnë afatin paritiv të përmbushjes së detyrimit, si kusht i domosdoshëm për ta fituar cilësinë e dokumentit të besueshëm.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka gjetur se kreditori nuk ka paraqitur deklaratë me shkrim për arritshmërinë e kërkesës në pajtim me Nenin 30 të LPP-së me të cilin parashihet se:

“Kur nga dokumenti i besueshëm nuk shihet se a është bërë e kërkueshme kredia, atëherë përmbarimi caktohet vetëm në qoftë se kreditori paraqet deklaratë me shkrim se kredia e tij është bërë e kërkueshme duke u treguar edhe dita për një gjë të tillë.”

51. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 173/2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 01.06.2023.

Faturat si dokumente të besueshme mbi bazën e së cilave është lejuar përmbartimi, nuk janë të nënshkruara dhe të pranuar nga ana e debitorit. Rrjedhimisht, këto fatura nuk mund të konsiderohen si dokument i besueshëm për përmbartim në kuptim të dispozitës së Nenit 21 dhe 29 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Kreditori, me datë 05.06.2020, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave të datave 03.02.2020, 29.01.2020, 27.01.2020 dhe të datës 22.01.2020, për shërbimet e kryera në shumën përkatëse.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbartim të kreditorit, me Urdhrin P.nr.75/20 të datës 26.01.2022, ka lejuar përmbartimin e propozuar, ndërsa debitori me datë 10.06.2020, ka ushtruar prapësim duke theksuar se nuk ka asnjë provë se dokumenti i besueshëm – faturat i janë dorëzuar nga ana e kreditorit, dhe si të tilla nuk janë as të nënshkruara apo të vulosura nga ana e debitorit. Ka theksuar se faturat janë të përpiluara në gjuhë të huaj të cilat nuk janë përkthyer në njërin nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Andaj këto fatura janë në kundërshtim të Nenit 18, 29 par. 3, 43 par. 4 të LPP-së.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori duke theksuar se janë të pa bazuara pretendimet e debitorit në prapësim, andaj edhe ka kërkuar që gjykata të refuzojë prapësimin, dhe Urdhri Përmbartimor të lihet në fuqi.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin PPP.nr.653/20, e datës 26.01.2022, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit P.nr.075/20 Përmbartuesit Privat, të datës 26.01.2022.

Në arsyetim të vendimit, gjykata ka gjetur se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim të dokumentit të besueshëm - faturave të datës 03.02.2020, 29.01.2020, 27.01.2020, dhe atë datës 22.01.2020 për shërbimet e kryera, mbi bazën e të cilave edhe është lejuar përmbartimi. Gjykata ka vlerësuar se urdhri për përmbartim i lejuar nuk është në kundërshtim me dispozitën e Nenit 29 dhe 30 të LPP-së. Gjykata ka vërtetuar se kredia është bërë e realizueshme, pasi që debitori ka pranuar faturat në fjalë, fakt i cili vërtetohet nga e-mail i datës 16.03.2020, përmes të cilit konfirmohet pranimi i faturës dhe borxhit ndaj kreditorit. Sidoqoftë, debitori nuk e ka paguar borxhin. Gjykata ka gjetur se propozimi dhe shkresat janë të përpiluara në gjuhët zyrtare të gjykatës, ndërsa fatura janë të lëshuar në gjuhën sipas të cilës palët kanë pasur raporte të ndërsjella si më parë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, me propozimin që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë si të bazuar ankesën e debitorit, ashtu që aktvendimi të ndryshohet dhe të refuzohet propozimi i kreditorit.

Gjykata Komeriale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr. 173/2023, të datës 01.06.2023, ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit, ka prishur Aktvendimin PPP.nr. 1496/19 e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 30.01.2020, dhe çështja i është kthyer në rigjykim dhe rivendosje Gjykatës Komeriale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Parë.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka vlerësuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me faturë e cila nuk paraqet dokument të besueshëm, pasi që e njëjta nuk është pranuar dhe nënshkruar nga ana e debitorit, dhe si e tillë nuk paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarimit në kuptim të dispozitës së Nenit 21 të LPP-së.

52. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 336/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 18.07.2023.

Gjykata ka vlerësuar se kërkesat e kreditorit nuk janë ende të kërkueshme pasi që debitori nuk na lëshuar certifikatën finale të pranimit për mallin e pranuar nga kreditori, ashtu siç është përcaktuar në raportin kontraktual në mes palëve. Andaj, në rastet kur në mes të palëve përmes kontratës është rregulluar çështja e pagesës, Gjykata duhet të marrë parasysh këto aspekte me rastin e vendosjes, dhe jo të veprojë sikurse në rastet e mungesës së kontratës, kur Gjykata analizon vetëm aspektet formale të faturës.

Kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në emër të detyrimeve të mbetura.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me Urdhrin Përmbarimor P.nr. 157/2021 të datës 11.01.2021, ka lejuar përmbarimin me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në bazë të faturës së datës 04.05.2021 dhe kontratës së datës 18.03.2021 t'ia paguajë shumën përkatëse. Kundër Urdhrit Përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim me të cilin ka kundërshtuar urdhrin për përmbarim, duke shtuar se ka kundërshtuar faturat e lëshuara nga kreditori për shkak malli i shpërndarë nga kreditori, përkatësisht televizionet e shpërndara nuk plotësojnë kushtet sipas specifikacioneve të parapara me kontratë.

Gjykata Themelore në Gjakovë, me Aktvendimin PPP.nr. 218/21 të datës, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, dhe ka anuluar Urdhrin Përmbarimor P.nr.nr. 404/2021 të datës 29.07.2021, të lëshuar nga Përmbaruesi Privat.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka theksuar se në e lëndës ka konstatuar se televizionet e shpërndara nga kreditori nuk plotësojnë kushtet sipas specifikacioneve në kontratën me titull “*furnizimi me kompjuter dhe Laptop - Furnizimi me TV Smart*” dhe është kundërshtuar pranimi i faturës së paraqitur nga kreditori, shkresat andaj Urdhër për Përmbarim është lëshuar në kundërshtim me Nenin 71 të LPP-së. Këto fatura janë lëshuar nga kontrata e datës 18.03.2021 e sipas dispozitave të saj ende nuk është i kërkueshëm detyrimi i debitorit, pasi që ende nuk është lëshuar certifikata finale e pranimit nga autoriteti kontraktues.

Kundër këtij aktvendimi, kreditori ka paraqitur ankesë me propozimin që gjykata e shkallës së dytë ankesën ta aprovojë si të bazuar, aktvendimi i ankimuar të prishet, dhe të mbetet në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.nr. 404/2021 të datës 29.07.2021.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.336/23, të datës 18.07.2023, ka refuzuar të pabazuar ankesën e kreditorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 218/21 e Gjykatës Themelore në Gjakovë, të datës 15.12.2021.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka vlerësuar se Gjykata e Shkallës së Parë ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm, duke përkrahur qëndrimin se fatura nuk përmban elementet e përcaktuara me Nenin 29 par. 3, duke vlerësuar se detyrimet e debitorit ende nuk janë të kërkueshme, për shkak të mos lëshimit të certifikatës finale për pranim.

53. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 808/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 28.08.2023.

Nënshkrimi i debitorit – pranuesit në faturë është kusht esencjal mbi bazën e së cilës fatura fiton tipare të përmbareshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga ana e debitorit. Fakti se ndërmjet palëve ekziston një raport detyrimor në bazë të licencës së lëshuar nga ana e kreditorit për debitorin, nuk përjashton prerogativat ligjore të parapara me dispozitat e Nenit 29 par. 3 të LPP-së.

Kreditori ka paraqitur propozim për përmbareshmëri ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm - faturave.

Përmbareshmëri Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me Urdhrin Përmbareshmëri KPPP.nr. 3550/18 të datës 21.11.2018, ka lejuar përmbareshmërinë me të cilën është detyruar debitori që kreditorit në emër të borxhit për tarifën vjetore të licencës që rrjedh nga faturat, t'i paguajë shumën përkatëse, si dhe shpenzimet procedurës përmbareshmërie.

Kundër Urdhrit Përmbareshmëri debitori ka ushtruar prapësim, me të cilin ka kundërshtuar urdhrin për përmbareshmëri duke theksuar se dokumenti në bazë të së cilit është marrë Urdhri Përmbareshmëri, nuk e ka titullin ekzekutiv dhe nuk i ka tiparet e përmbareshmërisë, pasi që fatura nuk është në origjinal dhe as kopje e vërtetuar, andaj, i propozon gjykatës që ta aprovojë prapësimin e debitorit, si dhe ta anulojë Urdhri Përmbareshmëri.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Parë, me Aktvendimin KPPP. nr. 898/22 e datës 28.08.2023, kanë pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, dhe kanë shfuqizuar Urdhrin Përmbareshmëri KPPP.nr.3550/18 të datës 21.11.2018, i lëshuar nga Përmbareshmëri Privat.

Gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret fatura e datës 29.01.2018 në bazë të cilës është lejuar përmbareshmëri nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, pasi që është lëshuar në mënyrë të njëanshme, nuk është pranuar nga kreditori dhe nuk përmban as nënshkrimin pranuesit – debitorit, nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar, po ashtu nuk përmban fare afatin e përmbareshmërisë se detyrimit monetar ashtu siç parashihet me Nenin 29, 37 dhe 40 par. 1.2 të LPP-së.

Kundër këtij aktvendimi, kreditori ka paraqitur ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar, të anulohet aktvendimi i ankimit, dhe të refuzohet prapësimi i debitorit si pabazuar.

Kreditori në ankesën e paraqitur ka theksuar se debitori është i obliguar të përmbareshmëri detyrimet e tij monetare në bazë të licencës së marrë nga kreditori për ushtrimin e veprimtarisë së debitorit. Sipas kreditorit, debitori me rastin e nënshkrimit të kushteve dhe termeve të përgjithshme të licencës së marrë nga kreditori, obligohet të bëjë pagesën e tarifës për çdo vit kalendarik.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 808/23, të datës 28.08.2023, ka refuzuar të pabazuar ankesën e kreditorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin KPPP.nr. 898/22 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomave të Shkallës së Parë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, fatura e lëshuar nga ana e kreditorit nuk përmban nënshkrim nga debitori, e as nuk përcakton kohën e përmbushjes. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 par.3 i LPP-së, i cili përcakton se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se ne të 3 është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”.

Në këtë rast fatura nuk e përmban nënshkrimin e pranuesit i cili është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbarueshmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitori. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbarues sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbarimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve.

Ndërkaq, lidhur me pretendimet e kreditorit rreth detyrimeve që rrjedhin nga licenca, Dhoma e Shkallës së Dytë ka theksuar se fakti se kreditori është organizatë buxhetore dhe autoritet rregullativ në fushën e mediave, është evidente se ka të drejtë për të arkëtuar pagesat e tarifës për licenca qoftë përmes faturave apo edhe akteve të veta administrative, mirëpo, hyrja në raport juridik me palët debitore dhe inicimi i procedurës përmbarimore nuk nënkupton se mund të anashkalohen prerogativat ligjore të parapara me dispozitat e Nenit 29 par.3 të LPP-së.

Gjykata ka ritheksuar se në procedurën përmbarimore organi përmbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Organi përmbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç’ rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

54. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 745/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës
- Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 14.04.2023.

Urdhri i Përmbauesit Privat përmes të cilit është lejuar përmbarimi në bazë të propozimit për përmbarim, të përpiluar dhe të nënshkruar nga vet Përmbauesi Privat, është i kundërligjshëm. Procedura e përmbaimit fillohet me vetëm me propozimin e kreditorit. Kreditori apo i autorizuari i kreditori duhet ta përpilojë propozimin për përmbarim dhe ta nënshkruajë atë. Në rast se propozimi i kreditorit plotëson kushtet për përmbarim, përmbauesi duhet të nxjerrë urdhër përmbarimor për lejimin e përmbaimit.

Kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës së datës 02.03.2015 në vlerën përkatëse. Përmbauesi Privat me Urdhrin Përmbaimit P.nr.78/2015, të datës 14.04.2015, ka lejuar përmbaimit ndaj debitorit.

Debitori ka paraqitur prapsim me arsyetimin se propozimi nuk paraqet bazë për përmbarim pasi që debitori nuk ka asnjë detyrim të pashlyer ndaj kreditorit dhe mbi këtë bazë nuk ka kurrfarë obligimi ndaj tij. Përmbauesi e ka lejuar urdhrin për përmbarim pa asnjë bazë ligjore dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe LMD-së dhe në kundërshtim me dispozitat e kësaj kontrate, pasi që kreditori ka faturuar pa bazë ligjore debitorit shumën përkatëse. Prandaj, debitori i ka propozuar gjykatës shfuqizimin e urdhrin dhe aprovimin e prapësimit.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar kreditori i përmbaimit i cili ka theksuar se propozimi për përmbarim është i lejuar sipas Nenit 27 par. 1, 29 par 1.3 dhe Nenit 38 par. 1 dhe Neni 40 par. 1.2 të LPP-së, ku dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është kreditori dhe debitori si dhe shumat e përmbushjes së detyrimit monetar, me propozimin që gjykata ta refuzojë prapësimin e debitorit.

Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PPP.nr. 1245/14, të datës 03.12.2020, ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, ka shfuqizuar Urdhrin për Përmbaimit P.nr. 78/2015 të datës 14.04.2015, të lejuar nga Përmbauesi Privat, si dhe ka anuluar të gjitha veprimet e ndërmarra nga Përmbauesi Privat.

Në Pikën II të dispozitivit të aktvendimit ka vendosur që të lirohet nga garancia dhe të urdhërohet shërbimi i arkës së gjykatës, që t'ia kthejë mjetet monetare në formë të garancisë debitorit, dhe të njëjtat të ia kthejë në xhirollogarinë bankare të tij, pasi ky Aktvendim të bëhet i formës së prerë.

Sipas gjykatës së shkallës së parë, Urdhri për lejimin e Përmbaimit nr. P.nr. 78/15 i datës 14.04.2015 është i pa rregullt për faktin se propozimin për përmbarim e ka përpiluar vet Përmbauesi Privat, e ka nënshkruar dhe pastaj të njëjtin propozim për përmbarim i njëjti përmbaues privat e ka lejuar përmbaimit.

Një fakt i tillë nënkupton se vet kreditori apo i autorizuari i kreditori duhet ta përpilojë propozimin për përmbarim dhe ta nënshkruajë atë, ndërsa Përmbauesi Privat propozimin e kreditorit i cili i plotëson të gjitha kushtet për përmbarim, duhet të nxjerrë urdhër përmbaimit, e që në këtë rast Përmbauesi Privat nuk ka vepruar ashtu siç është dashur. Me dispozitat e Nenit 5 par. 3 të LPP-së është paraparë që:

“Përmbaruesi Privat nxjerr urdhër në bazë të propozimit për kryerje të përmbarimit dhe kryen përmbarimin me qëllim të plotësimit të kërkesës së debitorit në bazë të dokumentit përmbarues, përveç nëse ndryshe parashikohet me ligj që urdhëron që përmbarimi dhe kryerja e përmbarimit të bëhet brenda juridiksionit të Gjykatës.”

Kështu, urdhri i lëshuar nga Përmbaruesi Privat për lejimin e përmbarimit është lëshuar në kundërshtim të Nenit 71 të LPP-së dhe i njëjti është lëshuar në kundërshtim me Nenin 37 lidhur me Nenin 43 par.4 të LPP-së.

Gjykata ka vendosur si pikën II të dispozitivit në bazë të Nenit 78 të LPP-së duke lejuar lirimin e garancisë, e duke i pasur parasysh të lartcekur, ka vlerësuar se shuma e garancisë duhet t’i kthehet debitorit.

Kundër këtij aktvendimi kreditori në afatin ligjor ka parashtruar ankesë me propozimin që Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PPP.nr.1245/20 i datës 03.12.2020 të priset dhe çështja t’i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë ose të ndryshohet dhe propozimi përmbarimor i kreditorit i cili veç është ekzekutuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr.745/22, të datës 14.04.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e kreditorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PP.nr. 1245/20 e Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 03.12.2020.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka përkrahur vendosjen se urdhri për lejimin e përmbarimit me numër P.nr.78/2015 i datës 14.04.2015 të lejuar nga Përmbaruesi Privat është i pa rregullt pasi që propozimin për përmbarim e ka përpiluar vet Përmbaruesi Privat, e ka nënshkruar dhe pastaj të njëjtin propozim për përmbarim i njëjti përmbarues privat e ka lejuar përmbarimin, dhe me këtë rast lejimi i përmbarimit është bërë pa u plotësuar kushti ligjor në kuptim të dispozitës së Nenit 3 par. 1 të LPP-së ku përcaktohet se:

“Procedurën e përmbarimit në shkallë të parë e udhëheq dhe për të vendosë Përmbaruesi Privat, ndërsa përjashtimisht gjyqtari individual kur me këtë ligj është caktuar se përmbarimin e cakton dhe zbaton Gjykata. Organi përmbarues vendos për propozimin e përmbarimit brenda afatit prej shtatë (7) ditëve pas pranimit të propozimit”, ndërsa me Nenin 4 paragrafi 1 të LPP-së theksohet se *“Procedura e përmbarimit fillohet me propozimin e kreditorit”.*

Në këtë rast nënkuptohet se vet kreditori apo i autorizuari i kreditori duhet ta përpilojnë propozimin për përmbarim dhe ta nënshkruaj atë, ndërsa Përmbaruesi Privat propozimin e kreditorit i cili i plotëson kushtet e përmbarimit duhet të nxjerr urdhër përmbarimor, mirëpo në këtë rast Përmbaruesi Privat nuk ka vepruar.

Prandaj, kjo gjykatë ka vlerësuar se përmbarimi në këtë çështje përmbarimore është lejuar pa u plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e Urdhrit Përmbarimor, të parapara me dispozitat e LPP-së, dhe si të tillë kjo gjykatë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur e ka aprovuar si të bazuar presimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhrin për përmbarim.



KAPITULLI IX KUSHTET PËR PËRMBARIM

55. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 1233/2022 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 23.08.2022.

Nuk mund të realizohet përbarimi i iniciuar mbi bazën e Policës së Sigurimit, për shkak një dokument i tillë, nuk është i përcaktuar në Nenin 22 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore, dispozitë kjo e cila ka përcaktuar në mënyrë taksative, se cilat dokumente mund të shërbejnë si dokumente përmbareuse.

Kreditori me datë 04.08.2020, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit, në bazë të policës për sigurimin e garancisë së tenderit dhe ekzekutimit të kontratës për shumën përkatëse.

Përmbareusi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit, me Urdhri P.nr. 160/2020 të datës 05.08.2020, ka lejuar përbarimin.

Ndaj këtij urdhri, me datë 07.08.2020, debitori ka paraqitur prapësim, me propozim për gjykatën që të aprovojë si të bazuar prapësimin e debitorit dhe Urdhri Përmbaremore ta anulojë në tërësi si të pa bazuar. Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori, me datë 14.08.2020, me propozim që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi Urdhri Përmbaremore P.nr.160/20 i datës 05.08/2020.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin PPP.nr. 998/2020, të datës 24.02.2022, ka aprovuar prapësimin e debitorit, ashtu që ka shfuqizuar urdhrin për lejimin e përbarimit P.nr. 160/20 të datës 05.08.2020, të lejuar nga Përmbareusi Privat. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se propozimi i kreditorit për përbarim në bazë të policës së sigurimit, nuk është titull ekzekutiv, dhe se nuk janë bashkangjitur prova që mund të dëshmojnë se policia e sigurimit është titull ekzekutiv.

Kundër këtij aktvendimi, kreditori në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, me propozim që të aprovohet ankesa e kreditorit dhe të anulohet aktvendimi i atakuar, dhe të mbetet në fuqi Urdhri Përmbaremore P.nr. 160/20 i datës 05.08.2020, me të cilin Përmbareusi Privat ka lejuar përbarimin e propozuar të kreditorit. Përgjigje në ankesë ka paraqitur debitori, me propozim që të refuzohet ankesa e kreditorit si e pa bazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr. 1233/2022, të datës 23.08.2022, ka refuzuar të pathemeltë ankesën e kreditorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 998/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 24.02.2022.

Edhe sipas gjykatës ankimore, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokument përmbareus, pasi që sipas dispozitës së Nenit 22 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore, askund nuk përcaktohet se Policat e sigurimit mund të shërbejnë si dokumente përmbareuse.

Andaj, këto dokumente si të tilla nga ana e vlerësimit të gjykatave janë të papërmbareushme, pasi që kjo dispozitë ligjore në mënyrë taksative ka përcaktuar se cilat dokumente mund të konsiderohen dokumente përmbareuse.

Ndërkaq, sipas Nenit 21 të LPP –së, parashihet qartë se:

“Organi përmbarues e cakton përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues dhe dokumentit të besueshëm”.

Sipas Nenit 22 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore Dokumente mbi të cilat mund të realizohet përmbarimi janë:

“Vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese; 1.2. vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia); 1.3. dokumenti noterial i përmbarueshëm në pajtim me ligjin për noterinë; 1.4. marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin pas aprovimit të Gjykatës; 1.5. aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujditë gjyqësore të Gjykatave të huaja si dhe vendimet e Gjykatave të huaja të arbitrazhit dhe ujditë e arritura para Gjykatave të tilla në raste të arbitrazhit, të cilat janë pranuar për përmbarim brenda territorit të Republikës së Kosovës; 1.6. vendimet dhe marrëveshjet përmbaruese të arbitrazhit në Republikën e Kosovës të shpallura të ekzekutueshme nga Gjykata; 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit; 1.8. vendimi gjyqësor i vërtetuar si urdhër përmbarues evropian; 1.9. dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përmbarues”.

56. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 748/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 01.09.2022.

Në rastin konkret, Organi Përmbarrimor është dashur të ndërpresë procedurën përmbarrimore, për shkak se debitori vetëm gjashtë (6) ditë pas paraqitjes së propozimit për përmbarrim nga kreditori, ka përmbushur detyrimet e tij në llogari të kreditorit.

Kreditore, me datë 09.10.2020, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës, me të cilën ka kërkuar që në emër të borxhit, t'ia paguajë shumën përkatëse, me kamatë prej 8% nga dita e arritjes së kërkesës për pagesë si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit ka lejuar përmbarrimin me Urdhri P.nr. 8378/20, të datës 09.10.2020, ndërsa kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim me datën 21.10.2020, duke theksuar se debitori në asnjë rast nuk ka kundërshtuar borxhin të cilin e ka kundërshtuar kreditorit, mirëpo ka kundërshtuar se kreditore asnjëherë nuk ka dërguar fatura te debitori për pagesë, dhe për këtë arsye nuk ka mundur të bëjë pagesën e faturave, dhe ka treguar se është i gatshëm të bëjë pagesën e borxhit sipas faturave.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me Aktvendimin PPP.nr. 968/20, të datës 10.02.2021, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, të paraqitur kundër Urdhrit për lejimin e përmbarrimit P.nr. 3729/20, të datës 09.10.2020. Në arsyetim të aktvendimit, gjykata ka theksuar se nuk janë plotësuar asnjëra nga shkaqet e parapara me Nenin 71 të LPP-së. Sipas gjykatës, fatura paraqet dokument të besueshëm, andaj edhe propozimi për përmbarrim nga ana e gjykatës është vlerësuar si i ligjshëm.

Kundër këtij aktvendimi, debitori ka parashtruar ankesë, duke i propozuar gjykatës së shkallës së dytë që ta aprovojë ankesën e debitorit dhe ta refuzojë ekzekutimin e aktvendimit mbi lejimin e përmbarrimit, dhe aktvendimin e kundërshtuar ta prishë, dhe çështjen ta kthejë në rivendosje.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.748/22, të datës 01.09.2022, ka aprovuar të themeltë ankesën e debitorit, ka ndryshuar Aktvendimin PPP.nr. 968/20 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, të datës 10.02.2021, ashtu që Pranohet i bazuar prapësimi i debitorit, shfuqizohet Urdhri Përmbarrimor P.nr. 3729/20 i Përmbarruesit Privat, i datës 09.10.2020, dhe anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarrimore në këtë procedurë përmbarrimore.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka gjetur se në shkresat e lëndës është dëftesa bankare e datës 16.10.2020 me të cilën është vërtetuar se debitori ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit, fakt për të cilin ka qenë në dijeni kreditore, për çka ka është dashur ta njoftojë edhe përmbarruesin privat në mënyrë që të ndërpritej procedura përmbarrimore.

Sipas Dhomës së Shkallës së Dytë, në rrethana të tilla nuk ka pasur kushte ligjore të vazhdohet procedura e përmbarrimit edhe pse është iniciuar e njëjta, sepse gjashtë ditë pasi që është paraqitur propozimi për përmbarrim është përmbushur obligimi nga ana e debitorit, kjo pasi që fatura në bazë të cilit është iniciuar procedura përmbarrimore nuk është e përshtatshme për përmbarrim, ashtu siç është përcaktuar me Nenin 27 të LPP.

57. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 387/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 20.12.2022.

Gjykata i ka gjetur të paprovuara pretendimet e debitorit se shuma e kërkuar nga debitori është 10% e vlerës totale të kontratës së lidhur, ku kreditori sipas dispozitave të kontratës, duhet të presë 12 muaj pas përfundimit të pranimit teknik, në mënyrë që të njëjtit të mund t'i paguhet shuma e 10% të kontratës.

Kreditori me datën 16.03.2021, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit – institucionit publik, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës së datës 02.12.2020.

Përmbaruesi Privat, sipas propozimit të kreditorit, me Urdhrit Përmbarimor P.nr. 76/21 të datës 16.03.2021, ka lejuar përmbarimin me të cilën është detyruar debitori që kreditori në emër të borxhit që rrjedh nga Kontrata e Prokurimit “Asfaltimi i rrugëve në fshatrat përkatëse”), t’ia paguajë shumën e caktuar, me kamatë ligjore prej 8% dhe të gjitha shpenzimet e përmbarimit.

Kundër Urdhrit Përmbarimor, debitori ka paraqitur prapësim me datën 25.03.2021, me pretendimin se fatura e papaguar është 10% e kontratës për ndalesë në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik dhe se kreditori edhe pse ka ofruar flet - garancione për këtë shumë, kreditori duhet të presë 12 muaj pas përfundimit të pranimit teknik sipas kontratës, në mënyrë që t’i paguhet shuma e 10 % të kontratës.

Përgjigje në prapësimin e debitorit ka ushtruar kreditori me datën 26.03.2021, duke arsyetuar se prapësimi i ushtruar nga debitori është i pabazuar dhe pretendimi i paraqitur në prapësim nuk qëndron, dhe se debitori nuk ka ofruar asnjë provë në bazë të cilës i mbështet kundërshtimet e tij.

Gjykata Themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë, me Aktvendimin PPP.nr. 981/21 të datës 19.05.2021, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, të paraqitur kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr. 76/21 të datës 16.03.2021 të Përmbaruesit Privat.

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata ka arsyetuar se fatura e datës 02.12.2020 mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarimi paraqet dokument të besueshëm dhe se bazuar edhe në dokumentet tjera si raporti teknik i datës 30.11.2020, Kontratën e Prokurimit të datës 30.08.2019, policës së fletë - garancionit, rezulton se kreditori ka pasur faturime për kryerjen e shërbimeve për debitorin, porse ka mbetur pa u paguar edhe një shumë. Gjykata ka gjetur se debitori nuk ka ofruar asnjë provë që do të dëshmonte kryerjen e obligimeve që ka pasur ndaj kreditorit.

Kundër këtij aktvendimi, debitori në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe aktvendimin e shkallës së parë ta refuzojë si të pabazuar pasi nuk kemi të bëjmë me dokument të përmbarueshëm.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.387/22, të datës 20.12.2022, ka refuzuar të pabazuar ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 981/21 të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, të datës 19.05.2021.

Sipas Dhomës së Shkallës së Dytë, fatura e datës 02.12.2020 e cila rrjedhë nga Kontrata e Prokurimit, ligjërisht paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarimit. Propozimi për përmbarim i ushtruar nga kreditori, po ashtu ka rezultuar të jetë në pajtim me Nenin 37 të LPP-së, i cila thotë se:

“Kur propozimi për përmbarim paraqitet ne bazë te dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimi t’i bashkëngjitet dokumentit tillë ne origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”, çka edhe gjykata shkalles së dytë ka vlerësuar se kreditori ka vepruar në pajtim me këtë nen.

58. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 708/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 07.04.2023.

Gjykata ka vendosur se faturat mbi bazën e të cilave është iniciuar procedura e përmbarimit nuk do të shqyrtohen për faktin se të njëjtat janë lëshuar në një gjuhë e cila zyrtarisht nuk përdoret nga ana e gjykatës. Me rastin e inicimit të procedurës përmbarimore, kreditori duhet të përkthejë faturat në gjuhën zyrtare të cilën e përdorë organi përmbarimor dhe pala debitore.

Kreditore, me datë 05.01.2021 ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës së datës 16.10.2019.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me Urdhrit Përmbarimor P.nr. 1/21 të datës 05.01.2021, ka lejuar përmbarimin, me të cilën është detyruar debitori që kreditorit në emër të borxhit t'i paguaj shumën përkatëse, me kamatë prej 8% nga data e ushtrimit të propozimit, si dhe tërë shpenzimet e procedurës.

Kundër Urdhrit Përmbarimor debitori ka ushtruar prapësim me datën 04.02.2021, me pretendimin se e kundërshton në tërësi propozimin për përmbarim si dhe urdhrin për lejimin e përmbarimit, sepse fatura si dokument i besueshëm mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarimi, është e parregullt, pasi që nuk është e nënshkruar nga ana e debitorit dhe është lëshuar në gjuhën të cilën nuk e njeh pala debitore, dhe e cila gjuhë nuk është në përdorim zyrtar nga gjykata.

Ndaj prapësimit të debitorit ka ushtruar përgjigje kreditore me datën 09.02.2021. Sa i përket pretendimit të debitorit se dokumenti bazë për përmbarim nuk ka titull ekzekutiv nuk qëndron sepse fatura e paraqitur në propozim nga kreditore përmban të gjitha elementet të cilat janë paraparë me Nenin 29 par. 1 pika 1. 3 lidhur me par. 3 të LPP-së, dhe e njëjta në pajtim me marrëveshjen e ratifikuar në mes të dy vendeve tona, dhe po ashtu, i njëjti ka pranuar mallin sipas faturës.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Deganë Podujevë, me aktvendimin PPP.nr. 267/21, të datës 23.04.2021, ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin për përmbarim P.nr. 1/2021 të datës 05.01.2021, të lejuar nga Përmbaruesi Privat, dhe ka shfuqizuar urdhrin e lartcekur të Përmbaruesit Privat.

NË aktvendimin e saj, gjykata ka arsyetuar se fatura nuk është e nënshkruar dhe vulosur nga ana e debitorit, e po ashtu e njëjta nuk është në gjuhën e cila është në përdorim zyrtar të gjykatës, dhe po ashtu, kjo gjuhë nuk njihet as nga ana e debitorit. Ndër tjera, gjykata ka theksuar se fatura nuk mund të shqyrtohet as nga gjykata pasi që nuk është në gjuhën e cila është në përdorim zyrtar të gjykatës. Andaj, ky dokument nuk është në harmoni me Nenin 29 par. 3 të LPP-se.

Kundër këtij aktvendimi, kreditore në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, aktvendimin e ankimuar ta ndryshojë apo anulojë, dhe çështjen ta kthejë në shkallë të parë në rivendosje.

Gjykata Komeriale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 708/22, të datës 07.04.2023, ka refuzuar të pathemeltë ankesën e kreditorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 267/210 e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Degës në Podujevë, të datës 23.04.2021.

Sipas gjykatës së shkallës së dytë, fatura e datës 16.10.2019, mbi bazën e së cilës është propozuar përmbarimi, nuk plotëson arsyet ligjore për tu konsideruar dokument i besueshëm, sepse e njëjta nuk përmban të gjitha elementet që kërkohen me dispozitat e cituara si më poshtë.

Neni 37 i LPP-së ka përcaktuar se: "Kur propozimi për përmbarim paraqitet ne bazë te dokumentit te besueshëm, mjafton qe propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit", po ashtu edhe Udhëzimi administrativ Nr. 15 /2010 për Zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, në Nenin 20 par. 1 nënpar. 1.17 të tij parasheh se:

"Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore".

Në rastin konkret, gjykata ka konstatuar se bazuar në shkresat e lëndës, nuk ka prova se fatura është pranuar nga debitori, pasi që e njëjta nuk është vulosur nga debitori e as nënshkruar nga ana e tij, në mënyrë që të konsiderohet si dokument i besueshëm.

Gjykata ankimore gjithashtu ka vlerësuar se pala kreditore me rastin e inicimit të procedurës përmbarimore është dashur të përkthejë faturën në gjuhën e gjykatës, tek ndonjë përkthyes i licencuar.

59. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 315/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 24.04.2023.

Pretendimi i debitorit se fatura nuk plotëson kushtet për përmbaerim me arsyetimin se e njëjta nuk është dorëzuar në origjinal apo në kopje të vërtetuar, nuk është marrë në konsideratë nga ana e gjykatës, për shkak se debitori ka përmbushur pjesërisht detyrimet e faturës në fjalë. Për shkak të një rrethane të tillë, debitori nuk mund të mohojë pranimin e faturës, dhe nuk mund të kontestojë përshtatshmërinë e faturës për përmbaerim.

Kreditori me datën 13.03.2020, ka paraqitur propozim për përmbaerim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës së datës 28.10.2019, me të cilën ka propozuar që të detyrohet debitori që në afat prej 7 ditëve t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën përkatëse, me kamatë vjetore në lartësi prej 8%, shpenzimet për përpilimin e propozimit, si dhe të gjitha shpenzimet tjera të krijuara në këtë procedurë.

Kundër Urdhrit për lejimin e përmbaerimit, debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin i ka propozuar Gjykatës ta aprovojë prapësimin, ta abrogojë Urdhrin Përmbaerimor P.nr:96/20 të datës 13.03.2020 dhe t’i anulojë të gjitha veprimet e ndërmarra procedurale. Debitori ka shtuar se dokumenti në bazë të të cilit është lejuar përmbaerimi nuk e ka cilësinë e dokumentit të besueshëm siç parashihet me dispozitat e Nenit 29 të LPP-së. Sipas tij Përmbaeruesi Privat ka lëshuar Urdhrin Përmbaerimor në kundërshtim me Nenin 40. par. 1.3 dhe 37 të LPP-së, pasi që në rastin konkret fatura e bashkangjitur nuk është në origjinal, e as në kopje të vërtetuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin PPP.nr. 535/20, të datës 12.10.2020, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit për pagesën e borxhit, të ushtruar kundër Urdhrit për Lejimin e Përmbaerimit P.nr:96/20 të datës 13.03.2020, të lëshuar nga Përmbaeruesi Privat, ka obliguar debitorin që në rast të ushtrimit të ankesës kundër aktvendimit, atëherë ai urdhërohet që të deponoj në gjykatë garancinë në shumën përkatëse, në afat prej 7 ditëve pas ushtrimit të ankesës, si parakusht për shqyrtimin e saj. Ndërkaq, është vendosur po ashtu se nëse debitori dështon të paguaj garancinë brenda afatit ligjor, ankesa kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare.

Gjykata pretendimet e debitorit lidhur me kontestimin e faturave, i ka konsideruar si të pa baza, për faktin se nga shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se debitori pjesërisht ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga fatura e datës 28.10.2019, fakt të cilin gjykata e ka vërtetuar përmes dokumentit bankar të ashtuquajtur “Qarkullimi për llogari të klientit (kreditorit)”, me përshkrimin “fatura Nr... pjesërisht”. Për shkak të një rrethane të tillë, debitori nuk mund të mohojë pranimin e faturës, dhe të kontestojë përshtatshmërinë e saj për përmbaerim.

Kundër aktvendimit të lartcekur, debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë, me propozimin që të aprovohet ankesa e debitorit në tërësi si e bazuar dhe Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.535/20, i datës 12.10.2020 të prishet, dhe lënda të kthehet në rigjykim – në vazhdim të procedurës përmbaerimore.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr. 315/22, të datës 24.04.2023, ka refuzuar të pathemeltë ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 535/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 12.10.2020.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka vlerësuar se fatura e kreditorit është e rregullt dhe shumën e faturuar sipas faturës në fjalë të paraqitur origjinal, debitori e ka pranuar me datë 28.10.2019. Në bazë të dokumentit bankar *“Qarkullimi për llogari të klientit (kreditorit)”*, gjykata ka vërtetuar se debitori me datë 07.02.2020 në llogarinë e kreditorit ka transferuar shumën përkatëse me përshkrimin *“fatura Nr.. pjesërisht...”*. Fakti se në përshkrimin e pagesës vet debitori ka specifikuar numrin e faturës i cili është dokument i besueshëm në këtë procedurë përmbare, nënkupton se nuk mund të mohohet pranimi i faturës dhe mungesa e përshtatshmërisë së saj për përmbare siç pretendon debitori.

60. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 496/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 10.05.2023.

Gjykata ka vendosur se faturat e lëshuara në bazë të detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata e Konsignacionit, nuk plotësojnë kushtet ligjore për tu konsideruar si dokumente të besueshme, mbi bazën e të cilave mund të iniciohet dhe realizohet përmbarimi.

Kreditori, me datë 20.05.2021 ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – tre Faturave të datës 02.10.2019.

Përmbaruesi Privat sipas propozimit të kreditorit, me Urdhrit Përmbarimor P.nr.192/21 të datës 24.05.2021 ka lejuar përmbarimin me të cilën është detyruar debitori që kreditorit në emër të borxhit t'i paguaj shumën përkatëse.

Kundër Urdhrit Përmbarimor, debitori ka paraqitur prapësim me datë 10.06.2021 duke theksuar se kreditori ka faturuar pa ndonjë bazë ligjore, më tej në kundërshtimet e tij debitori ka theksuar se dokumenti mbi bazën e së cilit është lëshuar Urdhri Përmbarimor, nuk është titull ekzekutiv, nuk ka tiparet për të qenë i përshtatshëm, e po ashtu ka theksuar se këtu ndërgjyqësit në cilësi të kontraktuesve kanë qenë në raport kontraktual, sipas kontratës së datës 01.10.2019 dhe se fatura e lëshuar dhe bazuar në këtë kontratë është me konsignim.

Përgjigje në prapësimin e debitorit ka parashtruar kreditori me datën 02.07.2021. Me këtë parashtrësë kreditori ka kundërshtuar të gjitha prapësimet e debitorit si të pa bazuara.

Gjykata Themelore në Prizren, me Aktvendimin PPP.nr.184/2021 e datës 01.03.2022, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat P.nr. 192/2021, të datës 24.05.2021. Në arsyetim të aktvendimit, gjykata ka vlerësuar se faturat e lëshuara nga kreditori janë të përshtatshme për përmbarim konform Nenit 22, 29 par. 1.3 dhe par. 3, të LPP-së.

Kundër këtij aktvendimi, debitori në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, me propozim që gjykata e shkallës së parë të aprovojë ankesën si të bazuar, aktvendimin e shkallës së parë ta prishë dhe ta aprovojë prapësimin e debitorit, Urdhrit Përmbarimor ta shfuqizojë, apo në të kundërtën, lëndën ta kthejë në rivendosje, duke e detyruar kreditorin t'i paguajë shpenzimet procedurale.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr.496/23, të datës 10.05.2023, ka aprovuar si të bazuar ankesën e debitorit, ka anuluar Aktvendimin PPP.nr. 184/21 e Gjykatës Themelore në Prizren, e datës 01.03.2022, dhe çështjen ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje, pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Parë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturave të datës 02.10.2019 të cilat janë rrjedhojë e raportit të ndërsjellë kontraktual mbi bazën e konsignacionit. Këto fatura si të tilla nuk kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm ashtu siç përcaktohet me dispozitën e Nenit 29 par. 3 të LPP-së.

61. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 735/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 10.05.2023.

Përkundër faktit se Biznesi Individual, pronar i të cilit ka qenë debitori, është mbyllur, debitori si përfaqësuesi ligjor i Biznesit Individual, nuk do të lirohet nga detyrimet e tij që ka ndaj kreditorit, me pretendimin se me mbylljen e biznesit të tij individual, janë shuar dhe detyrimet ekzistuese.

Kreditori, me datën 05.02.2020, ka paraqitur propozimin për përmbarim për pagimin e borxhit, në bazë të dokumentit përmbarimor Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë II.C.nr. 193/2008 të datës 24.06.2008, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet propozimi për përmbarim i debitorit ashtu që të obligohet kreditori t'ia paguajë borxhin në emër të kredisë së pakthyer t'i paguajë shumën përkatëse, me kamatë vjetore prej 15% duke e llogaritur prej datës 16.05.2008 e deri në pagesën definitive, si dhe ka kërkuar tërë shpenzimet e procedurës.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit ka nxjerrë Urdhrin Përmbarimor P.nr.01/09 i datës 15.02.2012, duke lejuar propozimin e propozuar, kundër të cilit, debitori ka paraqitur prapësim, duke theksuar se propozimi për përmbarim dhe Urdhri Përmbarimor është i pabazuar. Debitori ka arsyetuar se nuk ka qenë garantues i kredisë së marrë, pasi që kredia është riprogramuar disa herë, dhe në kredinë e fundit i njëjti ka pretenduar se nuk ka nënshkruar fare, përkundër insistimit të bankës.

Gjykata Themelore në Ferizaj – Dega në Shtërpce, me Aktvendimin PPP.nr. 250/20 e datës 17.06.2021, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit E.nr. 01/09 të datës 15.02.2012, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj dhe mbetet në fuqi aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit E.nr. 01/09, i datës 15.02.2012.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, debitori ka paraqitur ankesë, me propozimin që të aprovohet ankesa e debitorit dhe aktvendimin i atakuar të prishet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje. Debitori ka pretenduar se ka më shumë se 10 vite që biznesi i tij individual është mbyllur, dhe në bazë të këtij fakti, i njëjti duhet liruar nga borxhi i pretenduar i kreditorit.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr. 735/22, të datës 10.05.2023, ka refuzuar të pabazuar ankesën e debitorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 250/20 të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Shtërpce, të datës 17.06.2021.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka vlerësuar pretendimet ankimore të debitorit lidhur me atë se Biznesi Individual pronar i të cilit ka qenë, ka kaluar gati një dekadë që nuk ekziston, është mbyllur, dhe tashmë është vetëm Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara, mirëpo këto pretendime gjykata i ka vlerësuar si të pabazuara, me arsyetimin se duke u mbështetur në dispozitat e Nenit 48 par. 1 të Ligjit Nr. 06/L-06 për Shoqëritë Tregtare është përcaktuar se:

“Një person mund të ketë vetëm një biznes individual, personi i cili është pronar i një Biznesi Individual ka përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të shkaktuara, ose të imponuara nga një ligj ose kontratë në një Biznes Individual”.

Prandaj, edhe përkundër faktit se Biznesi Individual tanimë nuk ekziston, përfaqësuesi i tij ligjor nuk do të lirohet nga detyrimi që ka ndaj kreditorit.

62. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 353/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 22.05.2023.

Faturat me vetëm vulën e debitorit, por pa nënshkrimin e tij, nuk mund të konsiderohen dokumente të besueshme. Nënshkrimi nga palët në marrëdhënie detyrimi nuk paraqet vetëm një formalitet, por një veprim i tillë nënkupton pranimin e punëve të kryera nga kreditori dhe pohimin se ekziston borxhi ndaj kreditorit sipas faturave.

Kreditore me datën 17.09.2021, ka paraqitur propozimin për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturave të datave 25.05.2021, 27.05.2021, 30.06.2021, 29.06.2021, 29.06.2021, dhe 29.06.2021 në shumën përkatëse.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me Urdhrin Përmbarimor P.nr.550/21 të datës 17.09.2021, ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditore, ndërsa debitorin brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim duke kërkuar që prapësimi i debitorit të aprovohet si i bazuar, urdhri për përmbarim të anulohet, me arsyetimin se faturat nuk janë pranuar në mënyrë të rregullt, pasi që të njëjtat nuk përmbajnë nënshkrimin e debitorit, por vetëm vulën e tij.

Përgjigje në prapësim brenda afatit ligjor ka ushtruar kreditore duke kundërshtuar pretendimet e debitorit në prapësim, duke kërkuar që të refuzohet si i pabazuar prapësimi dhe urdhri përmbartes privat mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP. nr. 766/22, të datës 16.12.2022, ka refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit të paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 550/2021 të datës 17.09.2021 të Përmbaruesit Privat, duke lënë në fuqi Urdhrin Përmbarimor P.nr.550/2021 të datës 17.09.2021, dhe ka detyruar debitorin që në emër të shpenzimeve për përpilimin e propozimit për përmbarim dhe përgjigjes në prapësim kreditorit t'ia paguajë shumën përkatëse në afat prej 7 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata ka theksuar urdhri i lejuar nga ana e Përmbaruesit Privat bazohet në dokumente të besueshëm - fatura, të cilat përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas Nenit 29 par. 3 të LPP-së.

Kundër këtij aktvendimi, debitorin në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, me propozim të aprovojë ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Parë KPPP.nr.766/22, i datës 16.12.2022, apo të ndryshohet ashtu lënda të kthehet në rivendosje.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr. 353/23, të datës 22.05.2023, ka aprovuar të bazuar ankesën e debitorit, ka prishur Aktvendimin KPPP.nr. 766/22 të Gjykatës Komerciale të Kosovës, së datës 16.12.2022, dhe çështjen ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje, pranë të njëjtës gjykatë.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka vlerësuar se faturat nuk plotësojnë kushtet sipas ligjit për të qenë dokument i besueshëm, pasi që të njëjtat nuk janë të pranuar dhe nënshkuara nga debitorin.

Sipas dispozitës së Nenit 29, paragrafi 3 të LPP-së, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, e po ashtu me Udhëzimin Administrativ Nr.15/2010, për zbatimin e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, përkatësisht në Nenin 20, paragrafi 1.1.17, përcaktohet se: *“në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruaj faturën tatimore”*, andaj në rastin konkret, gjykata pa të drejtë ka vlerësuar se faturat plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm sipas ligjit, pasi që janë të pranuar për faktin se përmbajnë vulën e debitorit.

Në rastin konkret, faturat nuk janë të nënshkruara nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk mund të pranohen si dokument i besueshëm, në bazë të cilave mund të zhvillohet procedura përmbarrimore. Nënshkrimi nga palët në marrëdhënie detyrimi nuk paraqet vetëm një formalitet, por një veprim i tillë nënkupton pranimin e punëve të kryera nga kreditori, dhe pohimin se ekziston borxhi ndaj kreditorit sipas faturave.

63. Aktvendimi K.DH.Shk.II.nr. 220/2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 01.06.2023.

Fatura është dokument i besueshëm në rastet kur është pranuar nga debitori në formë të rregullt. Nënshkrimi i CMR-ve, nuk mund të konsiderohet pranim i faturave, dhe detyrimeve të cilat rrjedhin nga to.

Kreditori, me datë 21.09.2020 ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave të datave 02.07.2019, 23.11.2019 dhe 07.08.2020, në shumën përkatëse.

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit me Urdhrin Përmbarimor P.nr. 178/2020 të datës 23.09.2020 ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim, duke theksuar se faturat nuk plotësojnë kushtet për përmbarim, pasi që të njëjtat nuk janë pranuar nga ana e debitorit.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori me datë 19.11.2020, duke theksuar se faturat, gjegjësisht detyrimi që rrjedhë nga faturat është pranuar nga debitori, dhe një fakt i tillë provohet përmes CMR-ve të cilat janë të nënshkuara dhe të vulosura nga debitori.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin PPP.nr. 3008/20, të datës 25.02.2022, ka pranuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit, ashtu që shfuqizohet pjesërisht urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr. 178/2020 të datës 23.09.2020, dhe ka urdhëruar debitorin që nëse ushtron ankesë duhet që të paguajë garancinë në shumën përkatëse në afatin prej 7 ditëve, dhe pika nëse debitori dështon të paguajë garancinë brenda afatit ligjor, ankesa kundër këtij aktvendimi do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare.

Kundër këtij aktvendimi, kreditori në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovojë ankesën si të bazuar dhe të priset Aktvendimi PPP.nr. 3008/20 i datës 25.02.2022, dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe vendosje ose i njëjti të ndryshohet në favor të kreditorit të përmbarimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.Shk II.nr. 220/2023, të datës 01.06.2023, ka refuzuar të pabazuar ankesën e kreditorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 3008/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 25.02.2022.

Sipas Dhomës së Shkallës së Dytë, në rastin konkret faturat e dorëzuara paraqesin dokument të besueshëm, pasi që të njëjtat janë pranuar dhe nënshkruar nga ana e debitorit dhe si të tilla paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarimit në kuptim të dispozitës së Nenit 21 të LPP-së. Gjykata ka konstatuar se: *"Sa i përket pretendimeve ankimore të kreditorit se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkak se faturat janë pranuar dhe kjo dëshmohet sepse CMR-jat janë të nënshkuara dhe vulosura nga ana e debitorit, gjykata e shkallës së dytë njëjtë sikurse edhe gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se një pretendim i tillë nuk qëndron ngase fatura është dokument i besueshëm dhe e njëjta duhet të jetë e pranuar nga debitori në formë të rregullt, ashtu siç përcaktohet me dispozitat ligjore përkatëse, dhe se faturat e bashkëngjitura në propozimin për përmbarim, nuk janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori në mënyrë të rregullt, dhe nënshkrimi i CMR-ve nuk mund të konsiderohet pranim i detyrimeve të cilat rrjedhin nga faturat"*.

64. Aktvendimi Kom.Dh.Shk.II.nr. 368/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 05.06.2023.

Duke qenë se debitori ka paguar borxhin ndaj kreditorit para se të njoftohej lidhur me inicimin e procedurës përmbarimore, Gjykata ka vendosur të përfundojë procedurën përmbarimore, me arsyetimin e kjo procedurë ka humbur efektin e saj.

Kreditori, me datën 08.09.2020, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës së datës 17.01.2020, për shumën e detyrimit në vlerën përkatëse, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Përmbaruesi Privat, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.222/20 të datës 09.09.2020, ka caktuar përmbarimin, duke vlerësuar se dokumenti përmbarimor plotëson kushtet për përmbarim.

Debitori ka ushtruar prapësim, duke theksuar se kredia e kërkueshme nga kreditori sipas dokumentit të besueshëm është shuar para pranimit të këtij urdhri nga ana e debitorit me datën 23.09.2020 në llogarinë bankare të kreditorit. Me datë 25.09.2020 dy ditë më vonë, debitori ka pranuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 222/20 i cili urdhëron pagesën e kredisë, edhe pse ai borxh vetëm se ishte shlyer. Duke mos pasur njohuri për këtë procedurë përmbarimore, pagesa e borxhit e ka bërë joefektive faturën duke parandaluar kërkesën e kësaj kredie konform Nenit 71 pika 1.9 e Ligjit 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore.

Përgjigje në prapësim ka parashtuar kreditori duke kërkuar nga gjykata që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit ndërsa Urdhri Përmbarimor P.nr. 222/20 i datës 09.09.2020 të mbetet në fuqi, si i drejtë, dhe i ligjshëm.

Gjykata Themelore në Ferizaj me Aktvendimin PPP.nr.320/20 të datës 28.04.2021, ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbarim P.nr. 222/20 të datës 09.09.2020 të lëshuar nga Përmbaruesi Privat, dhe ka shfuqizuar këtë urdhër.

Në arsyetim të vendimit, gjykata ka theksuar se ia ka falur besimin e plotë provës me të cilën ka vërtetuar faktin se debitori ka paguar shumën e borxhit në llogari të kreditorit, dhe nga ana tjetër nga fletë-kthesa e cila i është dorëzuar propozimi dhe urdhri për përmbarim dhe fatura, konstatohet se debitori ka pranuar këto shkresa me datën 25.09.2020, që nënkupton se debitori me datën 23.09.2020 kur edhe e ka paguar borxhin ndaj kreditorit, nuk ka qenë i njoftuar për fillimin e procedurës përmbarimore ndaj tij, dhe më këtë fakt gjykata ka konstatuar se urdhri për përmbarim ka humbur efektin e tij dhe si i tillë ka mbetur pa mbështetje ligjore.

Kundër këtij aktvendimi, kreditori në afatin ligjor ka ushtruar ankesë me të cilën e ka kontestuar në tërësi si të pabazuar Aktvendimin PPP.nr. 320/20 e datës 28.04.2021.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit Kom.Dh.Shk.II.nr. 368/22, të datës 05.06.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e kreditorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 320/20 të Gjykatës Themelore në Ferizaj, të datës 28.04.2021.

Sipas gjykatës ankimore, nga shkresat e lëndës shihet qartë se nga fletë-kthesa me të cilën i është dorëzuar debitorit propozimi dhe urdhri për përmbarim, si dhe fatura për përmbarim, debitori i ka pranuar me datën 25.09.2020, ndërsa pagesa bankare e datës 23.09.2020 e realizuar nga debitori në emër të taksës së licencës së marrë nga kreditori, rezulton të jetë paguar borxhi sipas faturës përmbarimore, pra para njoftimit të debitorit për fillimin e procedurës përmbarimore.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur ka shfuqizuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 222/20 të datës 09.09.2020, pasi që me pagesën e borxhit ndaj kreditorit, procedura e përmbarimit ka humbur efektin e saj. Një vendosje të tillë, gjykata e ka arsyetuar duke u bazuar në Nenin 66 par. 1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, në të cilin është theksuar qartë se:

“Në qoftë se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe, përmbarimi do të përfundojë sipas detyrës zyrtare në qoftë se dokumenti përmbarimor është anuluar, ndryshuar, shfuqizuar, apo në ndonjë mënyrë tjetër është bërë i pa efekt, apo në qoftë se vërtetimi për përmbarueshmërinë e tij anulohet me vendim të formës së prerë.”

65. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 346/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 06.06.2023.

Me rastin e pranimit të propozimit për kundër përmbarim, Organi Përmbarimor duhet të shqyrtojë me kujdes të veçantë çështjen e afatshmërisë së propozimit të ushtruar, për shkak se afatet e përcaktuara për paraqitjen e propozimeve për kundër përmbarim, janë afate prekluzive.

Debitori i kundër përmbarimit me datë 27.01.2022, ka paraqitur propozim për kundër përmbarim ndaj kreditorit, në Gjykatën Themelore në Ferizaj, në bazë të dokumentit përmbarimor Aktvendimit E.Rev.nr.60/2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 19.10.2021, me të cilin është aprovuar revizioni i debitorit të përmbarimit dhe janë anuluar Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ae.nr. 170/018 i datës 07.07.2020, dhe Aktgjykimi I.EK.nr. 214/14 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i datës 03.05.2018, e ku mbi bazën e këtyre dy vendimeve të anuluar kreditorët kane realizuar kredinë, e cila rezulton të jetë anuluar nga instanca më e lartë, dhe çështja është kthyer në rivendosje. Andaj, ka propozuar kthimin e mjeteve të cilat debitorët i kanë realizuar në procedurën përmbarimore të mëhershme.

Kreditorët e kundër përmbarimit, në prapësimin e datës 15.04.2022 kanë parashtruar se kundërshtojnë në tërësi kundër përmbarimin e iniciuar nga debitori, me arsyetimin se është i pabazuar, dhe se nuk janë plotësuar kushtet për kundër përmbarim, pasi që me Vendimin E.Rev.nr. 60/2020 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 19.10.2021, çështja vetëm është kthyer në rivendosje, ndërsa nuk është refuzuar çështja në tërësi.

Gjykata Themelore në Ferizaj, me Aktvendimin E.nr. 96/22 të datës 04.05.2022, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të kundër përmbarimit, me të cilin ka kërkuar kundër përmbarimin e mjeteve në shumën përkatëse, ka vendosur që të detyrohet debitori i kundër përmbarimit, që kreditorëve në emër të shpenzimeve procedurale t'ua paguajë shumën përkatëse, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi.

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata ka theksuar së pretendimet e debitorit të përmbarimit janë të pabazuara, pasi bazuar nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e Gjykatës Supreme nuk është krijuar ndonjë detyrim për kreditorët e përmbarimit.

Kundër këtij aktvendimi, debitori i kundër përmbarimit në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe aktvendimin e atakuar ta anulojë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 346/23, të datës 06.06.2023, ka aprovuar të pabazuar ankesën e debitori, ka anuluar Aktvendimin E.nr. 96/22 të Gjykatës Themelore në Ferizaj, të datës 04.05.2020, dhe lëndën ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje, pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Parë.

Sipas Dhomës së Shkallës së Dytë, gjykata e shkallës së parë paraprakisht nuk ka shqyrtuar çështjen e afatshmërisë së propozimit për kundër përmbarim në kuptim të Nenit 54 par. 3 të LPP-së, ku afatet ligjore të përcaktuara në këtë dispozite, janë afate prekluzive, përderisa gjykata e shkallës së parë me asnjë provë nuk ka vërtetuar faktin se kur ka marrë në dijeni pala debitore për shkakun e kundër përmbarimit.

Paragrafi 3 i Nenit 54 të Ligjit për Procedurën Përmbimore, ka përcaktuar se:

“Propozimi për kundër përmbarim mund të paraqitet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita në të cilën debitori ka marrë dijeni për shkakun e kundër përmbarimit por jo më vonë se një (1) vit nga dita e përfundimit të procedurës përmbimore.”

66. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 251/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 05.09.2023.

Fatura nuk ka plotësuar kushtet për tu përmbuar për shkak se në faturë nuk janë përcaktuar pozicionet për punët e kryera, të parapara me dispozitat e Kontratës së lidhur ndërmjet palëve.

Kreditori me datën 21.02.2021 ka paraqitur propozim për përmbuarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Dy Faturave të datës 11.11.2020.

Përmbaruesi Privat sipas propozimit të kreditorit, me Urdhrit Përmbuarimor P.nr. 77/21 të datës 19.02.2021, ka lejuar përmbuarimin, me të cilën është detyruar debitori që në emër të borxhit nga faturat të cilat rrjedhin nga Kontratat e Prokurimit të datës 16.05.2019 me titull “Renovimi i emergjencës në Gjilan” dhe asaj të datës 05.07.2019 me titull “Renovimi i i ambulanteve në Gjilan”, kreditorit t’i paguaj shumën përkatëse, me kamatëvonesë prej 8% në vit nga dita e lejimit të propozimit për përmbuarim e deri në pagesën definitive.

Kundër Urdhrit Përmbuarimor, debitori me datën 05.03.2021 ka paraqitur prapësim, me pretendimin se faturat e cekura nga kreditori nuk janë të pranuar nga ndonjë komision i pranimit të punimeve, apo nga menaxheri i kontratës – personi fizik. Operatori ekonomik në cilësinë e kreditorit ka kërkuar t’i bëhet pagesa e punëve të kryera duke mos dhënë asnjë shpjegim për dështimin nga ana e tij në përmbushjen e kontratës së lartcekur. Sipas tij, kreditori i ka dorëzuar Përmbaruesit Privat dy fatura në të cilat fare nuk e ka bërë të qartë se për çka bëhet fjalë, domethënë se për cilat pozicione (punë) të kryera kërkohet përmbushja e detyrimit përmes urdhrit për përmbuarim. Ndër tjera, dy faturat për të cilat është dhënë propozim për përmbuarim nuk përmbajnë fare numër protokollit të debitorit.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datën 10.03.2020, me arsyetimin se nuk qëndron pretendimi i palës debitorë sepse faturat janë pranuar nga debitori, janë të protokolluara me çka janë plotësuar kushtet ligjore sipas LPP-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PPP.nr. 413/21 të datës 30.07.2021, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbuarimor P.nr. 77/21 së datës 19.02.2021, të Përmbaruesit Privat.

Gjykata ka arsyetuar se Përmbaruesi Privat ka lëshuar urdhër në bazë të faturave të cilat si dokumente të besueshme përbejnë bazën juridike për caktimin e përmbuarimit dhe i plotësojnë kushtet nga Neni 29, 27, dhe 29 i LPP-së.

Kundër këtij aktvendimi, debitori në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të aprovojë këtë ankesë, aktvendimin e atakuar ta ndryshojë, ose të njëjtin ta anulojë dhe çështja të kthehet në shkallë të parë në rivendosje.

Përgjigje ndaj ankesës se debitorit ka ushtruar kreditori, përmes së cilës ka kontestuar ankesën e debitorit si të pabazuar, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta refuzojë ankesën e debitorit, ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetojë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 251/23, të datës 05.09.2023, ka aprovuar të themeltë ankesën e debitorit, ka anuluar Aktvendimin PPP.nr. 413/21 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe lëndën ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje, pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Parë.

Sipas arsytimit të ofruar nga gjykata, kontratat e lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse në përmbajtjen e tyre kanë paraparë pozicionet për punët të cilat janë paraparë të kryhen, duke përfshirë njësinë, sasinë, çmimin dhe në fund totalin e obligimeve, e që mbi bazën e këtyre pozicioneve të përcaktuara në këto kontrata, krijohen edhe detyrimet si në faturat përmbushjen e të cilave e kërkon kreditori.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka vlerësuar se faturat në përmbajtjen e tyre nuk kanë të përcaktuar situacionin e paraparë me këto kontrata siç del edhe nga Neni 25 pika 1 e Kushteve të Përgjithshme –Pjesës II të Kontratës, që ndër tjera ka paraparë se: *“Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, Kontraktuesi paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull”,* e që në rastin konkret, në fatura nuk është dhënë artikulli, gjegjësisht pozicioni nga i cili do të rezultonte edhe detyrimi i debitorit ndaj kreditorit. Andaj, është e paqartë se shuma e kërkuar nga faturat për cilat situacione të kontratave ka të bëjë. Gjykata e shkallës së dytë ka vendosur se këto fatura nuk janë të përshtatshme për përmbarim.

Edhe në këtë vendim, Gjykata ka marr parasysh ekzistimin e kontratës në çështjen e arritjes apo jo për pagesë të faturës, për dallim nga faturat për të cilat nuk ka kontratë mes palëve ku shqyrton vetëm formën e dokumentin përmbarimor.

67. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 1447/22 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 29.09.2023.

Pavarësisht faktit se fatura nuk përmban nënshkrimin e debitorit, pranimi i saj me vulë të debitorit, nuk e zhvleftëson mënyrën e pranimit përderisa të mos provohet se një gjë e tillë është keqpërdorur nga ana e ndonjë subjekti.

Kreditori, me datën 17.09.2021, ka paraqitur propozim për përmbarim kundër debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave të datave 10.06.2021, 09.06.2021, 09.06.2021, 09.06.2021, 09.06.2021, 09.06.2021, 10.06.2021, dhe 10.06.2021.

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit ka nxjerrë Urdhrin Përmbarimor P.nr. 578/21 të datës 20.09.2021, me të cilin e ka lejuar përmbarimin sipas faturave, duke e detyruar debitorin që në emër të detyrimit nga këto fatura t'ia paguajë kreditorit shumën përkatëse me kamatë ligjore prej 8% nga data e lëshimit të faturës e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e përmbarimit.

Kundër Urdhrit Përmbarimor, debitori me datë 29.09.2021 ka paraqitur prapësim me pretendimin se dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbarimi nuk është dokument i besueshëm sipas LPP-së, sepse nuk ka nënshkrimin e debitorit, nuk i është dorëzuar të njëjtit, gjegjësisht nuk i është dhënë mundësia që i njëjti në afatin parativ ligjor të bëjë përmbushjen vullnetare të detyrimeve.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori me datë 06.10.2021, me pretendimin se faturat i plotësojnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas Nenit 29 par. 3 të LPP-së. Faturat u janë dorëzuar rregullisht, pasi çdo maunë kur futet në territorin e Republikës së Kosovës fillimisht duhet të kryhet procedura paraprake nga shpedicioni, të vazhdohet me procedura tjera të procesimit së deklarates së importit e paraparë me Kodin Doganor dhe Akcizave në Kosovë, në këtë rast i referohet edhe autorizimit të lëshuar nga Noteri në Prishtinë, me çka është vërtetuar pranimi i shërbimit, si dhe vulosja e faturave nga debitori. Tutje, kreditori ka shtuar se i kanë dërguar debitorit e-mail lidhur me borxhet e krijuara duke ia dërguar edhe kartelën e klientit me të gjitha shërbimet e kryera.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin PPP.nr.1278/21 të datës 10.03.2022, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 578/21 të datës 20.09.2021, të Përmbaruesit Privat, dhe ka refuzuar si të pabazuar propozimin për përmbarim të paraqitur me datën 17.09.2021, ndërsa Urdhrin Përmbarimor P.nr. 578/21 të datës 20.09.2021 të Përmbaruesit Privat, e ka shfuqizuar. Në arsyetim të aktvendimit, gjykata ka theksuar se Urdhri Përmbarimor është nxjerr pa plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e tij sepse dokumentet e besueshme - faturat në bazë të cilave është kërkuar përmbushja e detyrimit nuk përbëjnë bazën juridike për përmbarim, sepse të njëjtat nuk janë të nënshkruara nga debitori, dhe se në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga i njëjti.

Kundër këtij aktvendimi, kreditori në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovojë ankesën si të bazuar, ndërsa aktvendimin e ankimuar ta anulojë, dhe Urdhrin Përmbarimor ta vërtetojë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 1447/22, të datës 29.09.2023, ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit, dhe ka anuluar Aktvendimin PPP.nr. 1278/21 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 10.03.2022.

Sipas gjykatës ankimore, gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh faktin se faturat mbi të cilat është iniciuar procedura përmbarimore nuk janë të nënshkruara, porse ka neglizhuar faktin se këto fatura janë të vulosura me vulën e debitorit.

Sipas kësaj gjykate, fakti se për të qenë i pranueshëm dokumenti përmbarimor në raportet e ndërsjella afariste, mjafton që fatura të pranohet nga subjekti. Në këtë drejtim, pavarësisht faktit se nuk është vendosur nënshkrimi në faturë, pranimi i saj me vulë të subjektit nuk e zhvleftëson mënyrën e pranimi.

Faturat e pranuar përbajnë dokumente të besueshme të përshtatshme për përmbarim dhe në këtë rast paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit në kuptim të dispozitave ligjore të Nenit 29 të LPP-së, përderisa mënyra e pranimi bëhet në formë të dëshmisë zyrtare, qoftë me vulë apo nënshkrim, përderisa të mos provohet se një gjë e tillë, është keqpërdorur nga ndonjë nga subjekti.

68. Aktvendimi K.Dh.shk.II.nr. 890/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 10.10.2023.

Përkundër faktit se faturat përmbajnë nga një nënshkrim, të njëjtat nuk konsiderohen dokumente të besueshme, për shkak se këto fatura nuk përmbajnë vulën e pranimit dhe të protokollimit, përmes së cilave mund të vërtetohet se të njëjtat janë dërguar në zyrën e pranimit të debitorit (institucionit publik).

Kreditori me datë 16.07.2020, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm – gjashtë Faturave, me të cilin do të detyrohet debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin t’ia paguajë kreditorit borxhin në shumën përkatëse, me kamatë prej 8%, nga dita kur ka qenë i obliguar të paguajë obligimin e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore. Realizimi i përmbarimit të bëhet përmes ndalimit të mjeteve monetare të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogaritë bankare të kreditorit si dhe regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit, deri në vlerën e borxhit.

Përmbaruesi Privat me Urdhrin Përmbarimor P.nr. 2360/20, të datës 16.07.2020, ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm - gjashtë Faturave të dorëzuara nga kreditori.

Debitori ka paraqitur prapësim duke deklaruar se faturat mbi të cilat është lejuar përmbarimi, nuk janë dokumente përmbaruese dhe si të tilla nuk paraqesin titull ekzekutiv, duke shtuar se kreditori ka dështuar që të bashkëngjisë provat e nevojshme mbi të cilat e bazon këtë propozim për përmbarim dhe me këtë rast ka bashkëngjitur vetëm faturat në kopje të cilat nuk i plotësojnë kushtet esenciale, dhe si të tilla nuk mund të jenë objekt përmbarimi, pasi që të njëjtat duhet të jenë të nënshkruara nga të dy palët, si kreditori ashtu dhe debitori, të ceket afati për pagesë, dhe burimi i asaj fature, ndërsa në rastin konkret kreditori në faturë vetëm ka shënuar “Për Institucionin Publik (debitorin)”, duke pretenduar se është në tërësi e paqartë, e pakuptimtë dhe kontradiktore se në çfarë baze ligjore kreditori ka kërkuar detyrimin ndaj debitorit. Tutje, ka shtuar se faturat nuk kanë numër protokollit dhe nga kjo rezulton se nuk janë përmbushur kushtet ligjore që këto fatura të jenë objekt përmbarimi. Ndërkaq, për njërën faturë, debitori ka theksuar se është parashkruar.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se pretendimi i debitorit se faturat nuk janë të pranuar dhe nënshkruara nuk qëndron pasi që faturat në bazë të cilave është filluar procedura e përmbarimit janë të nënshkruara dhe të pranuar nga ana e debitorit e të cilat janë të noterizuara, ku në secilën faturë shihet specifikacioni i mallit dhe se debitori nuk ka mohuar borxhin që ka ndaj kreditorit, dhe se nuk ka paraqitur asnjë dëshmi që detyrimin e tij e ka përmbushur. Sa i përket parashkrimit të njëres fature, ka theksuar se në rastin konkret me Nenin 412 të LMD-së, janë përcaktuar se cilat janë kontratat komerciale, ndërsa debitori nuk është subjekt komercial dhe pasi që nuk kemi afat të veçantë të parashkrimit, në rastin konkret vlen afati i përgjithshëm prej 5 viteve siç parashihet në Nenin 352 të LMD-së.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Parë, me Aktvendimin KPPP nr. 373/22, të datës 31.03.2023, ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit (institucionit publik), dhe ka anuluar Urdhri Përmbardimor P.nr. 2360/20, të datës 16.07.2020, të lëshuar nga Përmbarduesi Privat, dhe ka përfunduar në tërësi përmbardimi në këtë çështje përmbardimore.

Sipas gjykatës së shkallës së parë, dokumentet mbi të cilat është mbështetur propozimi për përmbardim, e mbi bazën e të cilave Përmbarduesi Privat ka lejuar përmbardimin, nuk plotësojnë kushtet ligjore. Faturat në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga kreditori dhe nuk janë pranuar asnjëherë në mënyrë të rregullt nga debitorit. Të njëjtat nuk e përmbajnë vulën e pranimit dhe të protokollimit, përmes të cilave mund të vërtetohet se të njëjtat janë dërguar në zyrën e pranimit të debitorit. Sipas gjykatës, qëndron fakti se këto fatura përmbajnë një nënshkrim tek rubrika e pranimit, mirëpo nuk dihet se nga kush janë pranuar këto fatura dhe se gjithashtu nuk dihet cilësia e personit që i ka pranuar ato. Meqenëse gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbarduesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi, mbi këtë arsye gjykata nuk ka shqyrtuar çështjen lidhur me pretendimin për parashkrimin e borxhit të një fature.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor kreditori ka parashtruar ankesë dhe atë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit, ndërsa aktvendimin e ankimuar ta prishë dhe të mbetet në fuqi Urdhri Përmbardimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.Dh.shk.II.nr.890/23, të datës 10.10.2023, ka refuzuar ankesën e kreditorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin KPPP.nr. 373/22 e Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Parë, të datës 31.03.2023.

Sipas gjykatës ankimore, gjykata e shkallës së parë me të drejt ka vlerësuar se faturat në bazë të cilave është lejuar përmbardimi nuk plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme, pasi që të njëjtat nuk e përmbajnë vulën e pranimit dhe të protokollimit, përmes të cilave mund të vërtetohet se të njëjtat janë dërguar në zyrën e pranimit të debitorit.

Faturat përmbajnë një nënshkrim tek rubrika e pranimit, mirëpo nuk dihet qartë se nga kush janë pranuar apo nënshkruar, dhe nuk dihet as cilësia e personit që i ka pranuar ato. Në rastin konkret faturat nuk janë pranuar nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk mund të pranohen si dokument i besueshëm, në bazë të cilave mund të zhvillohet procedura përmbardimore. Gjykata në arsyetimin e vendimit të saj, ka ofruar dispozitën e Nenit 29, paragrafit 3 të LPP-së, në të cilën është përcaktuar se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitorit, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”.*

Një vendosje të tillë të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, mund ta gjeni edhe në Aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr. 355/23 të datës 19.06.2023, dhe në Aktvendimin K.Dh.shk.II.nr. 1320/22, të datës 16.06.2023.

69. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 909/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 16.10.2023.

Në rastin konkret, faturat nuk plotësojnë kushtet mbi të cilët mund të kërkohet përmbartimi, për shkak se të njëjtat nuk janë të nënshkruara dhe se nuk ka dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga debitori, përkundër faktit që këto fatura përmbajnë vulën e debitorit të përmbartimit¹.

Kreditori me datën 21.09.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave të datave 01.06.2021, 18.06.2021, 18.06.2021, 18.06.2021, 25.08.2021, dhe 25.08.2021.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka nxjerrë Urdhrin Përmbartimor P.nr. 624/2021 të datës 21.09.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin sipas faturave, duke detyruar debitorin që në emër të detyrimit nga këto fatura t'ia paguajë kreditorit shumën përkatëse me kamatë ligjore prej 8%, nga data e lëshimit të faturës e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e përmbartimit.

Kundër Urdhrit Përmbartimor, debitori ka paraqitur prapësim, me pretendimin se dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbartimi nuk është dokument i besueshëm sipas LPP, nuk është i rregullt dhe nuk i plotëson kërkesat nga Neni 38 i LPP-së par.1 dhe 2, sepse të njëjtat nuk janë të nënshkruar nga debitori, dhe se faturat nuk i janë dorëzuar debitorit në mënyrë që ta bëjë përmbushjen vullnetare të detyrimit. Përveç kësaj, kreditori ka abuzuar me autorizimin dhe marrëveshjen ndërmjet palëve duke keqpërdorur vulën për të cilën ka qenë i kontraktuar të bëjë vulosjen e dokumentacionit për eksport të mallit, në të njëjtën kohë ka bërë edhe vulosjen e faturave, andaj ka propozuar që gjykata ta aprovojë prapësimin e debitorit, dhe ta anulojë Urdhrin Përmbartimor.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori me datë 06.10.2021, me pretendimin se faturat i plotësojnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas Nenit 29 par 1.3 të LPP-së. Faturat i janë dorëzuar debitorit, pasi çdo maunë kur futet në territorin e Republikës e Kosovës fillimisht duhet të kryhet procedura paraprake nga shpedicioni, ka shtuar se përveç pranimit të mallit dhe shërbimit debitori i është drejtuar edhe përmes komunikimit të vazhdueshëm ku i njëjti ka krijuar vonesa lidhur me pagesën e borxhit.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin PPP.nr. 12491/21 të datës 25.02.2022, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, ka shfuqizuar urdhrin e Përmbartuesit Privat mbi caktimin e përmbartimit P.nr. 624/21 të datës 21.09.2021, dhe refuzohet i pabazuar propozimi për përmbartimi paraqitur i paraqitur me datë 21.09.2021 nga kreditori i përmbartimit, tek organi Përmbartuesi Privat.

1 Konsiderojmë se është e nevojshme të theksohet fakti se debitori gjatë paraqitjes së mjeteve goditëse në procedurën përmbartimore, ka pretenduar se kreditori ka keqpërdorur vulën e debitorit, për të cilën kreditori ka qenë i kontraktuar të bëjë vulosjen e dokumentacionit për eksport të mallit, në të njëjtën kohë, pretendohet se kreditori ka bërë edhe vulosjen e faturave të lëshuara në drejtim të kreditorit.

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata i është referuar dispozitave ligjore të LPP-së, përkatësisht Nenit 44 par. 4, Nenit 29 të LPP-së, andaj rrjedhimisht, vlerëson se kreditori me asnjë provë nuk ka mundur të provojë se faturat në bazë të cilave është caktuar përmbarimi i janë dorëzuar debitorit, ngase të njëjtat nuk janë nënshkruar nga debitori (përkundër që përmbajnë vulën e debitorit të përmbarimit) dhe se nuk ka dëshmi përcjellëse se të njëjtat janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori, pra nuk mund të konsiderohet se faturat janë pranuar nga debitori, në mënyrë që të mundet ta ketë pastaj cilësinë e debitorit.

Kundër këtij aktvendimi, kreditori në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, me propozim që aprovohet ankesa si e bazuar, aktvendimin e ankimuar ta anulojë dhe Urdhrin Përmbarimor ta vërtetojë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 909/23, të datës 16.10.2023, ka refuzuar të pabazuar ankesën e kreditorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 12491 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 25.02.2022.

Dhoma e Shkallës së Dytë, ka theksuar se faturat të cilat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim, dhe në bazë të cilave është kërkuar përmbushja e detyrimeve nga debitori, nuk i plotësojnë kushtet ligjore të parapara me Nenin 29 par. 3 i cili ka theksuar se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”* si dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 15/2010, i cili në Nenin 20 par. 1 nënpar. 1.17 parasheh qe *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, andaj, sipas kësaj dispozite faturat duhet të jenë të nënshkruara.

Në rastin konkret faturat nuk janë të nënshkruara nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk mund të pranohen si dokument i besueshëm, në bazë të cilave mund të zhvillohet procedura përmbarimore, mirëpo kreditori mund të iniciojë procedurë tjetër gjyqësore lidhur me realizimin eventual të kërkesës së tij.

Një vendosje të tillë të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, do të mund ta gjeni edhe në Aktvendimin pasues, të identifikuar me shenjën K.DH.SH.II.nr. 906/23 të datës 17.10.2023.

Sikurse në këtë vendim edhe në Aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 906/23 e datës 17.10.2023, debitori gjatë paraqitjes së mjeteve goditëse në procedurën përmbarimore, ka pretenduar se kreditori ka keqpërdorur vulën e debitorit, për të cilën kreditori ka qenë i kontraktuar të bëjë vetëm vulosjen e dokumentacionit për eksport të mallit, por në të njëjtën kohë, pretendohet se kreditori ka bërë edhe vulosjen e faturave të lëshuara në drejtim të kreditorit. Në të dy këto raste, procedura përmbarimore është realizuar ndërmjet palëve të njëjta.

70. Aktvendimi K.Dh.Shk.II.nr. 888/2023 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 17.10.2023.

Vendimi mbi të cilin është iniciuar procedura përmbarimore nuk mund të përmbarohet, pasi që të njëjti i mungon vula e klauzolës së formës së prerë, dhe ekzekutueshmërisë, të njëjtin i mungon edhe data e nxjerrjes së aktit, udhëzimi për këshillë juridike është i mangët, vendimi në vete nuk përmban fare arsyetim, si dhe për vlerën e borxhit të akumuluar të tatimpaguesit, nuk është përcaktuar periudha nga buron detyrimi.

Kreditori, me datën 25.10.2022, ka paraqitur propozim për përmbarim, ndaj debitorit në bazë të Vendimit të datës 10.10.2022, lëshuar nga Komuna e Mitrovicës Jugore, në vlerën përkatëse.

Përmbaruesi Privat, duke vendosur lidhur me propozimin për përmbarim të kreditorit ka nxjerrë Aktvendimin P.nr. 1125/2022 të datës 27.10.2022, me të cilin ka lejuar përmbarimin.

Ndaj këtij aktvendimi, debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se dokumenti në bazë së të cilit është nxjerrë Urdhri Përmbarimor nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk ka tiparet të përmbarushmërisë, si dhe i njëjti nuk e ka shterur afatin vullnetar të përmbarimit të detyrimit.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Parë me Aktvendimin KPP.nr. 2501/22 të datës 08.05.2023, ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr. 1125/2022 të datës 27.10.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat, dhe ka shfuqizuar Urdhri Përmbarimor P.nr. 1125/22 të datës 27.10.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat.

Sipas gjykatës, vendimi për ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguar nga Zyra e Tatimit në Pronë, për shumën e borxhit në lartësinë përkatëse, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk plotëson kushtet për të qenë dokument përmbarimor me titull ekzekutiv, sepse nuk përmban të gjitha elementet e kërkuara, të njëjtit i mungon data e nxjerrjes, udhëzimi për këshillë juridike është i mangët, nuk ka arsyetim, nuk ka klauzolën e përmbarueshmërisë, nuk ka ndonjë vulë verifikuese, dhe nuk ka të përcaktuar periudhën kohore nga ka buruar detyrimi i kërkuar.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor, kreditori ka parashtruar ankesë, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet, ose aktvendimin e ankimuar ta ndryshojë.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.Dh.Shk.II.nr. 888/2023, të datës 17.10.2023, ka refuzuar të pathemeltë ankesën e kreditorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin KPP.nr. 2501/22 të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Parë.

Edhe sipas gjykatës së shkallës së dytë, vendimi nuk është dokument përmbarimor i cili mund të jetë i përmbarueshem, pasi që i mungon vula e klauzolës së formës së prerë dhe ai i ekzekutueshmërisë dhe, si i tillë është i pa vlefshëm juridikisht dhe i papërshtatshëm për përmbarim, pasi që të njëjti i mungon edhe data e nxjerrjes së aktit, udhëzimi për këshillë juridike është i mangët, vendimi në vete nuk përmban fare arsyetim, si dhe për vlerën e borxhit të akumuluar të tatimpaguesit nuk është përcaktuar periudha nga derivon detyrimi.

71. Aktvendimi K.DH.SH.II.nr. 906/23 i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomës së Shkallës së Dytë, i datës 17.10.2023.

Faturat nuk plotësojnë kushtet mbi të cilët mund të kërkohet përmbartimi, për shkak se të njëjtat nuk janë të nënshkruara dhe se nuk ka dëshmi se të njëjtat janë pranuar nga debitori, përkundër faktit që këto fatura përmbajnë vulën e debitorit të përmbartimit.

Kreditori me datën 21.09.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër debitorit, në bazë të dokumenti të besueshëm – Faturave të datave 25.05.2021, 26.05.2021, 26.05.2021, 14.05.2021, dhe 12.05.2021.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka nxjerrë Urdhrin Përmbartimor P.nr. 620/2021 të datës 21.09.2021, me të cilin e ka lejuar përmbartimin sipas faturave, duke e detyruar debitorin që në emër të detyrimit nga këto fatura t'ia paguaj kreditorit shumën përkatëse me kamatë ligjore prej 8% nga data e lëshimit të faturës e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e përmbartimit.

Kundër Urdhrit Përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim, me pretendimin se dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbartimi nuk është dokument i besueshëm sipas LPP-së, sepse faturat nuk janë të nënshkruar nga debitori, dhe se faturat në asnjë rast nuk i janë dorëzuar debitorit në mënyrë që ta bëjë përmbushjen vullnetare të detyrimit. përveç kësaj, kreditori ka abuzuar me autorizimin dhe marrëveshjen ndërmjet palëve duke keqpërdorur vulën për të cilën ka qenë i kontraktuar të bëjë vulosjen e dokumentacionit për eksport të mallit, por në të njëjtën kohë ka bërë edhe vulosjen e faturave.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori, me pretendimin se faturat i plotësojnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas Nenit 29 par 1.3 të LPP-së. Faturat i janë dorëzuar kreditorit, pasi çdo maunë kur futet në territorin e Republikës e Kosovës fillimisht duhet të kryhet procedura paraprake nga shpedicioni, ka shtuar se përveç pranimit të mallit dhe shërbimit, debitori i është drejtuar edhe përmes komunikimit të vazhdueshëm ku i njëjti ka krijuar vonesa lidhur me pagesën e borxhit.

Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin PPP.nr. 1253/21 të datës 25.02.2022, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin e Përmbartuesit Privat mbi caktimin e përmbartimit P.nr. 620/21 të datës 21.09.2021.

Në arsyetim të aktvendimit, gjykata i është referuar dispozitave ligjore të LPP-së, përkatësisht Nenit 44 par. 4, Nenit 29 të LPP-së, andaj rrjedhimisht, vlerëson se kreditori me asnjë provë nuk ka mundur të provojë se faturat në bazë të cilave është caktuar përmbartimi i janë dorëzuar debitorit, ngase të njëjtat nuk janë nënshkruar nga debitori (përkundër që përmbajnë vulën e debitorit të përmbartimit) dhe se nuk ka dëshmi përcjellëse se të njëjtat janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori, pra nuk mund të konsiderohet se faturat janë pranuar nga debitori, në mënyrë që të mundet ta ketë pastaj cilësinë e debitorit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, me propozim që aprovohet ankesa si e bazuar, aktvendimin e ankimuar ta anulojë dhe Urdhrin Përmbartimor ta vërtetojë.

Gjykata Komeriale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë, përmes Aktvendimit K.DH.SH.II.nr. 906/23, të datës 17.10.2023, ka refuzuar ankesën e kreditorit, dhe ka vërtetuar Aktvendimin PPP.nr. 1253/21 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të datës 25.02.2022.

Sipas arsytimit të ofruar nga Dhoma e Shkallës së Dytë, në rastin konkret faturat nuk janë të nënshkruara nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk mund të pranohen si dokument i besueshëm, në bazë të cilave mund të zhvillohet procedura përmbarimore, mirëpo kreditori mund të iniciojë procedurë tjetër gjyqësore lidhur me realizimin eventual të kërkesës së tij.

Një vendosje të tillë të Gjykatës Komeriale të Kosovës – Dhomës së Shkallës së Dytë, do të mund ta gjeni edhe në Aktvendimi paraparak të identifikuar me shenjën K.DH.SH.II.nr. 909/23 të datës 16.10.2023.

Sikurse në këtë vendim edhe në Aktvendimin K.DH.SH.II.nr. 909/23 e datës 16.10.2023, debitori gjatë paraqitjes së mjeteve goditëse në procedurën përmbarimore, ka pretenduar se kreditori ka keqpërdorur vulën e debitorit, për të cilën kreditori ka qenë i kontraktuar të bëjë vulosjen e dokumentacionit për eksport të mallit, por në të njëjtën kohë, pretendohet se kreditori ka bërë edhe vulosjen e faturave të lëshuara në drejtim të kreditorit. Në të dy këto raste, procedura përmbarimore është realizuar ndërmjet palëve të njëjta.



Adresa:

**Rr. "Holger Petersen", Objekti "Park Residence",
Hyrja 4, Kati 0, Numër 2,
Prishtinë, Kosovë.**

+383 44 55 66 70

Info@vokshilata.com

www.vokshilata.com